

Nr. 8/25 i Regj.Themeltar
Nr. 8/25 i vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Evelina Qirjako	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar

Me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore Elona Kardhiqi në seancën gjyqësore datë 14.06.2017 të zhvilluar me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen penale e cila sipas Rregjistrimit Themeltar të Gjykatës së Lartë mban nr. 8/25/2016 me palë:

KËRKUES: **PROKURORIA E PËRGJITHSHME E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,**
përfaqësuar nga prokurori Arben Kraja.

TË PANDEHUR: **MAJLINDA ANDREA,** *e bija e Andrea dhe Stavrulla, lindur më 30.06.1969 në Durrës dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar, me shtetësi shqiptare me arsim të lartë, e martuar, aktualisht anëtare e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, me gjendje të lirë, e mbrojtur në gjykim nga avokat Theodhori Sollaku.*

ODHISE ANDREA, *i biri i Thodhorit dhe Ritës, lindur më 09.02.1964 në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, i pa dënuar, me shtetësi shqiptare, me arsim të lartë, i martuar, me mase sigurie “Arrest në shtëpi”, mbrojtur në gjykim nga avokat Ardian Visha.*

PETRAQ DASHI, *i biri i Koli dhe Sofie, lindur më 29.06.1966 në Fier dhe banues në Fier, i pa dënuar, me shtetësi shqiptare me arsim të mesëm, i martuar, me masë sigurie “Arrest në burg”, i mbrojtur nga avokat Theodhori Sollaku.*

ILIA ÇABIRI, *i biri i Fane dhe Konde, lindur më 06.08.1957 në Delvinë dhe*

banues në Sarandë, i pa dënuar, me shtetësi shqiptare, i martuar me arsim të mesëm, me masë sigurie “Arrest në burg”, i mbrojtur nga avokatët Ndue Pjetra dhe Gentiana Qendro.

ELENI LINO, e bija e Vasil dhe Gjeorgjia, lindur më 14.05.1956 në Gjirokastrë dhe banuese në Gjirokastrë, e pa dënuar, me shtetësi shqiptare me arsim të mesëm, e martuar me masë siguri “Arrest në shtëpi”, mbrojtur nga avokat Sokol Mengjesi.

TË AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319 e 25 dhe 319/ç e 25 të Kodit Penal.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pas vlerësimit të akteve të këtij procedimi penal dhe çmimit të provave të paraqitura nga palët e të pranuarat për tu administruar prej tij, si dhe pasi dëgjoi qëndrimet e kërkesat e prokurorit dhe të mbrojtësve të të pandehurve,

V Ë R E N

1. Prokuroria e Përgjithshme ka paraqitur në datën 14.10.2016 pranë Gjykatës së Lartë kërkesën për gjykim për të pandehurit:

Majlinda Andrea, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal

Odhise Andrea, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal.

Petraq Dashi, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal,

Ilia Çabiri, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal,

Eleni Lino, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal.

2. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nisur nga funksioni kushtetues që ka e pandehura Majlinda Andrea në momentin e ardhjes së kërkesës për gjykim të këtij procedimi penal nga organi i akuzës, (e pandehura në momentin e gjykimit të çështjes është Anëtare e Gjykatës së Lartë të

Shqipërisë), konstatoi se është para një çështje penale për të cilën gjen aplikim nën 75/b i K.Pr.Penale në të cilin thuhet se: *“Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit.”*

3. Ky Kolegj, marrë shkas nga ndryshimet e fundit ligjore që ka pësuar akti themeltar i vendit Kushtetuta, si dhe nga debati i zhvilluar në dhomë këshillimi në lidhje me çështjen e kompetencës lëndore, vlerëson në këtë vendim fillimisht të analizoje faktin se përse ai është kompetent për gjykimin e kësaj çështje, gjë të cilën e bën edhe kryesisht bazuar në nenin 72 të K.Pr.Penale.

4. Referuar të drejtës sonë procedurale, kompetenca është pikërisht pushteti që ligjvënësi i ka dhënë çdo gjykatë të çdo niveli (si në aspektin horizontal dhe në aspektin vertikal) për të marrë në shqyrtim çështje të caktuara, për këto si në aspektin material (lënda që gjykohet dhe këtu kemi ndarjen në gjykata penale normale dhe në gjykata të krimeve të renda), ashtu dhe në aspektin procedural (nisur nga subjekti i posaçëm). Kompetenca është pikërisht hapësira e përcaktuar me ligj në të cilat është i legjitimuar dhe ushtrohet pushteti gjyqësor.

5. Juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë për gjykimin e heshtjeve penale, ku të pandehur janë subjektet e parashikuara në nenin 75/b të KP, buronte nga vete Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998, ku në nenin 141 të saj thuhet se: *“Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër presidentit të republikës, kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese...”*. Ky parashikim kushtetues, ishte pasqyruar edhe në K.Pr.Penale në nenin 75/b të tij.

6. Me juridiksion fillestar duhet kuptuar gjykimi për here të parë, apo gjykimi në themel i veprave penale të kryera nga subjektet e parashikuara në nenin 75/b, gjykim i cili për subjektet e tjera si rregull bëhet nga gjykata e shkallës së parë. Gjykimi i këtyre subjekteve në Gjykatën e Lartë, bëhet për shkak të funksionit të veçantë që ata kanë, duke pranuar gjykimin vetëm pranë kësaj gjykate dhe duke hequr dorë nga gjykimi në dy shkallët me të ulta. Këto subjekte do të gjykohen nga Gjykata e Lartë si për vepra penale në ushtrimin e detyrës, ashtu dhe për çdo veprë tjetër që ata mund të kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës. Ky juridiksion i veçantë i Gjykatës së Lartë, nuk është i përcaktuar nga vepra penale por nga subjekti që kryen veprën penale, si dhe momenti i gjykimit të akuzës penale. Në interpretim të kësaj dispozite, del qartë fakti që subjektet e parashikuara në nenin 75/b të K.Pr.Penale, gjykohen nga Gjykata e Lartë: *“kur në kohën e gjykimit të kësaj vepre penale ata janë në funksionet e parashikuara në këtë dispozitë”*. Gjykimi i këtyre subjekteve në Gjykatën e Lartë, zhvillohet duke u respektuar për aq sa nuk vjen në kundërshtim me rregullat e gjykimit në shkallë të parë.

7. Pikërisht ky standard i cili ishte vendosur në nenin 141 të Kushtetutës së vitit 1998 dhe që u pasqyrua dhe në nenin 75/b të K.Pr.Penale, vlerësohet se nuk vinte në kundërshtim me standardet për ankimmimin e vendimeve gjyqësore bazuar kjo dhe në nenin 2 protokollit 7 të KEDNJ e cila thotë se: *“kjo e drejtë mund të ketë përjashtime... kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga një gjykatë me e lartë”*. Kjo dhe për faktin se vërtet Gjykata e Lartë gjykon si shkallë e parë, por ky vendim mund të rishikohet për shkak ligjor të parashikuara në nenin 450 të K.Pr.Penale, ose mund të ankimmohet në Gjykatën Kushtetuese në rastin e një procesi jo të rregullt ligjor. Ky qëndrim është mbajtur qartësisht edhe nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 62, datë 04.11.2016.

8. Ajo që është e rëndësishme të theksohet në këtë vendim, është fakti se parashikimi i bere në nenin 75/b të K.Pr.Penale buronte direkt nga Kushtetuta. Me ndryshimet e fundit kushtetuese (Kushtetuta e re), të cilat u miratuan në datën 22.07.2016 dhe që hynë në fuqi në datën 11 Gusht 2016, rezultoi se në nenin 135, thuhet: “1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. 2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur. 3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.”. Kurse në nenin 141, me ndryshimet e fundit parashikohet se: “Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit”.

9. Në rast se do të marrim në analizë ndryshimet e fundit Kushtetuese, del qartë fakti se tashme ligjvënësi e ka shfuqizuar në Kushtetute normën që ishte me parë në të, lidhur me juridiksionin fillestar që kishte Gjykata e Lartë për subjektet e posaçme. Këto subjekte të posaçme sipas Kushtetutës, në rast se kryejnë një vepër penale gjatë kohës që janë në detyrë do të gjykohen nga Gjykatat e Posaçme, të cilat do të krijohen sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (SPAC).

10. Ndryshimet kushtetuese, të cilat hynë në fuqi në datën 11 gusht 2016, parashikonin në dispozitat tranzitore, konkretisht tek neni 178 se: “Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar...”. Ndërkohe ky Kolegj evidenton faktin se, në momentin e gjykimit të kësaj çështje, është ende në fuqi K.Pr.Penale me parashikimin e bere për juridiksionin fillestar në nenin 75/b të tij. (ndryshimet e K.Pr.Penale do të hyjnë në fuqi në datën 1 gusht 2017).

11. Në rast se do të analizojmë këtë dispozitë tranzitore (nenin 178 të Kushtetutës), arrihet në konkluzionin se çdo ndryshim që është parashikuar në Kushtetute, i cili ndryshon pjesërisht ose tërësisht funksionin ose kompetencat e një organi të caktuar, nuk shfuqizon në mënyrë të menjëhershme dhe ligjet mbi të cilat këto organe funksionojnë dhe janë organizuar. Këto ligje vazhdojnë të funksionojnë dhe të zbatohen derisa ligjet e reja që do dalin në zbatim të Kushtetutës do të shfuqizojnë ato (pratej në atë kohë të miratohej një paketë e tere ligjesh në përputhje me Kushtetutën).

12. Sa me sipër bazohet edhe në respektimin e parimit të vazhdimësisë së kompetencës (koncept kushtetues), e cila ka të beje nga njëra anë me vazhdimin e aplikimit të kuadrit ligjor ekzistues përse kohe këto ligje nuk janë shfuqizuar nga një ligj i ri ose nga Gjykata Kushtetuese dhe nga ana tjetër, me vazhdimin e funksionimit të organeve kushtetuese dhe ligjore mbi bazën e rendit juridik në fuqi, deri sa të miratohen ligjet e reja ose deri sa të krijohen organet e reja që do të zëvendësojnë ato. Sa me sipër, është në përputhje dhe me mendimin e Gjykatës Kushtetuese të shprehur në vendimin nr. 44/2011, në të cilin thuhet se: “...në një shtet demokratik institucionet, sidomos ato kushtetuese duhet të reflektojnë vazhdimësi të funksioneve të tyre, me qëllim përcimin e sigurisë tek populli se pavarësisht rotacioneve politike dhe institucionale ekzistenca e institucioneve dhe funksionimi normal i tyre nuk rrezikohet”.

13. Parimi i vazhdimësisë së funksionimit të institucioneve është një nga parimet me të rëndësishme ku mbështetet shteti demokratik. Ndryshimet Kushtetuese (Kushtetuta e re e vitit 2016) kanë parashikuar një sërë ndryshimesh për disa prej organeve kushtetuese, ndërkohe kanë parashikuar krijimin e organeve të reja, si dhe ndryshimin e kompetencave të tyre pjesërisht apo plotësisht. Po megjithatë rezultoi që ligjet mbi të cilat këto organe funksionin mbeten për një farë kohe ende në fuqi dhe nuk u shfuqizuan në mënyrë të menjëhershme (nuk ka ndonjë dispozitë tranzitore në kushtetute ku të flasë për shfuqizimin e këtyre ligjeve). Moszbatimi dhe mosrespektimi i ligjeve që ishin në fuqi, të cilat rregullonin veprimtarinë e këtyre organeve, në një kohe që nuk ishin krijuar ende organet e reja kompetente, do të fuste në kolaps sistemin dhe do të bënte që të mos kishte një funksionim normal të këtyre institucioneve kushtetuese në një kohe që dihej se, paketa ligjore kërkon një kohe të mjaftueshme për tu përgatitur dhe miratuar. Ky kolegj vlerëson se ky ka qenë dhe qëllimi i ligjvënësimit në parashikimin që ka bërë në nenin 178 të Kushtetutës . Ai ka patur parasysh respektimin e parimit të vazhdimësisë, gjë që del qartë edhe nga analiza që do të bëhet më poshtë dispozitave kushtetuese, si dhe të ligjeve që u miratuan me vonë.

14. Në rast se do të shikojmë nenin 135 të Kushtetutës së ndryshuar, konstatojmë se do të jone Gjykatat e Posaçme ato të cilat do të gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër subjekteve të posaçëm si Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorët të Përgjithshëm, Inspektorët të Lartë të Drejtësisë, Kryetarët të Bashkisë, deputetët, zëvendësministrat, anëtarët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura, të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligje të posaçme, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

15. Për ngritjen dhe funksionimin e këtyre gjykatave u miratua ligji nr. 95/2016, ku në nenin 8 të tij parashikohet se: *“...kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë pikërisht ato që parashikohen në nenin 75/b të KpRP por nuk mund të tejkalojnë kompetencën e parashikuar në nenin 135 të kushtetutës”*. Ne nenin 57 Dispozita kalimtare të këtij ligji, ndërmjet të tjerash thuhet se: *“...5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie. 6. Në mënyrë që të respektohet e drejta e të pandehurve për një gjykim të drejtë, çështjet që do të jenë në gjykim para gjykatave për krimet e rënda në ditën e 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten nën kompetencën e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëse ato nuk bëjnë pjesë në kompetencën parësore apo dytësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas këtij ligji. Këto çështje ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme. 7. Në mesnatën e ditës së 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kompetencat e parashikuara nga nenet 8 dhe 9, të këtij ligji, u kalojnë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme. 8. Ligji nr. 9110, datë 24.7.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda”, shfuqizohet në mesnatën e ditës së 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. ...”*

16. Në analize të sa më sipër, del qartë se me anë të dispozitave tranzitore të shprehura në këtë ligj, ligjvënësi ka parashikuar se deri sa të fillojë të funksionojë Prokuroria e Posaçme (për

analogji dhe gjykata e posaçme), kompetente do te jete Prokuroria e Përgjithshme per veprat penale te parashikuara ne nenin 135/2 te Kushtetues (nen ky qe flet per subjektet e posaçme)sipas kompetencës dhe juridiksionit te parashikuar ne legjislacionin ne fuqi, para hyrjes ne fuqi te Ligjit 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” .

17. Pare ne këtë aspekt, nuk do te ishte normale qe Prokuroria e Përgjithshme, e cila vazhdonte funksionimin sipas ligjit te vjetër para hyrjes ne fuqi te ndryshimeve kushtetuese, te çonte çështjen e një subjekti te posaçëm ne gjykatën e shkalles se pare. Ne rast se ligjvënësi do te kishte dashur qe veprat penale te kryera nga subjektet e posaçme, para se te krijoheshin gjykatat e posaçme ti dërgonte ne një gjykatë tjetër per tu gjykuar, do ta kishte parashikuar një gjë te tille shprehimisht ne ligj, ne respektim edhe te parimit te “*gjykatës kompetente dhe te caktuar me ligj*”, sikundër e bëri në fakt me vone me ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës Së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ne ndryshimet qe ju bene K.Pr.Penale (por qe ende nuk kane hyre ne fuqi), pika 2 e nenit 75/b u shfuqizua dhe ne dispozitën tranzitore parashikohet se: “*Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore. 2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit. 3. Aktet dhe provat e marra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme dhe të përdorshme edhe në rastet kur ky ligj parashikon rregullime të ndryshme...*” .

18. Ne këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se përsa kohe te gjitha ligjet ekzistuese nuk ishin shfuqizuar, ato do te vazhdonin qe te aplikoheshin deri ne daljen e ligjeve te reja ose miratimin e ndryshimeve te ligjeve ekzistuese. Bazuar ne kete parim, vazhdoi funksionimi dhe i një sere organesh te tjera te rëndësishme kushtetuese, deri ne momentin qe dolën ligjet e reja qe rregulluan veprimtarinë e tyre dhe nga momenti qe ato hynë ne fuqi.

19. Ky Kolegj, vlerëson se persa kohe K.Pr.Penale i cili përcakton rregulla te qarta proceduriale ne lidhje me kompetencën e Gjykatës se Larte per gjykimin e subjekteve te posaçme, është ende ne fuqi ne momentin e gjykimit te kësaj çështje dhe njeri nga te pandehurit ka cilësinë e anëtarit te Gjykatës se Larte, atëherë ai është i zbatueshëm dhe ky Kolegj është kompetent per te shqyrtuar kete çështje penale.

20. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se është kompetent per te gjykuar, jo vetëm te pandehurën Majlinda Andrea por edhe katër te pandehurit e tjerë, bazuar kjo ne nenin 80/2 te këtij kodi, ku thuhet shprehimisht se: “*2. Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë dhe të tjerat në kompetencë të Gjykatës së Lartë, kompetente është kjo e fundit*”. Sa me sipër, vjen ne përputhje edhe me qëndrimin e konsoliduar tashme nga Gjykata Kushtetuese, ku në vendimin e saj nr. 62, datë 04.11.2016 ka parashikuar se: “*...Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë dhe të tjerat në kompetencë të Gjykatës së Lartë, kompetente është kjo e fundit.*” ... “*nëse do të pranohej që në raste të tilla të ishte kompetente një gjykatë më e ulët, për shkak të cilësisë së ndryshme të personave të akuzuar, atëherë kjo do të binte ndesh me parashikimin kushtetues të nenit 141/1, i cili ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si gjykatë të shkallës së parë për gjykimin e një kategorie të caktuar çështjesh penale dhe që si i tillë nuk mund të anashkalohet apo të mos respektohet nga dispozita ligjore. Për pasojë, çënimi i së drejtës së ankimit për një kategori*

subjektesh, për shkak të zbatimit të nenit 80/2 të K.Pr.P-së, buron drejtpërdrejt nga ky parashikim kushtetues. Balanca mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të tjerëve është siguruar nga gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së ankimit dhe interesit të dhënies së drejtësisë, që realizohet me anë të zhvillimit të një procesi të drejtë ligjor... Po ashtu, mjete i përdorur nuk është joproportional, pasi në raste të tilla Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen duke vepruar si një gjykatë fakti, duke zbatuar për sa është e mundur rregullat e gjykimin në shkallë të parë dhe duke respektuar të gjitha kërkesat për një proces të rregullt ligjor, si e drejta e mbrojtjes, e barazisë së armëve e kontradiktoritetit në gjykim, dhe duke marrë vendimin në bazë të vlerësimit të provave të administruara....”.

21. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, konstaton në të njëjtën kohë se mund të vazhdojë gjykimin e kësaj çështje, pa marrë autorizimin e ndonjë organi të posaçëm, pasi nuk jemi para asnjërës prej rasteve të parashikuara nga neni 288 i K.Pr.Penale (ndryshuar ky i fundit me ligjin nr. 21/2014).

22. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i dha mundësinë të pandehurve që të realizonin mbrojtjen e tyre nëpërmjet përfaqësimit me avokatë, të cilët u deklaruan në seancën e datës 05.12.2016 (shiko procesverbalin e datës 05.12.2016). Në këtë seancë, Av. Theodhori Sollaku deklaroi para gjykatës se ishte pajisur me prokurë të posaçme nga e pandehura Majlinda Andrea, ku i jepeshin të gjitha tagrat për ta mbrojtur atë në prezencë apo në mungesë të saj (akti është i administruar në dosje). Ai deklaroi se ishte i pajisur me prokurë të posaçme për të përfaqësuar edhe të pandehurin Petraq Dashi, në prani apo në mungesë të tij. Po në seancën gjyqësore të datës 05.12.2016 i pandehuri Ilia Çabiri ka deklaruar para gjykatës se do të përfaqësohet në këtë gjykim, në prezencë apo mungesë të tij nga Av. Ndue Pjetra dhe Av. Gentiana Qendro, ndërsa e pandehura Eleni Lino, ka deklaruar se do të përfaqësohej në këtë gjykim, në prezencë ose në mungesë të saj nga Av. Sokol Mëngjesi.

23. Ndërkohë për të pandehurin Odhise Andrea, në seancën e datës 05.12.2016 është vendosur gjykimin në mungesë të tij, pasi siç rezulton nga vendimi nr. 16/2, i datës 05.10.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është “deklaruar ikja e personit nën hetim Odhise Andrea”. Në këto kushte gjykata vendosi të caktojë kryesisht një mbrojtës dhe konkretisht Av. Ardian Visha (shih procesverbalin e datës 05.12.2016).

24. Te pandehurit, siç rezulton nga të gjitha procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Lartë, janë njoftuar rregullisht për datën dhe orën e gjykimin duke u paraqitur në seancë sipas vlerësimit të tyre, vetë ose nëpërmjet avokatit të tyre. Gjykata në çdo rast ka zhvilluar të gjitha seancat gjyqësore në respektim të nenit 352 të K.Pr.Penale, duke i zhvilluar ato në prani të mbrojtjes së të pandehurve, fakt ky që vërtetohet dhe nga të gjitha procesverbalet e seancave. Në çdo rast, Gjykata i dha mundësinë të pandehurve të merrnin pjesë personalisht në gjykim, si dhe të dëgjoreshin në respektim të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.Penale.

NGA HETIMI GJYQËSOR I ZHVILLUAR REZULTOI SE:

25. Tre të pandehurit në këtë procedim, Petraq Dashi, Ilia Çabiri dhe Eleni Lino, ishin të interesuar të përfitonin një sipërfaqe toke prej 40 ha, të ndodhur në rrethinat e Ksamilit, Sarandë. Kjo prone vinte si trashëgimi nga ish pronari Spiro Mihal Gjoka. Bashkëshortja e të pandehurit Petraq Dashi dhe e pandehura Eleni Lino, rezultonin në rrethin e trashëgimtareve të ish pronarit Spiro Mihal Gjoka dhe ishin përfitues të kësaj prone, në pjesën që u takonte me ligj. Ndërsa i pandehuri Ilia Çabiri pretendonte të përfitonte pjesë nga kjo prone, si person i cili ishte autorizuar me prokurë nga bashkëpronaret për të kryer të gjitha veprimet e domosdoshme ligjore për kthimin

e saj nga AKKP Tirane. Ne kompensim te punës qe ai do te kryente, bashkëpronaret kishin rene dakort qe do ta shpërblenin atë me një sasi te caktuar toke.

26. Ndërkohe dy te pandehurit e tjerë ne kete gjykim, Odhise dhe Majlinda Andrea janë bashkëshorte, ku kjo e fundit, rezulton te jete kushërire me te pandehurin Petraq Dashi (baballarët kushërinj te pare) dhe aktualisht me detyre Anëtare e Gjykatës se Larte.

27. Me qellim përfitimin e kësaj prone sipas parashikimeve të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave (nr. 9235/2004 i ndryshuar), trashëgimtarete ligjore te ish pronarit Spiro Mihal Gjokes kishin plotësuar dhe depozituar dokumentacionin ligjor pranë AKKP Tiranë. Ne mënyre qe prona te njihej dhe kthehej përfundimisht nga ky organ, ata ishin te detyruar qe te përfundonin edhe procesin civil qe kishin filluar me objekt vërtetimin e fakti juridik për *“Përcaktimin e kufijve për sipërfaqen 40 ha te ndodhur në Ksamil”*. Ky proces kishte përfunduar ne dy shkallet e gjykimit dhe rezulton qe çështja te ishte regjistruar per gjykim ne Gjykatën e Larte. Me vendimin nr. 23-2012-50 (40), datë 04.09.2012 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Sarande, ishte vendosur: *“Vërtetimi i faktit juridik duke saktësuar vëndndodhjen dhe kufijtë e pronës së pretenduar të ish pronarit Spiro Mihal Gjoka, prej 40 ha.”* Ky vendim gjyqësor ishte lënë në fuqi me vendimin nr. 118, datë 04.03.2014 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe çështja ishte regjistruar ne datën 21.11.2014 në Gjykatën e Lartë, ne pritje te gjykimit te saj, pasi ishte paraqitur rekurs ndaj vendimit te Gjykatës se Apelit Gjirokastër nga ish-Komuna Ksamil dhe Avokatura e Shtetit.

28. Rezulton qe ne datën 20.05.2016, Oficeri i Policisë Gjyqësore ne Prokurorinë pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krimet e Renda Z. Petrit Gjeçaj, informon kete organ se i pandehuri Ilia Çabiri, marrjen e kësaj prone kërkonte ta realizonte nëpërmjet veprime korruptive qe do ti kryente si me punonjësit e AKKP-se ashtu edhe me punonjësit e organeve te drejtësisë. Sipas informacioneve qe ai kishte siguruar nga burime te sigurta, ky i pandehur i kishte përfituar vendimet civile te përmendura me lart ne favor te tij, nëpërmjet veprimeve korruptive qe kishte kryer me gjyqtaret e Gjykatës se Shkalles se Pare dhe Gjykatës se Apelit dhe ishte duke vazhduar përpjekjet per arritjen e qëllimit te tij, duke u takuar me punonjës dhe drejtues te AKKP ne Tirane.

29. Ne datën 03.06.2016, ky oficer ka referuar përsëri ne Prokurorinë pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krimet e Renda, duke e informuar përsëri kete organ per veprimet qe po vazhdonte te kryente i pandehuri Ilia Çabiri, duke i kërkuar këtij organi kryerjen e një hetimi me te specializuar dhe me mjete me te specializuara, me qellim mbledhjen e provave te nevojshme dhe provimin e autorësisë se veprës penale per te cilën ai dyshonte se po kryhej. Per kete qellim ai ka kërkuar te kryhet përgjimi i komunikimeve dhe bisedave telefonike qe mund te bëheshin nga numri i telefonit celular 0697612754, qe i përkiste te pandehurit Ilia Çabiri.

30. Bazuar ne informacionin e mësipërm, Prokuroria pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krimet e Renda, me urdhrin e datës 23 Maj 2016 ka urdhëruar: *“1) Të kryhet regjistrimi penal për veprën penale “korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, si dhe për veprat penale “korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga nenet 245 dhe 260 i Kodit Penal”. 2. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim, i shtetasit Ilia Çabiri..., si i dyshuar për veprat penale “korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe “korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga nenet 319 dhe 245 të Kodit Penal...”*

31. Pas regjistrimit te procedimit penal te mësipërm, si dhe regjistrimit te emrit te pandehurit Ilia Çabiri ne regjistrin e njoftimit te veprës penale, ne cilësinë e “*personit nen hetim*”, me vendimin e datës 03.06.2016 te Prokurorit pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krimet e Renda është lejuar përgjimi i menjëhershëm i bisedave dhe komunikimeve telefonike te numrit te telefonit ne përdorim te shtetasit Ilia Çabiri. Ne te njëjtën kohe, ky organ ka paraqitur ne datën 03.06.2016 dhe kërkesën “Per vleftësimin e vendimit per lejimin e përgjimeve” pranë Gjykatës se Shkalles se Pare Per Krime te Renda, e cila me vendimin nr. 386, datë 04.06.2016 ora 09.00, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe vleftësimin si të ligjshëm të vendimit të prokurorit datë 03.06.2016 për përgjimin telefonik të numrit celular 0697612754, dhe lejimin e përgjimit të këtij numri për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar ky afat nga data 03.06.2016 ora 10.00.

32. Nga vënia ne përgjim e numrit te telefonit celular te pandehurit Ilia Çabiri, ka rezultuar se ai se bashku me te pandehurit e tjerë, Petraq Dashi dhe Eleni Lino po përpiqeshin qe te përfitonin pronën e mësipërme nëpërmjet kryerjes se veprimeve korruptive si me punonjësit e drejtësisë, ashtu dhe me punonjësit e AKKP .

33. Rezulton e provuar qe **ne datën 4 Qershor 2016**, në orën 11.39 a.m., ditë e shtunë, i pandehuri Petraq Dashi nga numri i telefonit të tij 698513349, ka marre në telefon të pandehurin Ilia Çabiri në numrin e telefonit 697612754, ku midis te tjerash ne bisede ai i shpreh shqetësimin e tij per mospërfundimin ende te atij “ *muhabetit*” dhe se çdo bisede nga ana e tij, është bere ne rregull. Atij “*i kane premtuar se çdo gjë do shkoje mire*”, por ne mënyre qe muhabeti te përfundojnë duhet “*graso*”. Gjate bisedës, i pandehuri Petraq Dashi i thotë te pandehurit Ilia se kur ka folur me personat per sa i përket te ashtuquajturës “*graso*”, u ka thënë qe te mos jete ndonjë gjë e rende dhe ata i kane konfirmuar se janë gjera brenda logjikes. Ndërkohe nga ana tjetër, i pandehuri Ilia konfirmon ne bisede qe ai është dakord , se e di qe gjerat kështu funksionojnë dhe ai te vazhdoje bisedat.

34. Rezulton e provuar se, i pandehuri Ilia Çabiri **në datat 6, 7 dhe 15 Qershor 2016**, ka komunikuar disa here me disa punonjës te AKKP, duke u interesuar për fatin e dosjes që bashkëpronaret kishin depozituar aty. Nga biseda e zhvilluar mes tyre, vërtetohet se deri ne kete moment dosja ende nuk kishte marre rruge pranë këtij organi, ajo per momentin nuk dihet se ku ishte, pasi nuk po gjendej ne arshive dhe punonjësi i këtij institucioni i premtonte se do te interesohej per te dhe do ti kthente një përgjigje.

35. Ndërkohe, rezulton qe te pandehurit vazhdojnë ne ditët qe vijojnë komunikimin ndërmjet tyre, duke i raportuar njeri tjetrit çdo veprim qe ata kryenin. Kështu ne **datën 24 Qershor 2016**, në orën 9 e 35 minuta a.m., ditë e premte, i pandehuri Petraq Dashi ka marre në telefon të pandehurin Ilia Çabiri, ku përsëri e informon se nuk ka te reja dhe ai është ne pritje dhe i shqetësuar. Ai i thotë Ilias *se aty lart ai merret me njerëzit e tij* dhe se një mendje i thotë qe te *shkoje tek goca e xhaxhait ne shtëpi*, por ngaqë i kane thënë prit, është ne pritje. Ndërkohe, i pandehuri Petraq i thotë Ilias se erdhi finalja dhe ne korrik shpresojnë qe ta mbyllin. Per çdo te re qe do te kete, ai do ta informoj atë menjëherë dhe se ai muhabet do te shkoje mire.

36. Ne datën **6 Korrik 2016**, në orën 8 e 49 minuta a.m., ditë e mërkurë, i pandehuri Ilia Çabiri ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi, duke e pyetur se çfarë te reja kishin. Ky i fundit, i thotë se “*mikut i kishte çuar fjale me te jatin*” dhe përgjigjja qe kishte marre ishte se ende nuk qe mbyllur, por mos te kishte merak. Ndërkohe, i pandehuri Petraq i thotë Ilias se ishte shume i mërztur dhe i shqetësuar se perse nuk po mbyllej, ne një kohe qe muhabetet ishin “*bërë t’shqoqura, t’pjekura, t’sakta*”. Ndërsa Ilia nga ana tjetër ne bisede, mundohet ta qetësoje duke i

thëne se kështu e kane këto pune, kështu e kane gjykatat dhe se ai ka 4-5 vjet me këto pune, poshtë e larte.

37. Bazuar ne te dhënat e dala nga bisedat e mësipërme, nga ku rezulton se krahas Ilia Çabirit tashme kishte dhe persona te tjerë te implikuar ne kryerjen e veprimeve korruptive per te përfituar kete prone, Prokurori ne Prokurorinë pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda, me vendimin e datës 07.07.2016, ora 12.00 lejoi përgjimin e menjëhershëm te bisedave dhe komunikimeve telefonike te numrit te telefonit celular ne përdorim te shtetasit Petraq Dashi, duke i kërkuar Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda “*Vleftësimin si te ligjshëm te vendimit te prokurorit dt 07.07.2016 me te cilin ishte vendosur lejimi i përgjimit te bisedave dhe komunikimeve telefonike per nr e telefonit celular te mësipërm per një afat 15 ditor*”. Ka rezultuar qe Gjykata e Shkalles se Pare per Krimet e Renda me vendimin nr. 465, datë 07.07.2016 ora 14.30, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe vleftësimin si të ligjshëm të vendimit të prokurorit datë 07.07.2016 ora 12.00 për përgjimin telefonik të numrit celular 0698513349, dhe lejimin e përgjimit të këtij numri për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar ky afat nga data 07.07.2016 ora 12.00.

38. Pas vënies ne përgjim te numrit te telefonit te te pandehurit Petraq Dashi ka rezultuar se , **ne datën 7 Korrik 2016**, ditë e enjte, i pandehuri Petraq Dashi është takuar me te pandehurin Odhise Andrea ne Rrogozhinë, në orën 12 e 43 minuta p.m. Menjëherë sapo është ndare nga ky i pandehur ne orën 12.58, pra afërsisht rreth 15 minuta me vone, i pandehuri Ilia Çabiri e merr në telefon të pandehurin Petraq Dashi ku midis te tjerash e pyet dhe “*se sa është kostua*”. Ndërkohe, i pandehuri Petraq i thotë se duhet te takoheshin ne Gjirokastër nga ora 6-7 mbasdite, pasi këto nuk ishin muhabetete qe bëheshin ne telefon dhe se “*o behet kete jave qe vjen o s’behet*”. Po ne datën **7. Korrik 2016** dy te pandehurit komunikojnë përsëri me njeri tjetrin dhe konkretisht ne orën 12:58 dhe orën 13:00. Nga bisedat e bëra mes tyre, del se ata e lëne qe te takohen te tre Petraqi, Ilia dhe Eleni, të nesërmen në drekë në Gjirokastër, tek e pandehura Eleni Lino për të biseduar më konkretisht për “*koston*”.

39. Menjëherë pas bisedave te zhvilluara mes dy te pandehurve po ne datën **7.7.2016 ora 13.13**, i pandehuri Petraq Dashi merr ne telefon të pandehurën Eleni Lino per ta informuar ne lidhje me faktin qe do takoheshin te nesërmen ne Gjirokastër nga ora 11-11:30 per te biseduar nga afër dhe se kishte lajme te mira. Ndërkohe, e pandehura Eleni i përgjigjet se është dakorte qe te takohen te nesërmen ne Gjirokastër dhe te bisedojnë te tre.

40. Menjëherë sapo ka përfunduar bisedën me të pandehurin Petraq Dashi, e pandehura Eleni Lino ne orën 13:19 ka marre ne telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Ky i fundit, i thotë se do takohen te bisedojnë per “*çështjen qe është ne Gjykatën e Larte dhe konkretisht per “Koston*”. Ilia i konfirmon Elenit se Petraqi i ka thëne se ka lajme te mira, por qe biseda nuk mund te zhvillohet ne telefon. Ata duhet te takoheshin me qellim qe te bisedojnë per koston, pasi tashme ajo nuk mund te jete 2000-3000 euro –thote Ilia , por është me shume dhe se ai ende nuk e di se sa kane kërkuar. Ndërkohe ne bisede, Ilia i shqetësuar i thotë Elenit se deri tani ai ka harxhuar një shume te konsiderueshme, ndërkohe qe Eleni i thotë se te gjithë shpenzimet qe ai ka bere deri tani per kete çështje duhet tja thotë Petraqit dhe se ajo vete është ne pamundësi per te paguar shumën qe mund tu kërkohe, por do te bisedoje edhe me motrat dhe vëllezërit per te kontribuar. Ilia i thotë se tani është fundi dhe ata duhet te bëjnë një sakrifice, pasi u ikën dem 10 vjet pune, ndërkohe qe Eleni i përgjigjet se është dakorte qe shumën ta japë dhe dikush tjetër dhe ata rregullohen me vone me njeri tjetrin.

41. Rezulton se te pandehurit kane vazhduar ne mënyre konseguente përpjekjet e tyre per realizimin e qëllimit qe kane pasur dhe kete e tregojnë dhe bisedat dhe veprimet konkrete qe ata

kane kryer ne ditët ne vijim. Ne **datën 8 Korrik 2016**, ora 7 e 56 a.m., i pandehuri Ilia Çabiri ka marre ne telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga biseda e zhvilluar konfirmohet fakti se i pandehuri Petraq Dashi do shkonte atë ditë në Gjirokastër rreth orës 11:30 - 12.00, për t'u takuar me dy të pandehurit Eleni Lino dhe Ilia Çabiri

42. Tre te pandehurit janë takuar ne dt **8. Korrik 2016** ne qytetin e Gjirokastrës, ne dyqanin e te pandehurës Eleni Lino. Menjëherë pasi ka mbaruar takimi, i pandehurit Petraq Dashi ka folur ne telefon me një shtetas me emrin Malo ku i thotë se sa ishte ndare me dy te pandehurit e tjerë dhe se ata i kishin thënë qe skishin mundësi te paguanin dhe se ai ishte ne siklet, pasi nuk kishte ku ta gjente per 3-4 shumën qe kërkohet. Ndërkohe, Petraqi i thotë bashkëbiseduesit se i kishte thënë Ilias qe te mblidhte bashkëpronaret e tjerë per tu kërkuar edhe atyre te kontribuonin dhe ne rast se nuk do te kontribuonin me leke, tu zbritej kontributi nga sipërfaqja e tokës qe ata do te përfitonin.

43. Ne datën **8 Korrik 2016**, në orën 20 e 58 p.m., i pandehuri Ilia Çabiri, ka folur ne telefon me një shtetas te quajtur Xhorxhi, te cilit i thotë se duhen dhëne leket përpara, ne mënyre qe te jepet vendimi. Kështu është vepruar dhe me pare. *“Leket duhet te jepen deri të martën, të mërkurën, dhe të premten merr vendimin”*. Xhorxhi e pyet se: *“çfarë garancie ka se mos japin leket dhe nuk marrin vendimin”*, por Ilia i përgjigjet se: *“ata nuk lozin me këto se është shume e madhe dhe kjo pune është me jete, vjen tjetri dhe te merr jetën dhe familjarisht”*, por duhet te mbledhin paratë.

44. **Me datën 9 Korrik 2016**, ditë e shtunë, në orën 8 e 35 a.m., i pandehuri Ilia Çabiri ka marre ne telefonon të pandehurin Petraq Dashi dhe i thotë se ai ka biseduar me bashkëpronaret e tjerë per te mbledhë shumën per zgjidhjen e problemit, por ata nuk kane mundësi qe te kontribuojnë. Ndërkohe Petraqi i thotë se duhet te bisedoje me pronaret per te kontribuar ne toke (ha) dhe ti ktheje një përgjigje atij deri ne darke, para se ky i fundit te takojë njerëzit per tu kthyer përgjigje, pasi ata dhe mund te lëviznin ne Itali etj.

45. Rezulton qe po te njëjtin shqetësim ka pasur edhe e pandehura Eleni Lino, e cila ne datën **9 Korrik 2016**, në orën 12 e 20 p.m., i ka telefonuar te pandehurit Ilia Çabiri per te marre vesh se çfare kishte bere ai me bashkëpronaret e tjerë dhe çfare ka arritur. I pandehuri Ilia i konfirmon se ende nuk ka bere gjë, por deri ne darke do te kishte një përgjigje.

46. Ndërkohe Prokuroria pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda, nisur nga te dhënat e siguruara deri ne kete moment, krijoi dyshimin e arsyeshëm se i pandehuri Odhise Andrea mund te ishte ndërmjetësi per procesin gjyqësor qe pritej te zhvillohej ne Gjykatën e Larte. Ky organ me vendimin e saj te datës 9 Korrik 2016, vendosi: *“Lejimin e menjëhershëm te përgjimit te nr te tel te Odhise Andreas per një afat prej 15 ditësh.....duke ju drejtuar me kërkesë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda per vleftësimin si te ligjshme te këtij vendimi...”*. Ndërsa, Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, me vendimin nr. 468, te datës 09.07.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe vleftësimin si të ligjshëm të vendimit të prokurorit datë 09.07.2016 ora 09.00 (të autorizimit) për përgjimin telefonik të numrit celular 0694083111, dhe lejimin e përgjimit të këtij numri për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar ky afat nga data 09.07.2016 ora 09.00.

47. Ne vazhdim te komunikimeve mes te pandehurve ne datën **10 Korrik 2016**, ditë e diel, ora 7 e 30 a.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marre në telefon të pandehurin Ilia Çabiri per ta pyetur se çfare beri me bashkëpronaret e tjerë. I pandehuri Ilia, i përgjigjet se ka bere debate me ta dhe se ata i ishin betuar se nuk kishin mundësi per te paguar. Pas kësaj, Ilia i thotë se ja u kishte bere te qarte bashkëpronareve te tjerë se do tu ulte sipërfaqe toke nga pjesa qe u takonte te merrnin dhe se kete pune me bashkëpronaret e merrte ai përsipër dhe e rregullonte ai. Ndërkohe është provuar ne

gjykim se ne datën **10 Korrik 2016**, te pandehurit Odhise dhe Majlinda Andrea kane hyre ne territorin shqiptar nga Greqia ku kishin udhëtuar ne datën 08.07.2016 me automjetin e tyre me targa AA307LT nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Bota, në orën 15:16 p.m.

48. Po ne datën **10 Korrik 2016** ne orën 18.35 p.m i pandehuri Petraq Dashi ka marre ne telefon te pandehurin Ilia Çabiri ku i *thotë se kishte folur direkt me mikun, i kishte bere propozimet dhe ai i kishte thënë se personi nuk pranon as me toka as me gjë tjetër, po i do te thata dhe e vetmja gjë që na bëri është që nga 60 na e çoi 50*. Kete gjë do tja konfirmonte edhe Lenices. Ndërkohe Petraqi vazhdon ti thotë Ilias i shqetësuar se nga do dalin leket qe do te japin dhe Ilia përgjigjet se nuk mund te kenë me shprese tek bashkëpronaret e tjerë, pasi ata nuk kane dhe duhet ti varin shpresat tek vetja e tyre. Petraqi i thotë se duhet te takohen te nesërmen ne Fier te tre, te bisedojnë dhe te vendosin per kete gjë.

49. Pas bisedës me Ilia, I pandehuri Petraq merr ne telefon Elenin po ne **dt 10.07.2016** ne orën 18:39 ku i thotë se ka folur me personin dhe se ai nuk kishte pranuar toke por donte leke te thata. I vetmi lajm i mire është se nga 60 e ka ul ne 50 dhe se ata duhet te takohen se bashku me Ilian (Yllin) te tre ne Fier. Ndërkohe, Petraqi i thotë se mund te rregulloje shumën duke e marre borxh nga një miku i tij, por ata duhet ta njohin kete borxh duke nënshkruar një akt noterial, ku do te deklarojnë se kete shume ia kane borxh Petraqit etj. E pandehura Eleni nga ana tjetër shprehet se është dakorte qe te marrin shumën e mësipërme, te rregullohen me vone me njeri tjetrin si dhe te shkoje ne Fier per te nënshkruar aktin noterial qe kërkon Petraqi. Petraqi i shpjegon Elenit ne bisede se sa me sipër kete shume qe do te paguhet tani, kërkon qe ta siguroje duke nënshkruar një akt noterial ne mënyre qe Ilia mos tia mohojte me vone, por tia ktheje atë qofte edhe me sipërfaqe toke kur te marre pjesën qe i kane premtuar bashkëpronaret e tjerë. Pas bisedës qe zhvillon me te pandehurën Eleni, po atë dite ne orën 20.36, i pandehuri Petraq mer ne telefon përsëri te pandehurin Ilia me te cilin bien dakord qe te nesërmen te takohen ne orën 10:00-10:30 ne Fier se bashku dhe me te pandehurën tjetër Eleni Linon per te biseduar dhe vendosur.

50. Te nesërmen **ne datën 11 Korrik 2016**, ditë e hënë, në orën 6 e 20 a.m., i pandehuri Ilia Çabiri është nisur per ne Fier. Pasi ka marre dhe te pandehurën Eleni Lino ne Gjirokastër ata janë takuar ne Fier me te pandehurin Petraq Dashi. Se bashku kane shkuar tek noterja Etleva Stamo, ku i pandehuri Petraq Dashi se bashku me Eleni Linon kane hyre ne zyre dhe i kane kërkuar kësaj te fundit te përpilonte një kontrate huaje ku i detyroheshin te pandehurit Petraq shumën prej 17.000 euro. Nisur nga vlera e konsiderueshme, noterja i ka orientuar dy te pandehurit qe te shkonin ne banke te bënin derdhjen perkatese dhe te paraqisnin tek ajo mandat pagesat. Te dy te pandehurit janë larguar dhe nuk janë kthyer me tek noterja.

51. Pasi kane dale nga zyra e noteres pa kryer ndonjë veprim dhe pasi kane biseduar me njeri tjetrin,(kane shkuar edhe ne shtëpinë e Petraq Dashit) të pandehurit Ilia Çabiri dhe Eleni Lino janë larguar me automjetin qe ata kishin ardhur kurse i pandehuri Petraq Dashi ka shkuar ne filialin e Raiffeisen Bank. Pak me vone ai ka shkuar tek pika e këmbimit valutor “Troka”, që ishte përballë Bankës dhe i ka kërkuar shtetasit Xhevahir Troka, i cili ushtronte profesionin e kambistit te kryenin një transaksion se bashku. Ai ka kërkuar nga Xhevahir Troka shumën prej 50 mijë euro ne cash dhe ne këmbim te kësaj shume, do te kalonte ne llogarinë e këtij te fundit shumën prej 6,850,000 leke (qe i përkiste shumës prej 50.000 euro sipas kursit te dites).

52. Petraq Dashi ka shkuar ne Raiffeisen Bank dhe ka bërë kalimin e shumës prej 6,850,000 lekë, nga llogaria e tij personale në llogarinë e shtetasit Xhevahir Troka dhe ky i fundit i ka dhënë atij ne zyrën e tij, shumën prej 50.000 euro ne cash te futura ne një qese te bardhe, e cila kishte dhe stampën e shoqërisë. Menjëherë sapo ka marre shumën e mësipërme, po brenda ditës ne orën 12:38 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marrë në telefon të pandehurin Odhise Andrea ku i ka

kërkuar që të takoheshin dhe e ka pyetur se si ishte me mire për të, në darke apo të nesërmen. I pandehuri Odhise i është përgjigjur se “*sa më shpejt, aq më mir, vap e madhe, ikin njerëzit*”. Pas kësaj i pandehuri Petraq i ka thënë se do të vinte po atë mbasdite në orën 6-7 dhe do të takoheshin.

53. Në orën 17 : 30 mbasdite (po në datën 11 Korrik 2016) i pandehuri Petraq Dashi është nisur nga qyteti i Fierit për të takuar me të pandehurin Odhise Andrea. Në orën 19 : 12, i pandehuri Petraq Dashi ka mbërritur në Tiranë ku edhe ka takuar të pandehurin Odhise Andrea, i cili po e priste në rrugë. Të dy kanë hyrur në makinë dhe kanë ndaluar në rrugën “Margarita Tutulani”, në afërsi të një lokali të quajtur “Harli Cafe”. Kane zbritur nga automjeti dhe i pandehuri Petraq Dashi ka pasur me vete dhe të njëjtën qese plasmasi të marra nga agjencia “Troka”, e cila kishte brenda shumë 50 mijë euro. Dy të pandehurit janë ulur dhe kanë qëndruar në ambientet e jashtme të lokalit “Harli Cafe”. Me vone ata janë ngritur dhe i pandehuri Petraq Dashi i ka dhënë të pandehurit Odhise Andrea qesen e plasmasit, që ai mbante. Të pandehurit janë ndare, ku i pandehuri Odhise Andrea ka shkuar në banesën e tij që ndodhej pas lokalit “Harli Cafe”, ndërsa i pandehuri Petraq Dashi është nisur për t’u kthyer në Fier.

54. Pasi është ndare nga i pandehuri Odhise Andrea në orën 19 : 44, i pandehuri Petraq Dashi ka folur në telefon me vajzën e tij Sonela Dashi ku i thotë se ishte në Tiranë, pasi *erdhi ti sillte atë porosinë atij shokut* dhe se ai shoku i kishte thënë *që kete jave mbyllej dhe e merrte në dorë*.

55. Pas marrjes së të dhënave të mësipërme nisur nga dinamika e hetimeve dhe kronologjia e kryerjes së veprimeve nga ana e shtetasve të mësipërm, si dhe faktit që çështja civile konkrete mund të merret në shqyrtim brenda asaj jave, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Pare për Krime të Renda ka çmuar se ekzistonin dyshime të arsyeshme dhe të bazuara se personi i dyshuar Odhise Andrea, mund të transmetonte komunikime nga bashkëshortja e tij, e cila ishte në detyrën e anëtares së Gjykatës së Lartë dhe kishte në përdorim numrin e telefonit celular 0692027672. Në këto kushte, me vendimin e saj të datës **11 Korrik 2016** ky organ ka vendosur lejimin e menjëhershëm të përgjimit të këtij numri.

56. Të nesërmen në **dt 12.Korrik 2016** ditë e martë, nga ora 10.00 deri në orën 12.00, është mbledhur në dhomë këshillimi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët Artan Broci, Admir Thanza dhe e pandehura Majlinda Andrea, për të shqyrtuar dosjet e përgatitura nga ndihmësit e gjyqtarëve Admir Thanza dhe të pandehurës Majlinda Andrea. Një ndër çështjet që është diskutuar ka qenë dhe çështja civile me objekt “*Përcaktimi i kufijve për sipërfaqen 40 ha e ndodhur në Ksamil*”. Relacioni para trupit gjykues është prezantuar nga ndihmësi ligjor i gjyqtarit Admir Thanza, shtetasi Adnand Berdica. Në përfundim është vendosur mospranimi i rekursit, sepse është gjykuar nga ky trup gjykues se, në rekurs ishin paraqitur pretendime të natyrës vlerësim provash, që nuk janë kompetencë shqyrtimi nga Gjykata e Lartë.

57. Ndërkohe, po në datë **12.7.2016** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Pare për Krime të Renda i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Shkalles së Pare për Krime të Renda, duke i kërkuar vlefhtësimin si të ligjshëm të vendimit të prokurorit për përgjimin e numrit të telefonit celular 0692027672, në përdorim të shtetasës Majlinda Andrea. Gjykata e Shkalles së Pare për Krime të Renda, me vendimin nr. 477, të datës **13 Korrik 2016** ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe vlefhtësimin si të ligjshëm të vendimit të prokurorit datë 11.07.2016 ora 21.00 (të autorizimit) për përgjimin telefonik të numrit celular 0692027672, dhe lejimin e përgjimit të këtij numri për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar ky afat nga data 11.07.2016 ora 21.00.

58. Në datën **12 Korrik 2016**, në orën 17: 36 p.m., e pandehura Eleni Lino ka marrë në telefon të pandehurin Petraq Dashi, duke e pyetur se si kishte shkuar. I pandehuri Petraq i përgjigjet se “*i kishte çuar ato*” dhe ishte në pritje “*nesër, pasnesër ose brenda javës ta merrnin në dorë*”.

59. Ka rezultuar gjithashtu e provuar se, pas përfundimit të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, dy të pandehurit Odhise dhe Majlinda Andrea janë vene në dijeni të faktit se ka filluar një procedim penal dhe i pandehuri Petraq Dashi ka qene në përgjim dhe vëzhgim nga policia. Në këto kushte, i pandehuri Odhise nuk i është përgjigjur me të pandehurit Petraq Dashi në telefon edhe pse ai në datën **13 Korrik 2016** dhe në datën **14 Korrik 2016**, e ka marrë disa here atë .

60. Ka rezultuar që në datën **14 Korrik 2016**, e pandehura Majlinda Andrea ka komunikuar në telefon me të pandehurin Odhise Andrea (nëpërmjet telefonit celular të birit), i cili ka qene me të birin në makinë duke shkuar për në Fier. E pandehura Majlinda, i thotë të shoqit se informacioni që kanë marrë është i sakte dhe atë ja kanë konfirmuar edhe persona të tjerë që *“dosja është atje dhe që ka dalë rastësisht nga një ceshtje tjetër”*. Ndërkohe ajo i thotë që të kryejë me kujdes veprimet se ai mund të jetë dakord. Ndërkohe edhe i pandehuri Petraq Dashi nga ana tjetër, po në këto dite mbasdite, i shqetësuar se nuk po arrinte të komunikonte dot në telefon me Odhisene, nisët për në Tiranë për ta takuar atë. Rugës për në Tiranë, ai merr një telefonatë nga numri i telefonit celular 693520130 që po përdorej nga i pandehuri Odhise Andrea, i cili e njofton se ishte duke shkuar tek ai dhe se duhet të takoheshin. Petraqi i thotë se ishte nisur për tek ai, po po kthehej nga rruga dhe e len që të takohen për 10-20 min në Fier.

61. Pasi takohen me njëri tjetrin, të pandehurit Odhise Andrea dhe Petraq Dashi shkojnë tek zyra e noterit Durim Lekdushi. Aty, në prani të noterit Durim Lekdushi, hartojnë dhe firmosin një Deklaratë Noteriale, me nr. 1840 rep. dhe nr. 1045 kol., date 14.07.2016, nga përmbajtja e së cilës rezulton se shuma prej 50.000 euro ishte dhënë nga Petraq Dashi tek Odhise Andrea si ndihmë financiare, hua pa përqindje për shkak të lidhjes familjare që ata kishin dhe për shkak të aktivitetit tregtar që kryente Odhise Andrea në fushën e *“Tregtim Graniti”*, me kusht që kjo shume të kthehej në datën 31.12.2016.

62. Rezulton e provuar se një ditë më vonë, në **datën 15 Korrik 2016**, ditë e premte, në orën 20 : 36 p.m., e pandehura Eleni Lino ka marrë në telefon të pandehurin Petraq Dashi e cila e pyet nëse kishte ndonjë të re. I pandehuri Petraq i përgjigjet se gjërat janë pozitive, por nuk duhet të flasin me në telefon.

63. Në datën **15 Korrik 2016**, ora 8 e 45 p.m., të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë me automjetin me targë AA 307 LT, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar “Porti i Durrësit”, me linjën e tragetit “Bari – Durrës – Bari”, SNAV LAZIO, me drejtim Italinë.

64. Në datën **16 Korrik 2016**, ditë e shtunë, ora 2 e 56 p.m., rezulton se një shtetase me emrin Lona, merr të pandehurin Odhise Andrea duke e pyetur se ku ndodhej. Nga biseda del qarte që personat njihen me njëri tjetrin dhe se i pandehuri Odhise i përgjigjet se ai me urdhër të kryetarit të tij është larguar nga Shqipëria dhe e ka pyetur nëse ka ndonjë problem. Ajo i ka konfirmuar se ka një problem dhe se dikush donte të takohet me të dhe të pandehurën Majlinda në lidhje me këto problem. Në fund shtetasja me emrin Lona i thotë që *“te mos kthehet tani për tani”*.

65. Bazuar në faktet rrethanat dhe provat e mbledhura, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkalles së Parë për Krime të Renda, në datën **12 Korrik 2016** urdhëroi, regjistrimin në regjistër të emrit të personit që iu atribuohet vepra penale për shtetasit nën hetim Petraq Dashi dhe Odhise Andrea.

66. Në datën **14 Korrik 2016**, ky organ me vendim shpalli moskompetencën për këtë procedim penal, duke ja kaluar aktet Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë vendim, ky organ pasi bën gjithë kronologjinë e ngjarjeve arrin në konkluzionin se: *“ekzistojnë dyshime të arsyeshme se shtetasit Odhise Andrea dhe Majlinda Andrea në cilësinë e gjyqtarëve pranë Gjykatës së Lartë në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë konsumuar veprën penale të “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve,*

prokuroreve dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë” parashikuar nga neni 319/c dhe 25 te K.Penal”.

67. Bazuar ne sa me sipër, Prokuroria e Përgjithshme me Urdherin e datës 14.07.2016, ka urdhëruar: “1) Regjistrimin e procedimit penal nr. 4, datë 14.07.2016 në Regjistrin e Njoftimit të veprave Penale të Prokurorisë së Përgjithshme për veprat penale “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal dhe “korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal”. 2. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, të shënohet emri i personit nën hetim, Majlinda Andrea..., si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal”

68. Po kështu, ne datën **15.07.2016**, është urdhëruar nga Prokuroria e Përgjithshme që në regjistrin e njoftimit të veprave Penale të Prokurorisë së Përgjithshme të shënohet emri i personit nën hetim Eleni Lino..., si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal.

69. Bazuar ne sa me sipër, organi i akuzës iu drejtua me kërkesë Gjykatës se Larte si gjykatë kompetente, të cilës i kërkoi te vendoste ne lidhje me masat e sigurimit për të pandehurit e sipërcituar. Bazuar ne kërkesën e organit te akuzës ne lidhje me masat e sigurimit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendosi:

- Me vendimin nr. 17, datë 16.07.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur ndaj personit nën hetim Majlinda Andrea, masa e sigurimit personal “pezullimin e ushtrimit të detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë”.
- Me vendimin nr. 16, datë 16.07.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur ndaj personit nën hetim Odhise Andrea, masa e sigurimit personal “arrest ne burg”.
- Me vendimin nr. 15, datë 16.07.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur ndaj personit nën hetim Petraq Dashi, masa e sigurimit personal “arrest në burg”.
- Me vendimin nr. 19, datë 16.07.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur ndaj personit nën hetim Ilia Çabiri, masa e sigurimit personal “arrest ne burg”.
- Me vendimin nr. 18, datë 16.07.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur ndaj personit nën hetim Eleni Lino, masa e sigurimit personal “arrest në burg”.
- Me vendimin nr. 18/1, datë 18.07.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasen Eleni Lino, me masën e sigurimit “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale.

70. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, i zgjedhur me short per gjykimin e kësaj çështje filloi shqyrtimin e saj ne datën 5.12.2016. Ne kete seance, pasi u verifikua legjitimiteti i palëve dhe u gjet ai i rregullt, nga ana e mbrojtjes së të pandehurve u parashtruan konform nenit 354 të K.Pr.Penale disa kërkesa paraprake, të cilat do të renditen si me poshtë:

71. Nga ana e mbrojtjes së të pandehurës Majlinda Andrea, u parashtruan këto kërkesa paraprake:

a) Heqjen e masës së sigurimit “Pezullim të ushtrimit të detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë” për të pandehurën. Sipas pretendimeve të mbrojtjes kjo masë nuk mund të kalojë afatin 3 mujor referuar nenit 267/2 të K.Pr.Penale, ndaj nga data 16.10.2016 është plotësuar afati tre mujor i fillimit të zbatimit të masës ndaluese

b) Deklarimin si te papërdorshëm te rezultateve te përgjimit per te pandehurit Ilija Cabiri, Petraq Dashi dhe Odhisea Andrea si dhe te gjitha akteve qe kane rrjedhur nga këto përgjime

c) Deklarimin si absolutisht të pavlefshëm të akteve procedurale në ngarkim të të pandehurës M. Andrea (në cilësinë e subjektit të posaçëm) dhe konkretisht të vendimit nr. 477, datë 13.07.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe të Autorizimit datë 12.07.2016 të prokurorit “Për lejimin e përgjimit në vende publike të Odhise dhe Majlinda Andrea”, si dhe të procesverbaleve të kryerjes së përgjimeve.

72. Sipas mbrojtjes se te pandehurës Majlinda Andrea, vendimi i Gjykatës për Krimet e Rënda në lidhje me përgjimin e numrit te telefonit celular që i përkiste të pandehurit I. Çabiri, është marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale penale, konkretisht nenet 221/1/a të K.Pr.Penale. Nuk janë respektuar kufijtë e lejimit te parashikuar nga kjo dispozite. Vepra per te cilën akuzohen te pandehurit nuk ka maksimum 7 vjet dhe procedimi penal ka filluar vetëm mbi bazën e indicjeve dhe nuk është e bazuar ne prova. Organi i prokurorisë nuk ka u komunikuar vendimet e përgjimeve dhe as procesverbalet e përgjimit. Ne kundërshtim me ligjin, është edhe vendimi për përgjimin e numrit te telefonit celular në përdorim të pandehurës M.Andrea, një subjekt i posaçëm, ku në vështrim të nenit 128/1/a K.Pr.P, përbën një akt procedural absolutisht të pavlefshëm. Vendimi i përgjimit për këtë subjekt është marrë nga një gjykatë jo kompetente.

73. Nga ana e mbrojtjes së të pandehurit Odhise Andrea, u paraqitën këto kërkesa paraprake:

a) Deklarimin e pavlefshmërisë së akteve procedurale të përgjimeve. Këtë kërkesë mbrojtja e të pandehurit Odhise Andrea, e paraqiti nga pikëpamja formale si ankim kundër vendimit nr. 386, datë 04.06.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, si dhe të gjitha vendimeve të tjera që kanë pasuar këtë vendim. Sipas mbrojtjes, kjo ankesë duhet të shqyrtohet nga gjykata, pasi ka lidhje me pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe për këto ka një afat procedural. Mbrojtja përdor te njëjtat argumenta qe paraqiten dhe ne kërkesën e paraqitur nga avokati i te pandehurës Majlinda Andrea, ne lidhje me mosrespektimin nga ana e Gjykatës për Krimet e Rënda ne vendimin nr. 386, datë 04.06.2016, te kufijve te lejimit te parashikuar ne nenin 221/1/a te K.Pr.Penale. Sipas tij, nuk ka pasur asnjë provë që të justifikojë vënien në përgjim të telefonit celular të të pandehurit I. Çabiri dhe vepra per te cilin akuzohen, nuk është me shume se 7 vjet. Sipas tij, nga organi i akuzës nuk është bërë dallimi midis përgjimit parandalues dhe provave të cilat duhet të administrohen në kuadër të kërkesës së prokurorit për lejimin e përgjimit dhe që kanë për qëllim vërtetimin e akuzës.

b) Mbrojtja e këtij te pandehuri, kërkoi dhe zëvendësimin e masës se sigurimit per te, me arsyetimin se ai nuk është larguar me qellim, por u ndodh jashtë kufijve ne një udhëtim te planifikuar gjë qe vërtetohet nga provat e paraqitura. Ne momentin e paraqitjes se kësaj kërkesë, dosja është per gjykim ne Gjykate te Larte dhe nuk ka mundësi objektive qe i pandehuri te dëmtoje provat.

74. Edhe mbrojtja e të pandehurit Ilia Çabiri dhe Eleni Lino, mbështetën kërkesat e bëra nga avokatët e mësipërm, duke rezervuar të drejtën që të shpreheshin për kërkesa të tjera paraprake vetëm pasi trupi gjyqësor të shprehë njëherë në lidhje me sa më sipër.

75. Në seancën gjyqësore të datës 12.12.2016, prokurori Arben Kraja paraqiti qëndrimin e tij në lidhje me kërkesat paraprake të paraqitura nga mbrojtja e të pandehurve, në respektim të nenit 354/2 të K.Pr.Penale. Prokurori deklaroi se:

a) Të gjitha veprimet e oficerit të policisë gjyqësore janë konform ligjit dhe konkretisht konform nenit 30/1 të Kodit të Procedurës Penale (Funkcionet e policisë gjyqësore) dhe konform nenit 293 të Kodit të Procedurës Penale (Referimi i veprës penale të prokurorit). Të gjitha dyshimet e tij janë konfirmuar plotësisht. Nga hetimet e kryera në vijim, është krijuar bindja e plotë se veprat penale janë kryer nga personat që kemi sjellë si të pandehur për t'u gjykuar. Në të gjitha rastet, kërkesat e paraqitura nga prokuroria janë konsideruar të ligjshme dhe të bazuar nga Kolegji Penal, duke u miratuar pa asnjë kundërshtim.

b) Në lidhje me kërkesën paraprake të paraqitur nga mbrojtja e të pandehurës Majlinda Andrea për të shfuqizuar dhe shpallur të pavlefshëm vendimin nr. 386, datë 04.06.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, vendim që lejon përgjimin e komunikimeve për numrin e telefonit 0697612754, në përdorim nga i pandehuri Ilia Çabiri, ato janë paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga nënina 222/a, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale. Avokati i të pandehurës Majlinda Andrea, ka qenë në dijeni të faktit që ka një vendim që lejon përgjimin e numrit të telefonit në përdorim nga i pandehuri Ilia Çabiri, por dhe të faktit se mbi bazën e këtij vendimi janë vënë në përgjim dhe numrat e telefonit të pandehurit Petra Dashi (gjithashtu i mbrojtur prej tij) dhe të pandehurit Odhise Andrea (bashkëshorti i të pandehurës Majlinda Andrea që mbrohet prej tij), që nga data 05.09.2016. Pra data maksimale e paraqitjes së ankimit duhet të ishte data 15.09.2016. Ndërkohë ankimin kundër këtij vendimi e ka paraqitur në sekretarinë e Gjykatës së Lartë me datën 24.10.2016 (sipas shënimit me shkrim dore që ka ai vetë ka bërë mbi kërkesë), ose me datën 26.10.2016, sipas protokollit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë, ku është depozituar kërkesa. Pra kërkesa është paraqitur rreth 40 ditë pas marrjes së dijenit, ndërkohë që ligji parashikon që duhet paraqitur brenda 10 ditëve të marrjes së dijenit. Jashtë afatit 10 ditor është edhe ankimi i paraqitur nga avokati i të pandehurit Odhise Andrea, i cili është caktuar kryesisht nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 16/2, datë 05.10.2016, të këtij kolegji. Avokati i këtij të pandehuri është vënë në dijeni të vendimit që kundërshton në datë 07.10.2016, ndërkohë që ankimin kundër këtij të fundit e ka përgatitur me datën 19.10.2016 (kur duhej ta ushtronte që në datën 17.10.2016) e ka dorëzuar me shërbimi postar në datën 22.10.2016 (sipas vulës postare në zarf), si dhe e ka protokolluar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë me nr. 3994 prot., datë 24.10.2016.

c) Në lidhje me themelin e ankimit, argumentat e paraqitura nga mbrojtja janë të pabazuara në ligj. Vendimi i gjykatës që ka lejuar përgjimin e numrit telefonik në përdorim të pandehurit Ilia Çabiri, është në përputhje me ligjin. Referuar nenit 222/a, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, mbi bazën e të cilit, përfaqësuesit e të pandehurve kanë paraqitur ankimin, përcaktohet se ankimi kundër vendimit që lejon përgjimin mund të bëhet vetëm "*për shkelje të kritereve të parashikuara në nenin 221*", dhe jo për të vlerësuar faktin se sa prova ka patur organi procedues në dispozicion, në momentin kur ka vendosur lejimin e përgjimit. Nuk qëndron pretendimi i të pandehurve, se nga ana e organit të akuzës janë shkelur kriteret e përcaktuara në nenin 221/1 të Kodit të Procedurës Penale për lejimin e

përgjimit. Procedimi penal është regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 319, 319/ç, 245 dhe 260 të Kodit Penal. Nga të cilat, vepra penale e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, parashikon një dënim në maksimum deri në dhjetë vjet burgim, ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal parashikon një dënim në maksimum deri në dymbëdhjetë vjet burgim.

d) Në lidhje me kërkesën për pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 477, datë 13.07.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kjo e fundit duhet rrezuar si e pabazuar në ligj. Vendimi i prokurorit për të lejuar përgjimin e menjëhershëm të komunikimeve të telefonit në përdorim nga e pandehura Majlinda Andrea, si dhe vendimi i gjykatës që ka vleftësuar përgjimin dhe ka lejuar vazhdimin e tij, janë akte të nxjerra në bazë të nenit 221/3, gërma “b” dhe “c” të Kodit të Procedurës Penale, të cilat parashikojnë se lejohet përgjimi kundër personave që dyshohet se marrin apo transmetojnë komunikime nga i dyshuari, apo që dyshohet se marrin pjesë në transaksione me të dyshuarin. Neni 141/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 75/b/2 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktojnë se Gjykata e Lartë është kompetente të gjykojë vetëm akuzat kundër gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe jo çështje të tjera, ku mund të përfshihen subjektet e posaçëm.

e) Në lidhje me kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit ndaj të pandehurës Majlinda Andrea, kjo e fundit nuk është parashikuar në nenin 354/1, si kërkesa paraprake dhe që mund të shqyrtohen para hapjes së fazës së shqyrtimit gjyqësor. Pavarësisht sa me sipër vlerësoj se: Jemi në të njëjtat kushte si në momentin që u vendos masa e pezullimit. Procedimi penal akoma nuk ka filluar të shqyrtohet, provat akoma nuk janë paraqitur para gjykatës dhe vlerësuar prej saj. Në këto kushte, heqja e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurës Majlinda Andrea dhe kthimi i saj në detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Lartë do të përbënte, padyshim një shkak të rëndësishëm që do vinte në rrezik paraqitjen dhe vlerësimin e provave dhe ecurinë normale të procesit gjyqësor. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të urdhërojë përsëritjen e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurës Majlinda Andrea “*Pezullim i ushtrimit të detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë*”, deri në përfundim të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

f) Në lidhje me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” në mungesë, me një masë më të lehtë për të pandehurin Odhise Andrea vlerësojmë se nuk kanë ndryshuar kushtet nga momenti kur u vendos kjo masa.

g) Gjithashtu, referuar fazës procedurale në të cilën ndodhet kjo çështje, rezulton se ende nuk ka filluar shqyrtimi i provave, ato akoma nuk janë paraqitur para gjykatës dhe vlerësuar prej saj, zëvendësimi i masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit Odhise Andrea me një masë siguri më të lehtë, do të përbënte pa dyshim një shkak të rëndësishëm që do vinte në rrezik paraqitjen dhe vlerësimin e provave, si dhe ecurinë normale të procesit gjyqësor.

76. Ndërkohë, mbrojtësit e të pandehurit Ilia Çabiri në datën 05.12.2016 kishin depozituar pranë sekretarisë së Gjykatës së Lartë një kërkesë për gjykim të shkurtuar, bazuar në nenin 403 të K.Pr.Penale, kërkesë kjo e cila iu bë e ditur prokurorit në seancën gjyqësore të datës 12.12.2016, si dhe ju vu një kopje e saj në dispozicion. Në këtë kërkesë, mbrojtja e të pandehurit I. Çabiri, pretendonte se çështja në ngarkim të këtij të pandehuri mund të gjykohej në gjendjen në të cilat

ishin aktet shkresore dhe për këtë arsye, kërkuan gjykim të shkurtuar bazuar në nenin 403 të K.Pr.Penale.

77. Në seancën gjyqësore të datës **19.12.2016**, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konform nenit 348 të K.Pr.Penale, pasi kontrolloi paraqitjen e palëve dhe legjitimitetin e tyre dhe i gjeti ato në rregull vazhdoi gjykimin duke deklaruar vendimin e tij në lidhje me kërkesat paraprake të paraqitura nga mbrojtja e të pandehurve.

78. Në lidhje me kërkesën e të pandehurës Majlinda Andrea për shuarjen e masës së sigurimit ndaj saj, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e ndërmjetëm të datës 19.12.2016 konstatoi se kjo masë e vendosur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 17, datë 16.07.2016, e ka humbur fuqinë për shkak të kalimit të afatit tre mujor nga fillimi i zbatimit të saj, parashikuar në nenin 267/2 të K.Pr.Penale, sipas të cilit “Masat ndaluese e humbasin fuqinë kur kanë kaluar tre muaj nga fillimi i zbatimit të tyre”.

78/1. Ky Kolegj, arsyeton në vendimin e tij midis të tjerash se: “Në referim dhe vlerësim të akteve procedurale që ndodhen në dosje, rezultoi se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 17, datë 16.07.2016 ka vendosur: “Pranimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesi, Prokuroria e Përgjithshme, duke caktuar si masë sigurimi personal për shtetasen Majlinda Andrea, e bija e Andreas dhe Stavrullës, atë të “Pezullimit të ushtrimit të detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 242 të K.Pr.Penale”. Ky Kolegj, konstaton se nga dita e marrjes së vendimit të mësipërm dhe deri në ditën e paraqitjes së kësaj kërkesë pranë Gjykatës së Lartë (kërkesa është paraqitur nga kërkuesja nëpërmjet përfaqësuesit të saj në datë 17.10.2016) ka kaluar afati 3 mujor i parashikuar nga neni 267/2 i K.Pr.Penale, afat ky brenda të cilit, këto lloj masa kanë fuqi ligjore. Bazuar në sa më sipër, gjykata konstaton humbjen e fuqisë së saj, pasi kanë kaluar tre muaj nga fillimi i zbatimit të saj”.

79. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në lidhje me kërkimin për pavlefshmërinë absolute të disa akteve të procedimit dhe konkretisht: 1) Vendim nr. 386, datë 04.06.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda; 2) Vendim nr. 424, datë 18.06.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda; 3) Vendim nr. 398, datë 08.06.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda; 4) Vendim nr. 433, datë 22.06.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda; 5) Vendim nr. 465, datë 07.07.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda; 6) Vendim nr. 468, datë 09.07.2016 të Gjykatës së Krimeve të Rënda; 7) Autorizim i prokurorit datë 07.07.2016 për lejimin e përgjimit në vende publike; 8) Procesverbal i kqyerjes së përgjimeve në vende publike datë 12.07.2016; 9) Autorizim datë 11.07.2016 i prokurorit për lejimin e përgjimit në vende publike; 10) Raport shërbimi “Mbi veprimet e vëzhgimit të kryera në datë 11.07.2016”, si dhe dëgjoi qëndrimin e prokurorit në lidhje me të, në bazë të nenit 354/3 të K.Pr.Penale vendosi:

-Të rrëzojë këtë kërkesë si të pabazuar në ligj.

79/1. Ky Kolegj, arsyeton midis të tjerash se: “...kërkimi për pavlefshmëri absolute të akteve të mësipërme procedurale është e pabazuar në nenin 128 të K.Pr.Penale. Kjo gjykatë konstaton se të gjitha aktet e mësipërme procedurale, janë marrë nga organet e procedimit në respektim të parashikimeve të nenit 128 të K.Pr.Penale. Asnjë nga kushtet e parashikuara në shkronjat a, b dhe c të këtij neni nuk rezultoi që të mos jenë respektuar nga organet e procedimit. Nga shqyrtimi i këtyre akteve procedurale në këtë fazë gjykimi, nuk rezultoi që të jenë marrë nga organet e procedimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 128, të K.Pr.Penale, në të cilën parashikohet se: “1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: a) kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod; b) të drejtën e

prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim; c) thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme””.

80. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e kërkuases Majlinda Andrea dhe të avokatit të saj për pavlefshmërinë absolute të akteve të procedimit dhe konkretisht: 1) Vendimi nr. 477, datë 13.07.2016 i Gjykatës së Krimeve të Rënda; 2) Autorizim datë 12.07.2016 i prokurorit për lejimin e përgjimeve në vende publike të Odhise dhe Majlinda Andrea, si dhe të procesverbaleve të kryerjes së përgjimeve, si dhe dëgjoi qëndrimin e prokurorit në lidhje me të, në bazë të nenit 354/3 të K.Pr.Penale vendosi:

-Të rrëzojë këtë kërkesë.

80/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se: *“...bazuar në nenin 87, si dhe në nenin 221, paragrafi 3, gërma “b” dhe “c” të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: “Përgjimi mund të urdhërohet kundër: ... b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari; c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin; ...”, aktet procedurale të përmendura më lart nuk janë absolutisht të pavlefshme. Përsa i përket kërkesës së avokatit për papërdorshmëri të provave, gjykata çmon se kjo kërkesë do të merret në konsideratë mbasi të merren në shqyrtim aktet dhe provat e përfituara nga organet e procedimit”.*

81. Ne lidhje me kërkesën e paraqitur nga avokati per paperdorshmerine e provave, Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, po në vendimin e ndërmjetëm të datës 19.12.2016 ka vlerësuar se kjo kërkesë do të merrej ne konsiderate, pasi te merren ne shqyrtim aktet dhe provat e përfituara nga organet e procedimit.

82. Ne lidhje me ankimin e paraqitur nga avokati i të pandehurit Odhise Andrea, pranë Gjykatës se Larte në datë 22.10.2016 kundër vendimit nr. 386, datë 04.06.2016 “Për vleftësim përgjimi dhe lejim përkatës për nr. telefonik celular 0697612754” dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe tërësisë së akteve përgjuese që pasojnë këtë vendim, si dhe dëgjoi qëndrimin e prokurorit në lidhje me të, në bazë të nenit 354/3 të K.Pr.Penale vendosi:

-Të rrëzojë këtë kërkesë.

82/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se : *“...nga aktet procedurale rezulton që ky ankim është paraqitur jashtë afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 222/a, pika 1 e K.Pr.Penale në të cilin parashikohet se: “Kundër vendimit që pranon përgjimin mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga i interesuari që ka ardhur në dijeni të përgjimit për shkelje të kriterëve të parashikuara nga neni 221 i K.Pr.Penale”. Nga verifikimi i akteve të procedimit, rezulton se Avokati i të pandehurit Odhise Andrea, është caktuar kryesisht si i tillë me vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 16/2, datë 05.10.2016. Rezulton se në datën 07.10.2016 ai është njohur me aktin “Vendim për njoftimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur të shtetasit Odhise Andrea”, në të cilën evidentohet fakti që është lejuar fillimisht përgjimi i nr të tel 0697612754 në përdorim nga shtetasi Ilia Cabiri, dhe më vonë është proceduar për vënien në përgjim edhe të nr telefonik 0698513349 të shtetasit Petraç Dashi. Pavarësisht sa më sipër, rezulton se në datën 10.10.2016, sipas procesverbalit të mbajtur po në këtë datë nga OPGJ i titulluar “Për njohjen me materialet e dosjes”, avokatit i është dhënë mundësia për njohjen me materialet e dosjes dhe i janë vënë në dispozicion një kopje e akteve te dosjes. Nisur nga sa më sipër, rezulton se ankimi i paraqitur nga avokati i të pandehurit Odhise Andrea, është paraqitur jashtë afatit 10 ditor të parashikuar shprehimisht nga ligji, nga momenti që ai është vënë në dijeni të akteve procedurale që ai ankimon. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se kjo kërkesë duhet rrëzuar, pasi nuk qëndrojnë as shkaqet e paraqitura në këtë ankim. Në analizë të dispozitës së përmendur më lart, mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga i interesuari që ka ardhur në dijeni të përgjimit*

vetëm për shkelje të kritereve të parashikuara nga neni 221 të K.Pr.Penale dhe jo për çdo shkak tjetër. Gjykata nuk konstaton shkelje të kritereve të parashikuara në këtë dispozitë, përsa kohë në momentin e marrjes së vendimit nr. 386, datë 04.06.2016 nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Prokuroria për Krime të Rënda kishte regjistruar një procedim penal, i cili bënte fjalë për veprat penale të “Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç të K.Penal, si dhe veprat penale “Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendore” dhe “Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendor”, parashikuar nga neni 245 dhe 260 të K.Penal, vepra këto të cilat kanë një masë dënimi maksimum deri në 10 vjet”.

83. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e avokatit të të pandehurit Odhise Andrea për “Zëvendësimin e masës së sigurimit” të vendosur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 16, datë 16.7.2016”, si dhe dëgjoi qëndrimin e prokurorit në lidhje me të, në bazë të nenit 354/3 të K.Pr.Penale vendosi:

-Të rrëzojë këtë kërkesë.

83/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se: “Kjo gjykatë vlerëson se nuk kanë ndryshuar rrethanat dhe kushtet e përcaktuara nga neni 228 te K.Pr.Penale, mbi të cilat është bazuar edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kur ka marrë vendimin e tij nr. 16, datë 16.07.2016, me të cilin ka vendosur si masë sigurie për të pandehurin, atë të “Arrestit në burg”. Gjykata vlerëson se masa e sigurimit e vendosur nga gjykata i përgjigjet rëndësisë së faktit, si dhe sanksionit që parashikon vepra penale konkrete për të cilën ajo akuzohet. Nga aktet procedurale rezulton se i pandehuri vazhdon të jetë i larguar dhe ti fshihet gjykimit penal të kësaj çështje, duke bërë që të ekzistojnë kushtet ligjore të parashikuara nga neni 228/3, shkronja b të K.Pr.Penale”.

84. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga organi i akuzës në datë 17.12.2016, për përsëritjen e masës së sigurimit duke u urdhëruar: “Pezullimi i gjyqtarës Majlinda Andrea për ushtrimin e detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë deri në përfundimin e çështjes dhe dhënien e një vendimi përfundimtar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë”, si dhe dëgjoi qëndrimin e avokatit mbrojtës në lidhje me të, në bazë të nenit 354/3 të K.Pr.Penale vendosi:

-Të pranojë kërkesën për përsëritjen e masës së sigurimit personal për të pandehurën Majlinda Andrea, e bija e Andreas dhe e Stavrullës, duke caktuar si masë sigurimi personal atë të “Pezullimit të ushtrimit të detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes” në bazë të nenit 267/2 të K.Pr.Penale.

84/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se : “...caktimi i kësaj mase vazhdon të jetë e nevojshme për shkak se nuk kanë ndryshuar kushtet e parashikuara në nenin 228/3, gërma a dhe c të K.Pr.Penale mbi të cilat është marrë dhe vendimi me nr. 17, datë 16.07.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjykata vlerëson se pezullimi i të pandehurës Majlinda Andrea nga ushtrimi i detyrës, do të shmangte rreziqet e parashikuara nga dispozita e mësipërme. Gjykata vlerëson se masa e sigurimit e kërkuar nga prokurori i përgjigjet rëndësisë së faktit, si dhe sanksionit që parashikon vepra penale konkrete për të cilën ajo akuzohet. Në këto kushte, masa e sigurimit personal “Pezullimi i ushtrimit të detyrës” parashikuar dhe nga neni 242 i K.Pr.Penale vlerësohet si e mjaftueshme për tu vendosur nga gjykata”.

85. Pas shpalljes se vendimit te mësipërm, nga ana e mbrojtësve të të pandehurit Ilia Çabiri, u kërkuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë që ky i fundit të shprehej në lidhje me kërkesën e bere nga ky i pandehur për të pasur gjykim të shkurtuar.

86. Ndërkohe po ne kete seance gjyqësore, mbrojtësi i të pandehurës Eleni Lino kërkoj deklarimin e pavlefshmërisë së procesverbalit të deklarimeve nga personi ndaj të cilit zhvillohen

hetime, datë 17.07.2016, bazuar kjo në nenin 37, dhe 128/c të K.Pr.Penale. Ai parashtrori para trupit gjykues se: *“E pandehura është ndaluar në datë 16.07.2016 ora 23.20 në qytetin e Gjirokastrës. Të nesërmen në datë 17.07.2016 në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, është bërë marrja në pyetje e të pandehurës nga prokurori dhe OPGj-ja, në kundërshtim të plotë me parashikimet e nenit 128/c të K.Pr.Penale. Nga ana e organit të akuzës, të pandehurës Eleni Lino nuk i është bërë e ditur, e drejta e parashikuar nga neni 37 i K.Pr.Penale, për të caktuar një mbrojtës, fakt i cili cenon rëndë deklaratimet e dhëna nga ky person, për më tepër kur gjendemi para deklaratimeve që e rëndojnë atë me përgjegjësi penale”.*

87. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 19.12.2016, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e të pandehurës Eleni Lino, si dhe dëgjoi mendimin e organit të akuzës, i cili kërkoi rrëzimin e kësaj kërkesë, bazuar në nenin 331 dhe 332 të KPr.Penale vendosi:

-Rrëzimin e kërkesës.

87/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se: *“rezulton se ky akt procedural i cili kërkohet të deklarohet absolutisht i pavlefshëm ende nuk është bere pjesë e fashikullit të dosjes gjyqësore në këtë fazë të gjykimit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të dije apo të parashikojë nëse organi procedues, prokuroria do ta përdorë apo jo në të ardhmen këtë akt bazuar kjo në nenin 331 dhe 332 të KPr.Penale”.*

88. Në lidhje me kërkesën paraprake për gjykim të shkurtuar të paraqitur nga mbrojtja të pandehurit Ilia Çabiri pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (e shprehur më sipër në këtë vendim), ky Kolegj vlerësoi se në kushtet që në këtë procedim ka disa bashkë të pandehur, të cilët akuzohen për veprat penale të përmendura më lart në bashkëpunim, të shprehej në seancën e ardhshme, pasi të shikonte edhe qëndrimin e të pandehurve të tjerë për të cilët mbrojtja kërkoi kohë, për të formalizuar kërkimin konform rregullave të nenit 403 të K.Pr.Penale, si dhe për të përcaktuar qarte tagrat e përfaqësimit në lidhje me kete kërkim (kërkesë kjo e avokatit mbrojtjes të Odhise Andrea).

89. Ndërkohe rezultoi se në datën 09.01.2017, i pandehuri Odhise Andrea (për të cilin me vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ishte deklaruar ikja e personit nën hetim) u paraqit vullnetarisht pranë ambienteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Ky fakt provohet me procesverbalin e datës 09.01.2017 të depozituar pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë *“Mbi ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë Tiranë me nr. 16, datë 16.07.2016, për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Odhise Andrea, si dhe të Urdhërit të Prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal”.* Për këtë arsye, Prokuroria e Përgjithshme bazuar në nenin 246/1 dhe 248 të K.Pr.Penale, ju drejtua Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me kërkesën nr. 2245/44 prot, datë 10.01.2017 me objekt *“Dërgohet procesverbali për ekzekutimin e vendimit”*, për verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 16, datë 16.07.2016 të Gjykatës së Lartë Tiranë, me të cilin është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal *“arrest në burg”* ndaj shtetasit Odhise Andrea.

90. Në bazë të nenit 248/1 të K.Pr.Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 12.01.2017, përveç kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme për verifikimin e ekzekutimit të vendimit penal në lidhje me caktimin masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit Odhise Andrea, mori në shqyrtim edhe kërkesën e paraqitur nga ky i fundit për zëvendësimin e masës së sigurimit të caktuar ndaj tij nga *“arrest në burg”* në një masë më të butë si ajo *“arrest në shtëpi”*.

91. Në kete seance gjyqësore, mbrojtja e të pandehurit pretendoi se: *“I pandehuri ka ikur në kohën kur ndaj tij nuk ekzistonte asnjë lloj mase sigurimi personal dhe nuk mund të ishte në*

dijeni se ndaj tij do të vihej një masë e tillë. Rezultoi e provuar që i pandehuri me vullnetin e tij të lirë është vetëdorëzuar pranë organeve të drejtësisë dhe nuk ka më asnjë lloj mundësie që të largohet apo të mos përballet vetë më drejtësinë. Arsyeja për të cilën nga ana e organit të akuzës u kërkua që të vendoset si masë sigurie ajo e “arrestit në burg”, ka qenë pikërisht vetëm dyshimi se shtetasi Odhise Andrea rrezikon të ikë. Aktualisht ky rrezik nuk ekziston më dhe për këtë arsye referuar nenit 228 të K.Pr.Penale, kjo masë duhet të zëvendësohet me një masë tjetër më të butë”. Ndërsa vete i pandehuri Odhise Andrea, deklaroi se: “Nuk jam dakord me akuzat e ngritura nga organi i akuzës. Kam njohje me P.Dashin, pasi ky i fundi është kushëri i bashkëshortes sime dhe me të kam biseduar për të marrë hua një sasi lekësh për shkak të vështirësive që kisha me biznesin tim në ato momente. Këto veprime i kam kryer edhe herë të tjera. Veprimet e prokurorisë si ato të përgjimit nëpërmjet bisedave telefonike dhe ato të përgjimit ambiental, janë dashkaqe pasi nuk pasqyrojnë gjithë faktet dhe veprimet e kryera prej meje ato ditë, por vetëm fragmente të caktuara me qëllim implikimin tim dhe të bashkëshortes sime. Bisedat e mia janë vendosur në kontekstin që organi i prokurorisë ka dëshiruar...”.

92. Ne respektim të nenit 248/2 dhe 260 të K.Pr.Penale, pasi u dëgjua i pandehuri në lidhje me pretendimet e tij, gjykata ja dha fjalën prokurorit, i cili deklaroi se nuk kanë rënë shkaqet ligjore për të cilën ndaj këtij të pandehuri është vendosur masa e sigurimit personal “arrest në burg” dhe për këtë arsye, kjo kërkesë duhet të rrëzohet.

93. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 16/3, datë 12.01.2017 vendosi:

-Zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale me atë të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe në bazë të pikës 2 të po këtij neni, ndalohet i pandehuri të komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të.

-Urdhërohet Policia Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi në adresën: Rruga: “Margarita Tutulani”, Pall. “Pinari” 1, Tiranë.

93/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se : “...*(i) Fakti që i pandehur Odhise Andrea u vetëdorëzua në datën 09.01.2017, rreth orës 22.00 pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë..., tregon qartë se nuk ekziston më mundësia e largimit të tij, përse kohë vetë ky i pandehur me vullnetin e tij të lirë është dorëzuar para organeve të drejtësisë, duke shpjeguar para gjykatës edhe versionin e tij të fakteve dhe të rrethanave që pretendohet se kanë ndodhur; (ii) të gjitha provat të cilat mund të merreshin në lidhje me hetimin e kësaj çështje në fazën e hetimeve paraprake të hetimeve dhe që nuk mund të përsëriten më, janë marrë nga ana e organit të akuzës dhe nuk ka më asnjë lloj mundësie që i pandehuri Odhise Andrea të ketë mundësi efektive për ti prishur apo zhdukur ato. ...në gjendjen në të cilat ndodhen aktet, në kushtet ligjore në të cilat ndodhen të pandehurit e tjerë, si dhe me kufizimet që lejon neni 237/2 i K.Pr.Penale, i pandehuri Odhise Andrea nuk rrezikon më të prishi provat e marra apo të ndikojë në ndonjë lloj mënyre për të marrë prova të tjera; (iii) në vështrim të neneve 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, masa e sigurimit “arrest në burg” e dhënë në datën 16.07.2016 nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është e papërshtatshme në kushtet aktuale, pasi kjo masë nuk i përgjigjet rrezikshmërisë së të pandehurit Odhise Andrea, i cili është një person që ka punuar në strukturat e Policisë së Shtetit, është i pa dënuar dhe pa precedentë të mëparshëm penalë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson në këtë moment, nisur nga rrethanat e faktit dhe personaliteti i të pandehurit, nuk ka më rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të njëjtit lloj, me veprën penale për të cilin ai po procedohet...”.*

94. Në seancën gjyqësore të datës 13.01.2017, nga ana e mbrojtjes se te pandehurve Ilia Çabiri, Majlinda Andrea, Petraq Dashi dhe Eleni Lino u kërkua aplikimi i nenit 403 të K.Pr.Penale

per gjykimin e shkurtuar. Ndërkohe, trupi gjykues po ne kete seance, pyeti avokatin mbrojtës te pandehurit Odhise Andrea nëse dhe ky i fundit bashkohej me kete kërkim, por avokati nuk u shpreh per sa me sipër duke mos u bashkuar me kërkesën e te pandehurve te tjerë.

95. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 30.01.2017, Kolegji Penal i Gjykatës se Lartë, pasi vlerësoi kërkesat e palëve si dhe pretendimet e prokurorit ne lidhje me këto kërkesa, bazuar ne nenin 404 të K.Pr.Penale vendosi:

-Të rrëzojë kërkesën e të pandehurve, Majlinda Andrea, Petraq Dashi, Ilia Çabiri dhe Eleni Lino për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, bazuar kjo kërkesë në nenin 403 të K.Pr.Penale si të pabazuar në ligj, pasi çmon se kjo çështje nuk mund të gjykohet me gjykim të shkurtuar.

95/1. Kolegji Penal arsyeton midis te tjerash se: *“...në këtë gjykim ka disa bashkë të pandehur, ku disa prej tyre të cituar më lart, kërkuan ti nënshtrohen gjykimin të posaçëm, kurse i pandehur Odhise Andrea nuk parashtroi asnjë kërkesë duke lënë të vazhdojë gjykimi i zakonshëm. Në zbatim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 2/2003 “në një gjykim me disa të pandehur nuk mund të procedohet për disa me gjykim të posaçëm dhe për të tjerët me gjykim të zakonshëm. Vetëm në rastet kur, në kushtet e nenit 93 të K.Pr.Penale vendoset ndarja e çështjes, mund të lejohet gjykimi i shkurtuar për të pandehurit që e kanë kërkuar një gjykim të tillë dhe çështja të veçohet për të pandehurit e tjerë, që kërkojnë gjykim të zakonshëm...”.* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, konstaton se nuk jemi para asnjërit prej kushteve të parashikuara në mënyrë të qartë nga neni 93 i K.Pr.Penale. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi të rrëzojë kërkesën për gjykimin e shkurtuar të paraqitur nga një pjesë e të pandehurve, si të pabazuar në ligj dhe të vazhdojë gjykimin e zakonshëm për të gjithë të pandehurit”.

96. Gjithashtu, po ne seancën gjyqësore te datës **30.01.2017**, ne lidhje me kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit Ilia Çabiri për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga ajo e “arrestit në burg” në një masë më të butë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerësoi se këtë kërkesë do ta merrte në shqyrtim gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje.

97. Më pas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 355 te K.Pr.Penale e deklaroi të hapur shqyrtimin gjyqësor, duke i dhënë fjalën fillimisht prokurorit për të paraqitur faktet objekt akuze, si dhe per te treguar provat qe ai kërkonte te merreshin ne shqyrtim nga ky trup gjykues. Më pas ju dha fjalën mbrojtësve të të pandehurve per te dhënë shpjegimet e tyre, si dhe provat qe kërkonin te paraqesnin.

98. Për të provuar akuzën në ngarkim të të pandehurve, prokurori kërkoi që të merren në shqyrtim këto prova:

-Pyetjen në cilësinë e dëshmitarit Artan Broci, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, Admir Thanza, Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, Adnand Berdica, këshilltar në Gjykatën e Lartë, Etleva Stamo, adresa : Lagja “Kastrioti”, mbi Bankën NBG, Fier, Xhevahir Troka, adresa : banues në Fier, numër telefoni 0682035413.

-Në zbatim të nenit 166 të Kodit të Procedurës Penale kërkoj pyetjen e të pandehurve.

-Procesverbal këqyrje dhe marrje e dokumentave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë datë 29.06.2016, së bashku me aktet bashkëlidhur.

-Procesverbal këqyrje dhe marrje e dokumentave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë datë 13.07.2016, së bashku me aktet bashkëlidhur.

-Procesverbal këqyrje dhe marrje e dokumentave nga sistemi TIMS për identifikimi Eleni Lino, datë 15.07.2016, së bashku me aktet bashkëlidhur.

-Procesverbal këqyrje dhe marrje e dokumentave nga zyra këmbimit “Troka”, datë 14.07.2016, së bashkë me aktet bashkëlidhur.

- Procesverbal këqyrje e dokumentave nga notere Etleva Stamo, datë 14.07.2016.
- Procesverbal këqyrje dhe marrje e dokumentave nga dosje civile në Gjykatën e Lartë, datë 19.07.2016 dhe aktet bashkëlidhur.
- Procesverbal për marrjen e dokumentave, të dorëzuara nga Majlinda Andrea, datë 16.09.2016, së bashku me aktet bashkëlidhur.
- Procesverbal sekuestrimi i pamjeve filmike te zyrës së këmbimit valutor “Troka”, datë 14.07.2016, bashkëlidhur dokumentat dhe CD përkatëse.
- Procesverbal kontrolli i vendeve, banesa e Eleni Lino, datë 16.07.2016.
- Procesverbal për sekuestrim dokumentash Eleni Lino, datë 16.07.2016, procesverbal për kthimin e dokumentave datë 20.09.2016.
- Procesverbal për sekuestrimin e aparatit telefonik celular të Ilia Çabiri, datë 17.07.2016.
- Procesverbal për sekuestrimin e aparatit telefonik celular të Eleni Lino, datë 16.07.2016.
- Procesverbal për kontrollin e automjetit të Petraq Dashi, datë 16.07.2016.
- Procesverbal për kontrollin e vendeve, banesa e Petraq Dashit, datë 16.07.2016.
- Procesverbal për sekuestrimin e aparatit telefonik celular të Petraq Dashi dhe të disa dokumentave, datë 16.07.2016 dhe aktet bashkëlidhur.
- Procesverbal për sekuestrimin e depozitave bankare të Odhise Andrea në “Credins Bank” dhe “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 27.07.2016 dhe aktet bashkëlidhur.
- Shkresë nr. FRS/3369/ES, datë 15.07.2016, ardhur nga shoqëria “Vodafone”, identifikim abonentësh, bashkëlidhur dokumentat dhe CD përkatëse.
- Akt Ekspertimi teknik telefonash dhe kartash SIM, nr. 9365, datë 08.09.2016 dhe aktet bashkëlidhur së bashku më CD përkatëse.
- Procesverbal për këqyrjen e të dhënave nga Akti Ekspertimit, datë 27.09.2016, bashkëlidhur dokumentat përkatëse.
- Shkresa nr. 757 Prot., datë 27.07.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 3 CD.
- Shkresa nr. 715 Prot., datë 15.07.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 6 CD.
- Shkresa nr. 558 Prot., datë 07.06.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 1 CD.
- Shkresa nr. 621 Prot., datë 21.06.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 3 CD.
- Shkresa nr. 680 Prot., datë 06.07.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 3 DVD.
- Shkresa nr. 694 Prot., datë 08.07.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 4 CD.
- Shkresa nr. 703 Prot., datë 12.07.2016, bashkëlidhur procesverbale transkriptimi të bisedave dhe 5 CD.
- Shkresa nr. 855 Prot., datë 05.09.2016, bashkëlidhur 6 CD.
- Raport shërbimi për veprimet e vëzhgimit të fshehtë, datë 11.07.2016.
- Procesverbal për kryerjen e përgjimeve në vende publike, datë 12.07.2016, së bashku me një CD ku pasqyrohen veprimet e vëzhgimit të datave 11 dhe 12 korrik 2016.
- Raport shërbimi për veprimet e vëzhgimit të fshehtë, datë 12.07.2016.
- Raport shërbimi për veprimet e vëzhgimit të fshehtë, datë 13.07.2016, 14.07.2016 dhe 15.07.2016, bashkëlidhur 2 DVD ku pasqyrohen veprimet e vëzhgimit të datave 13, 14 dhe 15 korrik 2016.

-Aktet e caktimit të masave të sigurimit dhe zbatimit të tyre.

-Aktet e tjera shkresore të ndodhura dhe bashkëngjitura në fashikullin gjyqësor.

99. Mbrojtja e të pandehurve Majlinda Andrea dhe Petraq Dashi, Av.Th.Sollaku, deklaroi para gjykatës se, në lidhje me faktet dhe rrethanat e pretenduara nuk janë bërë hetime të plota dhe të gjithanshme. Në lidhje me të pandehurën M Andrea ka vetëm një indicie. Një telefonatë, dy ditë pas dhënies së vendimit gjyqësor, ku ka mësuar nga bashkëshorti se Petraq Dashi ka qenë në vëzhgim nga policia. Vet bashkëshorti tregon faktin se ka marre 50 mijë euro për biznes dhe nuk bëhet fjalë për mitmarrje. Petraq Dashi dhe Odhise Andrea kane shpjeguar qarte për marrëdhëniet midis tyre. Prokuroria nuk ka bere hetimet e nevojshme. Ne interpretimet e prokurorit behet fjala vetëm për disa selektime bisedash, te administruara ne CD. Ka biseda te tjera qe krijojnë një bindje tjetër. Nuk janë interceptuar te gjithë bisedat. Për sa më sipër, Av. Theodhori Sollaku, kërkoi nga gjykata pyetjen me cilësinë e dëshmitarëve te shtetasve: Matilda Dashi (bashkëshortja e te pandehurit Petraq Dashi); Sonela Dashi (vajza e të pandehurit Petraq Dashi); Petrit Gjeçi (OPGJ që ka dhënë informacionin për nisjen e këtij procedimi penal).

100. Av. Ardian Visha, mbrojtësi i të pandehurit Odhise Andrea, deklaroi se akuza qe i atribuohet të mbrojturit prej tij është i pabazuar. Ai gjithashtu ka pretenduar se shuma e marre prej te mbrojturit prej tij nga i pandehuri P Dashi, është mare si borxh per shkak te aktivitetit tregtar qe ushtronte i pandehuri Odhise Andrea dhe jo si shpërblim per dhënien e vendimit gjyqësor që pretendohet nga ana e organit të akuzës. Per të provuar këtë fakt, ka kërkuar nga gjykata pyetjen me cilësinë e dëshmitarit të shtetasve Petrit Gjeçaj (O.P.Gj); Ervin Stefa (Administrator i shoqërisë “Marmor Production”). Gjithashtu, Av. A Visha ka kërkuar nga gjykata caktimin e një eksperti të paanshëm për transkriptimin e bisedave.

101. Me cilësinë e provës shkresore ai paraqiti para trupit gjykues dhe kërkoi qe te merreshin ne cilësinë e provës aktet e mëposhtme:

- Ekstrakt historik i lëshuar nga QKB për shoqërinë “GRANITIMPORT-AL” që mban datën 11.01.2017.
- Ekstrakt historik i lëshuar nga QKB për shoqërinë “MARMOR PRODUCTION” që mban datën 09.01.2017.
- Deklaratën noteriale me nr. 54 rep dhe nr. 24/1 kol, datë 10.01.2017 të kryer nga deklaruesi Ervin Stefa para noteres Flutura Abdiu.
- Deklaratë llogarie e datës 10.01.2017 për shoqërinë “MARMOR PRODUCTION” nxjerrë nga Banka Societe Generale Albania (dy fletë).
- Deklaratë llogarie e datës 10.01.2017 për shoqërinë “MARMOR PRODUCTION” nxjerrë nga Banka Societe Generale Albania (dy fletë).
- Deklaratë llogarie e datës 10.01.2017 për shoqërinë “MARMOR PRODUCTION” nxjerrë nga Banka Societe Generale Albania (kater fletë).

102. Po kështu, mbrojtja e te pandehurit Ilia Çabiri, pretendoi se i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale per te cilën akuzohet. Organi i akuzës nuk sollti asnjë provë që të provonte se shtetasi Ilia Çabiri ka kryer veprime apo mosveprime te cilat te çojne ne konsumimin e veprës penale per te cilën akuzohet dhe që të legjitimohej prokuroria për të vënë në përgjim numrin e tij të telefonit. Madje as OPGJ Petrit Gjeçaj nuk ka përmendur asnjë provë konkrete ndaj këtij të pandehuri për të provuar akuzën që i atribuohet atij në këtë gjykim. Sipas tij, ne gjykim u vërtetua se bashkëpronaret nuk kishin te paguanin. Ne vazhdim ai kërkoi përsëri para gjykatës zëvendësimin e masës së sigurimit personal për këtë të pandehur, duke pretenduar se gjendja e tij shëndetësore ishte përkeqësuar ndjeshëm. Per kete qellim ai depozitoi para gjykatës një vërtetim

të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet të cilës pretendohet se i pandehuri rrezikon trompozë dhe qëndrimi i tij në burg i rrezikon jetën. Në këto kushte, mbrojtja e të pandehurit kërkoi caktimin e një eksperti mjeko-ligjor, i cili duhet të bënte vlerësimin e gjendjes shëndetësore të të pandehurit Ilia Çabiri.

103. Edhe mbrojtja e të pandehurës Eleni Lino, Av. S.Mengjesi pretendoi para gjykatës se akuza që i atribuohet kësaj të pandehure nuk qëndron, pasi nuk rezulton të jete evidentuar nga organi i akuzës se cila është mënyra e kryerjes se veprës penale nga kjo e pandehur. Nuk cilësohet se cili është roli i saj dhe cili veprim konkret i paligjshëm është kryer prej saj. E pandehura E Lino nuk ka ndërmarre asnjë veprim, si dhe nuk ka kryer asnjë rol për veprën penale që i atribuohet. E vetmja gjë që ka bere kjo e pandehur , ka qene interesimi i saj për fatin e çështjes gjyqësore, si një ndër përfitueset e pronës objekt shqyrtimi gjyqësor në Gjykatë të Lartë. Për te vërtetuar sa me sipër, mbrojtja e kësaj të pandehure, kërkoi nga gjykata pyetjen me cilësinë e dëshmitarit të shtetasit Xhorxhi Lino (djali i te pandehurës Eleni Lino). Gjithashtu, mbrojtja e kësaj të pandehure kërkoi që të depozitonte me cilësinë e provave shkresore edhe këto akte: a) ekzaminim i datës 16.06.200, b) rezonance manjetike, c) shkresë datës 05.07.2000 për shtrimin ne spital ne Athine, ç) një ekzaminim qe mban datën 021.06.2001 dhe d) një grafi digitale se bashku me përshkrimin per gjendjen shëndetësore.

104. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga mbrojtja per te pyetur OPGJ, prokurori prapësoi duke thënë se sa me sipër është një kërkesë e paligjshme dhe e padrejtë. Kjo për faktin se, sipas organit të akuzës, OPGJ ka kryer veprimet ne përputhje me ligjin dhe brenda kompetencave te tij funksionale. Ndërsa në lidhje me kërkesën për caktimin e një eksperti per transkriptimin e CD-ve te përgjimit, organi i akuzës është shprehur se nuk ka asnjë kundërshtim, duke evidentuar faktin se në rastin konkret nuk është e nevojshme caktimi i një eksperti, pasi bisedat e regjistruara ne CD mund të dëgjohen normalisht. Asnjë kundërshtim nuk ka pasur organi i akuzës edhe në lidhje me caktimin e një mjeku-ligjor për përcaktimin e gjendjes shëndetësore të pandehurit Ilia Cabiri, në kushtet kur kjo gjendje nuk mund të përcaktohet me ndonjë mënyrë tjetër.

105. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ne seancën gjyqësore te datës 30.01.2017 bazuar ne nenin 356 dhe 357 te K.Pr.Penale pasi dëgjoi parashtrimin e prokurorit në lidhje me faktet objekt akuze dhe mori në shqyrtim kërkesën e tij në lidhje me provat të cilat kërkoi që të shqyrtohen, pasi dëgjoi me radhë mbrojtësit e të pandehurve, të cilët treguan faktet që synojnë të provojnë, si dhe mori në shqyrtim kërkesën e tyre në lidhje me marrjen e provave, vendosi:

-Të pranohet kërkesën e prokurorit për marrjen e provave shkresore dhe thirrjen e dëshmitarëve të paraqitur, në parashtrimet e bëra prej tij para këtij trupi gjykues dhe në listën bashkangjitur (te paraqitura dhe ne kërkesën për gjykim.)

-Bazuar në nenin 357 të K.Pr.Penale të pranohet kërkesat e përfaqësuesve ligjorë të pandehurve për marrjen e provave shkresore, si dhe thirrjen e dëshmitarëve të paraqitura me kërkesë para këtij trupi gjykues.

-Të rrëzohet si të pabazuar në ligj, kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e disa te pandehurve për caktimin e një eksperti për transkriptimin dhe zbardhjen e bisedave telefonike të zhvilluar ndërmjet të pandehurve, të paraqitura nga ana e organit të prokurorisë në disa CD, të cilat ndodhen në dosjen e ardhur për gjykim nga organi procedues. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, bazuar në nenin 178 të K.Pr.Penale “Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave, ose vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike shkencore, kulturore“, zbardhja apo transkriptimi i bisedave të regjistruara në disa CD nuk kërkon njohuri të posaçme, shkencore sipas kërkesave të kësaj dispozite procedurale.

-Ato pjesë të bisedave të regjistruara në këto CD dhe që u kërkuan të zbardhen nga mbrojtja e të pandehurve, do të dëgjohej nga gjykata gjatë gjykimit sipas kërkesës konkrete që do të bëjnë të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, për CD konkrete dhe për pjesën konkrete të bisedës që do të kërkohej të dëgjohej.

-Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga i pandehuri Ilia Cabiri, nëpërmjet mbrojtësit të tij për zëvendësimin e masës së sigurimit, për faktin se ky i pandehur është në një gjendje shumë të rëndë shëndetësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi që në bazë të nenit 178 të K.Pr.Penale, duke qenë se ekzaminimi i gjendjes së tij shëndetësore kërkon njohuri të posaçme shkencore, gjë të cilën nuk mund ta bëjë dot ky trup gjykues, të caktojë një ekspert nga lista e ekspertëve të mjekësisë ligjore pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, për të ekzaminuar gjendjen e tij shëndetësore.

106. Ndërkohe, gjykata urdhëroi prokurorin të dorëzonte pranë sekretarisë së gjykatës nga një kopje CD për secilin nga të pandehurit në mënyrë që ata të kishin mundësi të verifikonin provën dhe të benin parashtrimet e tyre në lidhje me to, gjë e cila është kryer nga ana e prokurorit dhe nuk ka kundërshtime nga ana e mbrojtjes

107. Në seancën gjyqësore të datës 06.02.2017, u paraqit para gjykatës Dr.Shk. Zija Ismaili, të cilit ju shpjegua se ishte thirrur në cilësinë e ekspertit nga ana e këtij trupi gjykues me qëllim ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të të pandehurit Ilia Çabiri. Nga ana e trupit gjykues ju lexua formula e betimit sipas nenit 183 të K.Pr.Penale, ju bë e qarte përgjegjësia ligjore që ai kishte si dhe ju dhane detyrat nga ana e trupit gjykues (procesverbali i seancës gjyqësore datë 06.02.2017).

108. Në seancën gjyqësore të datës 20.02.2017, gjykata vazhdoi rregullisht procesin me marrjen e dëshmisë së dëshmitarëve: Artan Broci; Admir Thanza; Adnan Bërdica; Etleva Stamo; Xhevahir Troka. Kurse në seancën gjyqësore të datës 27.02.2017, vijoi me marrjen e dëshmisë së dëshmitarëve: Petrit Gjeçaj; Matilda Dashi; Sonela Dashi; Ervin Stefa, Xhorxhi Lino dhe Petra Dashi

109. Në pyetjen e dëshmitarit Petrit Gjeçaj, mbrojtësi i të pandehurit Odhise Andrea kërkoi që dëshmitari të jepte burimin e informacionit se cili ishte njeriu i besuar që i kishte dhënë këtë informacion. Avokati mbrojtës A Visha, pretendoi se ligja nuk e mbron dëshmitarin që të mos tregojë burimin e informacionit dhe ai është i detyruar të japë emrat, kur pyetet si dëshmitar, referuar nenit 160 i K.Pr.P. Tek dëshmia indirekte, mbrojtja ka të drejtë të kërkojë burimin dhe dëshmitari po refuzon ta japë burimin, sepse është mbi një bazë të paqenë. Për këtë arsye i kërkoi gjykatës që të detyrojë dëshmitarin që të japi përgjigje. Në lidhje me këtë kërkim, bazuar në nenin 160/5 të K.Pr.Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e ndërmjetëm të datës 27.02.2017, vendosi: “*Te rrezoje kërkesën e av. A.Visha për të detyruar OPGj për të dhënë burimin e informacionit dhe emrat e informatorëve*”.

110. Në seancën gjyqësore të datës 27.02.2017, është lexuar akti i ekspertimit mjekoligjor, i hartuar nga eksperti Dr. Zija Ismaili. Nga paraqitja e këtij akti ekspertimi, rezultoi e provuar se i pandehuri Ilia Çabiri vuan nga “*fibrilacion atrial kronik dhe regurgitacion mitral i moderuar*”, e cila nënkupton ç’rregullimin kronik të ritmit të punës së zemrës dhe valvulës mitrale. Sipas ekspertit mjekoligjor, aktualisht i pandehuri Ilia Çabiri është stabilizuar nga mjekimi i dhënë, por megjithatë kjo lloj sëmundje mund të japi çrregullime të paparashikuara, të cilat mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore, pavarësisht vendodhjes së tij.

111. Avokatët mbrojtës të të pandehurit Ilia Çabiri, kundërshtuan në seancë gjyqësore konkluzionet e ekspertit duke u shprehur se ai nuk i ka dhënë përgjigje shteruese pyetjeve të bëra nga gjykata, duke mos arsyetuar nëse institucioni i IEVP apo edhe Instituti i Kujdesit të Veçantë

Shëndetësor të të Burgosurve kanë mundësi të ofrojnë ndihmën e duhur për të përballuar një emergjencë apo krizë të fibrilacionit në rast se ajo do të ndodhë. Eksperti nuk rezultoi të ketë marrë në konsideratë as gjendjen psikologjike të të pandehurit Ilia Çabiri, as edhe gjendjen e përgjithshme të tij, e cila rezultoi të jetë mjaft e rënduar për shkak të moshës së tij si dhe faktit që për një kohë fare të shkurtër ka humbur një masë trupore të konsiderueshme (25 kile për gjashtë muaj).

112. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm nr. 25 akti, datë 13.03.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Ilia Çabiri për zëvendësimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg".

112/1. Kjo gjykatë në lidhje me këtë vendimmarrje ka arsyetuar se: *"...Në nenin 260/2 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se, vetëm në tre raste gjykata mund ta zbusë masën e sigurimit personal, të cilat janë: kur nevojat e sigurimit zbuten, masa e caktuar nuk i përgjigjet më rëndësisë faktit, ose nuk i përgjigjet masës së dënimit që mund të caktohet nga gjykata. Në rastin në shqyrtim nuk ndodhemi përpara asnjë prej këtyre rrethanave, pasi nuk ka ndonjë ndryshim akuze, e cila mund të parashikojë ndonjë masë dënimi më të butë dhe masa e sigurimit i përgjigjet rëndësisë së faktit, ose të dënimit që mund të caktohet më vonë, duke vënë në pah se i pandehuri akuzohet edhe për bashkëpunimin, i parashikuar nga neni 25 i Kodit Penal. Gjithashtu gjendja e rëndë shëndetësore e të pandehurit është pretenduar edhe më parë dhe nuk është pranuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Përfundimi që ka arritur eksperti mjekoligjor në rastin në shqyrtim është se, sëmundja nga e cila vuan i pandehuri Ilia Çabiri mund të trajtohet edhe në Spitalin e Burgut, prandaj nuk ndodhemi përpara tre kriterëve të përmendura nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg në çështjet Mouisel kundër Francës e vitit 2001 dhe Melnik kundër Ukrainës e vitit 2006. Në aktin e ekspertimit thuhet se, aktualisht i pandehuri Ilia Çabiri është stabilizuar nga mjekimi i dhënë, por megjithatë kjo lloj sëmundje mund ti japi çrregullime të paparashikuara, të cilat mund të ndikojnë në gjendjen e tij shëndetësore, pavarësisht vendodhjes së tij..."*

113. Ne seancën gjyqësore të datës 23.05.2017 (ne konkluzionet përfundimtare) mbrojtja e të pandehurve Petraq Dashi dhe Majlinda Andrea, bazuar në nenin 378/5 të K.Pr.Penale kërkoi të dëgjoheshin në sallonin 3CD dhënë nga prokurori. Kjo kërkesë e paraqitur prej tij u revokua në seancën gjyqësore të datës 26.05.2017, ku avokatet Theodhori Sollaku dhe Ardian Visha u shprehën se, në lidhje me kërkesën për dëgjimin e tre CD-ve hiqnin dorë nga çelja e hetimit dhe dëgjimin e tyre.

114. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur dhe në nenin 371 të K.Pr.Penale vendosi të bashkojë me fashikullin e gjykimit procesverbalet e seancave gjyqësore, provat shkresore të paraqitura nga prokuroria, të lexuara dhe të pranuar nga gjykata, si provat e paraqitura nga av. e të pandehurve Odhise Andrea, Petraq Dashi, Majlinda Andrea, Eleni Lino Ilia Çabiri dhe në bazë të nenit 378/1 të K.Pr.Penale, ftoi palët në diskutimet përfundimtare.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË VLERËSON SE:

115. Ne përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pas analizës, vlerësimit dhe çmuarjes së provave të pranuar dhe debatuar në gjykim, rezultoi të provuar se të pandehurit Petraq Dashi, Ilia Çabiri, Odhise Andrea dhe Eleni Lino kanë konsumuar në bashkëpunim elementët e veprës penale "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë", në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 e 25 të Kodit Penal.

116. Ne nenin 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikohet se: *“Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit deri në katër vjet”*. Referuar te drejtës sonë penale, objekti i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike te vendosura per te siguruar një veprimtari te rregullt e korrekte te organeve gjyqësore, te prokurorisë si dhe te funksionareve te tjerë te drejtësisë, si dhe mbrojtja e interesave te ligjshme te shtetasve te mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

117. Nga ana objekti kjo vepër penale kryhet me veprime aktive te shprehura ne mënyra te ndryshme, me ane te premtimit, propozimit dhënies, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çfarëdo përfitimi të parregullt gjyqtarit, prokurorit ose funksionarëve të tjerë te sistemit të drejtësisë, e lidhur kjo me kryerjen ose moskryerjen e një veprimi që lidhet me detyrën a funksionin e tij. Vepra penale konsiderohet e kryer qe nga çasti i premtimit ose i propozimit qe i behet funksionarit te sistemit te drejtësisë si, gjyqtarit, prokurorit ose punonjësit të organeve të drejtësisë, pavarësisht nga ardhja e pasojave te tjera.

118. Subjekt i kësaj vepre penale, është çdo person i cili ka mbushur moshën per përgjegjësi penale, është i përgjegjshëm dhe qe premtion propozon ose jep përfitim te parregullt, personit qe është me detyre gjyqtar, prokuror ose funksionar i sistemit te drejtësisë.

119. Nga ana subjektive, kjo vepër penale kryhet me dashje te drejtpërdrejte dhe me qellim përfitimi. Konsumimi i katër elementeve te figurës se veprës penale nga ana e te pandehurve del qarte nga te gjitha provat e marra ne kete gjykim dhe konkretisht:

120. U vërtetua gjate gjykimit se tre te pandehurit Petraq Dashi, Ylli Cabiri dhe Eleni Lino donin te përfitonin një sipërfaqe toke prej 40 ha, te ndodhur në rrethinat e Ksamilit, Sarandë. Kjo prone vinte si trashëgimi nga ish pronari Spiro Mihal Gjoka. Bashkëshortja e te pandehurit Petraq Dashi dhe e pandehura Eleni Lino, rezultonin ne rrethin e trashëgimtareve te ish pronarit Spiro Mihal Gjoka dhe ishin përfitues te kësaj prone ne pjesën qe u takonte me ligj, kurse i pandehuri Ilia Çabiri pretendonte te përfitonte pjese nga kjo prone, si person i cili ishte autorizuar me prokure nga bashkëpronaret, per te kryer te gjitha veprimet e domosdoshme ligjore per kthimin e saj nga AKKP Tirane. Ne kompensim te punës qe ai do te kryente, bashkëpronaret kishin rene dakort qe do ti dhuronin atij një sasi te caktuar toke.

121. Me qellim përfitimin e kësaj prone nga AKKP, trashëgimtarete ligjore te ish pronarit Spiro Mihal Gjokes kishin plotësuar dhe depozituar dokumentacionin ligjor pranë AKKP Tiranë. Ne mënyre qe prona te njihej dhe kthehej përfundimisht nga ky organ, ata ishin te detyruar qe te përfundonin edhe procesin civil qe kishin filluar me objekt vërtetim fakti juridik *“Përcaktimi i kufijve për sipërfaqen 40 ha te ndodhur në Ksamil”*. Ky proces kishte përfunduar dy shkallet e gjykimit dhe rezulton qe çështja ishte per gjykim ne Gjykatën e Larte. Me vendimin nr. 23-2012-50 (40), datë 04.09.2012 të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Sarande ishte vendosur: *“Vërtetimi i faktit juridik duke saktësuar vëndndodhjen dhe kufijtë e pronës së pretenduar të ish pronarit Spiro Mihal Gjoka, prej 40 ha.”* Ky vendim gjyqësor ishte lënë në fuqi me vendimin nr. 118, datë 04.03.2014 të Gjykatës së Apelit Gjjirokastër dhe çështja ishte regjistruar me datën 21.11.2014 në Gjykatën e Lartë, ne pritje te gjykimit te saj, pasi ishte paraqitur rekurs ndaj vendimit te Gjykatës se Apelit Gjjirokastër nga ish-Komuna Ksamil dhe Avokatura e Shtetit. Çështja do te gjykohej nga Kolegji Civil i kësaj gjykate, me relator Admir Thanza dhe anëtare te trupit gjykues Artan Broci dhe Majlinda Andrea.

122. U provua gjate gjykimit dhe nga deklarimet e te pandehurve se Petraq Dashi, Eleni Lino, Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea kanë marrëdhënie familjare mes tyre. E pandehura Eleni Lino është vajza e hallës së gruas së Petraq Dashit. Ndërkohë ky i fundit, rezulton kushëri me të pandehurën Majlinda Andrea (baballarët e tyre janë kushërinj te pare). Të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea janë bashkëshortë, kurse i pandehuri Ilia Çabiri është person i autorizuar me prokurë nga një pjesë e trashëgimtarëve të ish pronarit Spiro Mihal Gjoka për të ndjekur problemet ligjore te pronës se ndodhur në Ksamil deri ne njohjen dhe kthimin e tyre.

123. U vërtetua me te gjitha provat e marra gjate shqyrtimit gjyqësor se i pandehuri Ilia Çabiri, ka konsumuar elementet e veprës penale per te cilën ai akuzohet. Mbrojtja e këtij te pandehuri si gjate gjykimit ashtu dhe ne konkluzionet përfundimtare pretendoi se: *“nga te gjitha provat e sjella nga akuza ne asnjë rast nuk u provua se ky i pandehur te kete lidhje me konsumimin e veprës penale per te cilën akuzohet . nga ana e te pandehurit ne asnjë rast nuk rezultoi te kete bere ndonjë kërkese Ilia Çabiri per persa i perket shperblimit ose pageses ne kembim te perfitimit ashtu sic pretendon organi akuzës”*. E kundërta nga sa pretendon mbrojtja e ketij te pandehuri del nga provat e trajtuara ne kete gjykim dhe te paraqitura nga organi i akuzës.

124. Rezulton e provuar nga deklarimet e mbrojtjes se te pandehurit Ilia Çabiri si dhe nga deklarimet e te pandehurit Petraq Dashi ne seancën gjyqësore te datës 27.02.2017, se ne muajin Qershor 2016 këta te dy janë paraqitur pranë Gjykatës e Lartë per te marre informacion ne lidhje me çështjen objekt gjykimi. I pandehuri Petraq Dashi ka deklaruar se: *“...I.Çabiri nuk është anëtar i pronës, duke qene banues ne Sarande u zgjodh qe do ti ndiqte ai gjyqet, kur te merrej si prone, ai do te merrte një pjese.... Ne muajin maj kam marre I. Çabirin nga Saranda ne Fier dhe kemi ardhur ne Gj.Larte. Kemi pyetur dhe na kane thëne se ju bie ne fund te qershorit per te gjykuar çështja. Nuk isha ne dijeni per datën e gjyqit, kurse ne maj kam ardhur ne sekretari me thane qe ju bie nga fundi i qershorit. Ne gusht e dija qe gjykata mbyllej”*.

125. Interesimi i këtij te pandehuri per përfundimin e kësaj çështje si dhe per premtimet qe ata duhet te bënin per zgjidhjen e saj, del qartë nga te gjitha (i) procesverbalet per pergjimin e telekomunikimeve te marra ne cilësinë e provës si dhe (ii) nga veprimet e kryera prej tij, te cilat do te analizohen me poshtë ne kete vendim dhe qe tregojnë qarte per konsumimin e elementeve te veprës penale per te cilën akuzohet.

126. Siç rezulton nga procesverbali per përgjimin e telekomunikimeve ne datën 4 Qershor 2016, në orën 11 e 39 a.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marre në telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre rezulton:

(i) se te dy janë te shqetësuar per faktin se si do te zgjidhet kjo pune. Kështu i pandehuri Petraq Dashi thotë se *“ un e di per cfare me more , po vallai kam filluar qe kshu me ate nuk dua ti dal llafi “e kupton , qe te me thotë ore ne e lame se unë do te marr vete ,me kupton pse. Po mua sikur me kane hyre ethet , nuk e di me del gjumi natën per atë muhabet , po matem ti vete tek shtëpia , ta marr ne telefon , po meqë e lam”*.

(ii) Rezulton se i pandehuri Petraq Dashi kishte bere dhe biseda te mëparshme ne lidhje me kete ceshtje dhe puna kishte mbetur pasi duhej te behej një premtim ajo qe ata e quajnë *“graso”*. Sa me sipër del nga konteksi i bisedës *”Jo, po muhabeti vajti mirë fare, me një fjalë nga muhabeti i fundit që u ulëm ne, u bë e qartë që ky muhabet do grason, në rregull graso graso, e kupton ?”*

(iii) ndërkohe po nga biseda ne vazhdim del qarte fakti qe ata janë te gatshme te japin shpërblim per te përfutuar vendimin, i vetmi shqetësim qe ata kane është se sa do jete shuma qe do te japin. I pandehuri Ilia është dakord me ato qe i thotë ne bisede i pandehuri Petraq Dashi, pohon dhe i pranon ato.

Petraqi : *Eee dakort edhe i thashë e rëndësishme është të mos jetë ndonjë gjë e rëndë, jo jo më tha mua, janë gjera brënda asaj që janë të llogjikshme.*

Ilia : *Po mirë.*

Petraqi : *Po mos të jenë kopace brënda, kshu më tha. Tani pas këtij muhabeti më mori pastaj, ashtu siç ta kam thënë gjithmonë, e gjerat janë në proces, do të mar unë, ti mos mer më, do të mar unë, do të lajmëroj unë.*

Ilia : *shumë bukur, se ashtu funksionojnë gjërat.*

.....

Ilia : *un isha në Tiranë dje, ika për tër natën, vajta në mengjes, në orën 8 kisha takim me ata, u ulëm, u takuam, i ka dhënë rëndësi shumë të madhe tani që, atje të kthimit, të kompesimit të lekëve.*

Petraqi: *po mir o mir, po të hedhim këto, të fusim ktë në xhep, pastaj flasim bashkë ne. (Procesverbal per Pergjimin e Telekomunikimeve fq 101 e dosjes vol 2).*

127. Në ditët në vijim, në datat 6, 7 dhe 15 Qershor 2016, vertetohet nga permbledhjet e transkripteve te bisedave te zhvilluara mes te pandehurit Ilia Çabiri dhe shtetasit mbajtes te numrit te telefonit + 873, se ai është duke komunikuar me punonjës të AKKP Tiranë, duke u interesuar për fatin e dosjes që kanë depozituar atje. Nga biseda e bere ndërmjet tyre, del qarte se dosja s'ka marre ende rruge. Ajo per momentin nuk dihet se ku është, pasi nuk figuron as ne arshive dhe punonjësi i agjencisë i premton se do te interesohet per dosjen dhe do ti ktheje përgjigje (shikoni procesverbalin per Përgjimin e Telekomunikimeve te datës 6.6.2016 fq 109 e dosjes vol 2, dt 07.06.2016 fq 115-116 e dosjes, Vol nr. 2 dhe procesverbali per Përgjimin e Telekomunikimeve i datës 15.6.2016 fq 117-119 e dosjes Vol nr. 2).

128. Ne vijim, siç konfirmohet përsëri nga procesverbali per Përgjimin e Telekomunikimeve te datës 07.06.2016 (fq 126 e dosjes vol 2), ne datën 24 Qershor 2016, në orën 9 e 35 minuta a.m., i pandehuri Petraq Dashi merr në telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre konfirmohet:

(i) se i pandehuri Petraq Dashi është në pritje të një përgjigje në lidhje me çështjen civile që është në Gjykatën e Lartë nga personi me te cilin ka biseduar

Petraqi: *Hiç asgjë fare, as nuk më ka marrë as ashu... nuk e di si e qysh e tek do vijë. Nuk po e marr vesh fare, më tha më prit, më prit, po të marr vetë në telefon e kaq.*

(ii) se ai merret me njerëzit e tij aty per kete ceshtje

Ilia: *Mos është e nevojshme të vete unë një herë lart vetë...?*

Petraqi : *Po jo ore vlla se e bezdis, unë merrem me njerëzit e mi atje, thashë një mendje me gocën e xhaxhait, ti veja të shpija, por më duket si. Nqs të ka thën kshu tha është kot tha...*

(iii) Dhe se pritet qe kjo pune te mbyllet ne korrik te 2016

Ilia: *Erdhi finalja, në korrik ishalla e mbyllim...*

Petraqi : *Ai muhabet do vete mirë e të gjitha (shikoni procesverbalin per Transkriptimin e bisedave telefonike dt 24.6.2016 , fq 125 e dosjes vol 2).*

129. Ne datën 6 Korrik 2016, në orën 8 e 49 minuta a.m., i pandehuri Ilia Çabiri merr në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre konfirmohet se:

(i) pandehuri Petraq Dashi i ka dërguar fjalë atij mikut me të atin.

Petraqi : *Ati mikut i çova fjalë me të jatin me një fjalë.*

Ilia : *Po?*

(ii) konfirmohet fakti qe ende sqe bere asgjë ne lidhje me shqyrtimin e çështjes

Petraqi: *Edhe tha është akoma në ashu, tha po e shikojmë, tha mos ki merak. Kjo ishte përgjigja.*

Ilia: *Mos ki merak? Kaq?*

(iii) si dhe fakti që muhabetet janë bere te qarta te shkoqura me personin me te cilin është biseduar dhe se ska arsye pse te vonohen.

Ilia: *Këto punë kanë gjykatat mo vlla, nuk ashu, po ta kishim mbaruar, ta kishim mbledh mendjen.*

Petraqi: *Nuk e di çka të t' them or ti, muhabetet jan bërë t' shkoqura, t' pjekura, t' sakta, nuk e di tani.*

130. Po nga procesverbali për “Përgjimin e Telekomunikimeve” te datës 07.07.2016 (fq 132 e dosjes vol 2), vërtetohet se ne datën 7 Korrik 2016, në orën 12 : 58 minuta p.m., i pandehuri Ilia Çabiri ka folur në telefon me të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës se tyre konfirmohet se:

(i) pandehuri Petraq Dashi ka marrë përgjigje sa është shuma që duhet të paguanin në Gjykatën e Lartë pasi, Ilia e pyet: “Sa është kostua mo Petraq ?;

(ii) se për këtë çështje nuk mund të flitej në telefon, por duhet të takoheshin atë ditë mbasditë në Gjyrokastër për të biseduar në detaje.

Petraqi : *Tashti po atë do takohemi, janë gjëra që s' bëhen n' telefon kto, me një fjal, o bëhet këtë javë që vjen, o s' bëhet, me një fjal, kshu që kostua është veri ato, po takohemi sot mbasditë n' Gjyrokastër dhe kaq, mir, hajt.*

Ilia: *E mir nga ora 6-7*

131. Po nga dy bisedat e zhvilluara ne dt 07 Korrik 2016, rezulton fakti që i pandehuri Petraq Dashi i kërkon Ilia Çabirit që te takohen te nesërmen ne Gjyrokastër bashke me te pandehurën Eleni Lino, për te biseduar rreth pagesës dhe ky i fundit bie dakorte. (shikoni procesverbalin për Përgjimin e Telekomunikimeve te datës 07.07.2016 fq 135-137 e dosjes vol 2).

132. Siç rezulton nga procesverbali i Përgjimeve te Telekomunikimeve te po asaj date 7 Korrik 2016, në orën 13: 19 p.m., pasi i pandehuri Petraq Dashi e kishte lënë takimin me te pandehurin Ylli Çabiri, merr ne telefon edhe te pandehura Eleni Lino për ti thënë për takimin që kishte lënë me Ilian.

Eleni : *Alo..*

Petraqi : *Lenica, ç' kemi ?*

Eleni : *Mir, faleminderit.*

Petraqi : *Petraqi, jam.*

Eleni : *O, Petraq, ç' bëni ?*

Petraqi : *Ee, për atë të mora sepse nesër i thash dhe Yllit, nga ora 11-11 e 30, do takohemi aty në Gjyrokastër.*

Eleni : *E mir, shum mir, ndonjë lajm të mirë ?*

Petraqi : *I mir, i mir, po hajt.*

Eleni : *E mir pastaj, nga ora 11 e 30, e ?*

Petraqi : *Po, po, hajt*

133. Kjo e fundit, pas bisedës me Petraqin mer në telefon të pandehurin Ylli Çabiri. Nga biseda e zhvilluar mes tyre rezulton se:

(i) te tre te pandehurit do te takoheshin për te bisedua për çështjen e kostos ne gjykate te larte e cila nuk mund te thuhej ne tel dhe që sipas tyre kjo nuk do te ishte si ne dy shkallet e para me nga dy tre mije euro.

Eleni : *E tani sapo më mori dhe thoshja prit se isha unë nja një javë tutje dhe thash të të marr Yllin për ndonjë të re dhe dje harrova, kur më mori tani Petraqi, me tha do vi nesër në 11:30, do vij dhe Ylli tha të bisedojmë.*

Ilia : *E, është ajo për Gjykatën e Lartë, nuk e di tani ça kanë bërë ...*

Eleni : *E, i thashë unë ndonjë lajm të mirë ? Të mirë, të mirë, më tha mua po kaq.*

Ilia : *Ka kosto, ka kosto.*

Eleni : *E kuptova unë që tha, edhe unë për atë mendova për koston, e për koston.*

Ilia : *Ajo është tani t' shohim, po ajo tani s' është me 2000 evro, e 3000 evro.*

Eleni : *Po sa do të jetë shuma andeja ?*

Ilia : *Nuk e, do bisedojmë, s' më tha gjë në telefon.*

(ii) Janë po këta te pandehur qe pranojnë, qe duhet te japin shpërblim per arritjen e qëllimit te tyre, por qe janë te shqetësuar sa do te jete ajo pasi ata kane harxhuar dhe deri tani mjaftueshëm. Ndërkohe po nga biseda del qe ata duhet te bëjnë një sakrifice ta mbarojnë kete pune, pasi po u kthye çështja u ikën dem dhe gjitha puna qe kishin bere ne dy shkallet e para, si dhe 10 vjet pune te tjera.

Ilia : *Unë der tani, përvec tuajat që dhatë ti edhe Petraqi, kam harxhuar 8000 euro, 9000 euro, të miat.....*

Ilia : *Tani nuk do zëm të tilla llogarira, sepse tani po, është halli se të kthyen prapë në shkallë të parë, e në shkallë të dytë, u dogjëm, është kot na venë dëm ato.....*

Ilia : *Tani, ne nuk e dimë sa kanë kërkuar.*

Eleni : *Nuk e dimë, jo, themi neve, pa.....*

Ilia : *Po mendimi im është që të bëjmë sakrifica që ta mbarojmë këtë muhabet.*

Eleni : *Duhet bërë sakrificë, po kush ta bëj sakrificën se, kur nuk ke ...*

Ilia : *Do vrasim veten se ndryshe tani na ven puna dëm, 10 vjet punë na vete dëm, ne vetëm me këtë llaf.*

Eleni : *E di, e di, prandaja të them, në qoftë se ka ai, po jan kaq shumë?*

Eleni: *Le ti japi ai dhe e rregullojmë më vonë pastaja neve, mos e neve përshëmbull, neve i dimë kto gjëra që jan të tilla. Makar të jetë dhe ashtu të mos jetë ndonjë pengesë tjetër, makar të jet dhe ashtu.*

134. Nga kjo bisede e zhvilluar mes palëve, konfirmohet fakti se i pandehuri Ilia sebashku me te tjerët ishin te gatshëm te takoheshin, te uleshin te bisedonin per “Koston” shpërblimin qe do te jepnin, dhe duhet te sakrifikonin per ta dhënë atë, pasi ndryshe u ikte dem gjitha puna e bere deri ne atë kohe, madje duke rene dhe dakord qe ti paguante njeri dhe pastaj rregulloheshin. Pra del qarte ana subjektive (dashja) e te pandehurve per kryerjen e veprës penale.

135. Siç vërtetohet nga procesverbali i përgjimeve te telekomunikimeve te datës 08.07.2016 (ndodhur në faqen 148 të dosjes gjyqësor, volumni 2), ne datën 8 Korrik 2016, ora 7 : 56 a.m., i pandehuri Ilia Çabiri merr në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga biseda e zhvilluar konfirmohet fakti se i pandehuri Petraq Dashi do shkonte atë ditë në Gjirokastrë rreth orës 12.00, për t’u takuar me dy të pandehurit Eleni Lino dhe Ilia Çabiri. Pas kësaj bisede i pandehuri Ilia Çabiri niset për Gjirokastrë dhe takohet me të pandehurit Petraq Dashi dhe Eleni Lino. Takimi zhvillohet në dyqanin e te pandehurës Eleni Lino ku dhe është biseduar per shumën e shpërblimit.

136. Fakti qe tre te pandehurit janë takuar dhe qe kane biseduar pikërisht per “Koston” vërtetohet nga biseda zhvilluar mes te pandehurit Petraq Dashi dhe një shtetasi me emrin Malo, pasi ka mbaruar ky takim, bisede e zhvilluar ne orën 24:11 p.m. të datës 8 Korrik 2016 (shikoni procesverbalin per Përgjimin e Telekomunikimeve te datës 8.07.2016, fq 149 e dosjes vol 2), nga

ku del qarte qëllimi i takimit, muhabetet që ata kishin bere, shqetësimin se ku do gjendeshin leket, pasi Eleni shprehej që nuk kishte mundësi, fakti që Ilias i ishte lënë detyre që të fliste me bashkëpronaret e tjerë për të kontribuar të gjithë në shumën që kërkohet etj.

Petraqi : *E, Malo.*

Malo : *E re Petro, ku je ?*

Petraqi : *Ja ktu, po kthehem tani.*

Malo : *He, ç'a bëre ?*

Petraqi : *Ee, ato muhabete që prisja, i thash Yllit, se Lenica thoshte s'kam, s'kam.... s'prisja unë ndonjë gjë, tani për unë, për të mos thënë që dakort, unë jam shumë, shumë në siklet - i thash unë, se s'mund ti gjej për 3 – 4 ditë aq lek...*

Malo : *Ehe, ehe.*

Petraqi : *Kshu që, ç'a do bëjmë.*

Malo : *Ee.*

Petraqi : *Ylli, ti, i thashë unë, t' del për detyrë të dalësh atje, ti thuash atyre miqve, sikur sonte t' shkohsh në Tiranë, a ti marrësh në telefon, ta ndash muhabetin, sa do kontriboni. Jo tha, unë n' qoftëse nuk kontrobojnë me lek ata, tha do ti them sa zbrisni tha nga 15 – shja, më kupton ? që kan pjesë.*

Malo : *Po, po.*

Petraqi : *Edhe kjo është ashtu, i thash unë. Dakort, më kupton ?*

Malo : *Po.*

Petraqi : *Po jo, po ti bëj njëher muhabet të hënën, se mos ai bie dakort, që ti bëj me kto, me kto. Mir se e bëj unë muhabetin i thash unë, edhe këtë, po po që se s'ra dakort ai, qysh do ti bëjmë ? Ku do ti gjejmë ? Na ngeli pikpyetja ku do gjenden pastaj.*

Malo : *Ehe.*

Petraqi : *Që ta shtrydh Yllin sa t' kem mundësi.*

Malo : *Po.*

Petraqi : *Edhe pastaj ti jap në momentin e fundit, ti them okej..., i gjeta, më bëni kaq, më detyroheni kaq. Po do vi ti bëjmë muhabetet*

137. Fakti që i pandehuri Ilia Çabiri vazhdonte veprimet e tij për arritjen e qëllimit dhe sigurimin e shpërblimit, rezultoi dhe nga procesverbali për përgjimet e telekomunikimeve të datës 8 Korrik 2016, (fq 151-153 të dosjes vol 2) ku në orën 20 : 53 p.m., shtetasi me emrin Xhorxhi (i cili mund të jete një nga bashkëpronaret), merr në telefon të pandehurin Ilia Çabiri dhe bisedojnë pikërisht për shumën që duhet të paguhet në Gjykatën e Lartë. Duke analizuar këte bisede arrihet në përfundimin që: (i) Ilia Çabiri po përpiqet me veprime konkrete për të siguruar shumën që kërkohet të jepet si shpërblim. Bashkëbiseduesi e pyet atë se çfarë garancie kanë ata në rast se japin shumën përkatëse, pasi shuma është e madhe por Ilia thotë “*kjo shumë duhet të jepet sa më shpejt që të marrin....., dhe se ata nuk luajnë me shumën të tilla se u ikën jeta*”.

Xhorxhi : *Po ja të pyes unë, mir i duan ato ata, po ka garanci apo ?*

Ilia : *O Xhorxhi, ajo është punë e bërë, jep ato ...*

Xhorxhi : *Po mir, ka garanci ? Apo ti japim, e pastaja, jo andeja, po këteja.*

Ilia : *Jo, jo, atje është loja. E jep lekët merr....*

Xhorxhi : *Po mir mo, mir, nuk diskutojmë atë, po mos na i dredhin gjë edhe..*

Ilia : *Jo, po, ata nuk lozin me jetën, kështu luhet kjo.*

Ilia : *Jo, jo, jo, ne duhet deri të martën, të mërkurën, të jepen dhe të premtën merr vendimin.*

Xhorxhi : *Ehe.*

Ilia : *Kshu luhet gjërat dhe në dhamë lekët që morrëm vendimin.....*

Ilia : Nuk lozin ata me kto, se është shumë e madhe, nuk, lozin.

Xhorxhi : *Po mir mo, mir, normal, po ndaj them dhe un mo, ngaqë është shum e madhe se.*

Ilia : *Jo, jo, jo, nuk lozin ata, se e din qëme jet kjo pun, të vjen tjetri të merr jetën dhe familjarisht.*

Ilia : *Tani Petraqin nuk e dim....., të rezistoj çik muhabetin, kaq mund të mbledhim.*

138. Siç provohet me procesverbalin per Përgjimin e Telekomunikimeve te datës 09.07.2016 (fq 154-156 te dosjes vol 2), në datën 9 Korrik 2016, në orën 8 e 35 a.m., i pandehuri Ilia Çabiri ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës së zhvilluar konfirmohet qarte fakti se:

(i) i pandehuri Ilia Çabiri ishte duke punuar per te siguruar shpërblimin qe duhet te jepnin por bashkëpronaret nuk kishin pranuar qe te paguajnë pasi nuk kishin mundësi ekonomike .

Ilia: *Edhe i thash, dolën problemi këtu, këtu, këtu, i thashë. Dëgjo më tha mua, neve nuk është halli se kemi lek edhe si dhamë, jemi në këto pozicione të ngushta, tha, me një llaf..... un su pash as librezat, as ato gjërat. I thashë, dëgjo, i thash, kjo pun ka një kosto, i thash ju meqë jeni në pjacë, i thashë, e dini si funksionojnë gjykatat, si funksionojnë të gjitha gjërat. Un i thashë, deri tani kam qënë korrekt me juve, apo jo ? Po më thanë mua. Tani i thash si i bëhet sepse mua më ka ikur shum lek nga kjo punë e gjykatave i thash. Kur kemi bërë ca muhabetete i thash, i kemi bërë ndryshe thash, po më dilni ndryshe. Dhe bëra shumë debate me ta.*

(ii)Po nga biseda del se i pandehuri Ilia Çabiri ua ka bere te qarte bashkëpronareve qe ne rast se nuk kontribonin ne te holla, do kontribonin me pasuri te paluajtshme duke u zbritur sipërfaqe nga toka (pra përsëri dalin qarte veprimet aktive te te pandehurit per te siguruar shpërblimin qofte ai ne te holla apo ne pasuri te palujtshme /toke).

Ilia : *Për ketë problem, më thanë mua, ne nuk kemi dhe nuk të ndihmojmë dot. Mir i thashë, do keni kosto neser për tokën, i thash....*

Petraqi : *Ja the troç ti atë punën e atyre hektarëve vlla ?*

Ilia : *Po, po, po, po re.*

(iii) Ndërkaq i pandehuri Petraq e udhëzoi qe ti sqaroje mire këto pune me bashkëpronaret, pasi duhet te japë një përgjigje përfundimtare dhe nuk do qe ta zgjasi me kete pune. Ndërkohe qe Ilia i thotë se koha është e shkurtër dhe nuk kane mundësi qe te mbledhin kaq shume leke.

Petraqi: *Merr përgjigje nga ata se unë do nesër, po qe se ata, se më than një llaf, sikur s'kan ikur n'Itali, nuk e di ku kan vajt. Un do interesohem sonte, po ashtu nesër vete i takoj për të bërë ato muhabetet, po ma nda këtë njëher mua ti, që t'jem me këmbë në tok un.*

Ilia : *Ore, do të jap unë haber në darkë, të thash mo.*

Petraqi : *A, rrofsh.*

Ilia : *Ashtu, tani më kupton mua ti, muhabeti është ki, që kta supozojnë me këtë gjë që thua me nje justifikim që nuk na latë kohë, përshëmbull, një javë kohë. Si ti mbledhim kaq lek ?*

Petraqi : *Ore, ja o Ylli, mir e ke ti t'keqen vëllai, dëgjo Petraqin, dëgjo mua një sekondë. Ja më thanë ata dakort, sa do ti ? Një javë ? Mir, merr një javë koh. Po çka do bëj për një javë o Ylli ?, Po aman të keqen vëllai, po lem...*

Ilia : *Jo të marrësh një javë koh mo, ta shtym der na shtatori,po prap dhe na shtatori neve.*

Petraqi : *Po, jo re, nuk ma mban bytha n'shtator mua, çka thua ti. Po nuk bëhet fjalë ajo, e çka un ? Un që mbrëmë jam takuar me nja 2 – 3 vet, po ti e di si jan kto pun. T'gjith mbledhin shpatllat e burr....*

Ilia : *E marr vesh mo pasha, e marr vesh.*

Petraqi : *Dëgjo mua, më sqaro muhabetin e atyre, me ato ti, më sqaro muhabetin e atyre njëher.*

Ilia : *E, në dark, e në dark.*

Petraqi : *Edhe mender, mos e çaj bythën fare, i thuaj o byrazer, sa kishe ti ? 15 ? I rruan bythën 15 – es ti i thuaj, kaq.*

Ilia : *Po e di, mo...*

Petraqi : *I rruan bythen 15 – es ti thoj, po mbaj 12 atje, a mbaj 11 atje, mbaj 13 maksimumi, se nën 2, jo njëher, harroje ti thuaj atija, edhe andej nga ke ardhur.*

139. Po ne datën 9 Korrik 2016, në orën 12 : 20 p.m., e pandehura Eleni Lino merr në telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës rezulton se e pandehura Eleni kërkon të dijë nga i pandehuri Ilia, nëse mori përgjigje nga bashkepronaret e tjere. I pandehuri Ilia i konfirmon se nuk ka marrë akoma përgjigje, por në darkë, nga ora 8 ose 9, është e sigurtë se do marrë përgjigje. Sa me sipër vertetohet me procesverbalin për Pergjimin e Telekomunikimeve të datës 09.07.2016 (fq 157 të dosjes vol 2).

140. Siç provohet me procesverbalin për Pergjimin e Telekomunikimeve të datës 10.07.2016 fq (159-160 të dosjes vol 2), në datën 10 Korrik 2016 ora 7 e 30 a.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marrë në telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës konfirmohen veprimet e kryera nga i pandehuri:

(i) i pandehuri Ilia Çabiri kishte patur në shtëpinë e tij një natë më parë një takim me bashkepronaret dhe se ata nuk kishin pranuar të kontribonin në të holla pasi nuk kishin dhe Ilia u kishte thënë se kontributin do ta jepnin me sipërfaqe toke. Nderkohe që Petraqi perseri kembengul që ta ndante muhabetin me ata.

Ilia : *Mir është ? I kisha ktu mbrëm ata miqtë.*

Petraqi : *Ehe.*

Ilia : *Kam bërë lëre debate, vari lesht, nuk kam gjëndje, mu betuan, prandaj erdhën poshtë, se unë i bëra alarmante gjërat, se janë alarmante. Thash ndodhem në këtë pozicion i thash, na vete puna dëm edhe juve keni pjesën tuaj dhe ju veni dëm, i thash, se po s'mora unë, s'merrni dhe juve i thash. Nuk kemi o Yllo, më tha mua, prandaj erdhëm poshtë, tha që të na besosh. Unë e dija këtë përgjigje i thash, edhe i thash do tu ul hektarë, i thashë, në metro. Ky ishte muhabeti me ta.....*

Ilia : *O pasha, as ata kanë gjë në dorë, as unë s'kam gjë në dorë kur vjen finalja, unë bëj punët e mia pa merak për ato gjëra nuk e ... ato janë muhabetet e fundit që do bëhen. Këto këtu, unë doja të nxirrja ndonjë diçka ktej, të paktën dhe 20 mijë euro, 10 mijë euro, 15, sa të mund të nxirrnim, nuk nxorrëm, mbaroj filmi, atë e kam unë në dorë, ore në fund fare unë su jap gjë fare ore, e ke idenë ti se sa inat kam marrë unë këtë radhë me ata ? Kam bërë debat deri në 12 me ata mbrëm, prandaj s'të mora në telefon.*

Petraqi : *Dëgjo, dëgjo Ylli, ndaje muhabetin me ata..*

(ii) si dhe konfirmohet fakti se i pandehuri Petraq Dashi do vazhdonte bisedimet me personat e caktuar që kishin marrë persiper zgjidhjen e ceshtjes dhe do t'i kthente një përgjigje se si do procedonin në vazhdim .

141. Po në datën 10 Korrik 2016, në orën 18: 35 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka folur perseri me të pandehurin Ilia Çabiri dhe biseda konfirmohet nga procesverbalin për Pergjimin e Telekomunikimeve të datës 10.7.2016 (fq 161-162 të dosjes vol 2). Nga përmbajtja e bisedës konfirmohet perseri fakti se i pandehuri Petraq po vazhdonte veprimet e tij në mënyrë aktive për të realizuar qëllimin, ai kishte biseduar “*direkt me mikun*” dhe ja kishte thënë propozimin e tij, por

pergjigja ishte qe: “ai nuk pranon as me toka as me gjë, i do të thata” dhe sipas te pandehurit Petraq: “e vetmja gjë që na bëri ai ne është që nga 60 e çoj 50. Dakort? Ktë po ta them ty, do marr dhe Lenicen, do t’ja them dhe asaj tani, sepse për ne është gjë e madhe që e uli 10”

Ilia : *Po shumë ashu, ta kishte ul dhe njëçik.*

Petraqi : *Jo shumë, është një gjë e mirë, nuk po them shumë e mirë, po sido që të jetë, në pozitat që jemi ne është një gjë e mir, dhe na jep goxha, goxha, na jep çik krah.*

142. Nga analiza qe i behet kesaj bisede, vertetohen faktet qe:

(i) te dy te pandehurit Petraq Dashi dhe Ilia Çabiri kane arritur te takojnë personat te cilët do ti ndihmonin ata ne dhënien e vendimit;

(ii) u kane bere atyre propozime konkrete dhe kane marre një përgjigje konkrete;

(iii) dhe tani janë duke bashkëpunuar me njeri tjetrin (me veprime konkrete aktive dhe me dashje) per te siguruar shumën prej 50.000 eur qe duhet te jepnin ne këmbim te vendimit te gjykatës ne favor te tyre;

(iv) Nga biseda rezulton se dy te pandehurit bien dakorte qe bashkëpronaret e tjerë qe nuk mund te kontribuojnë ne te holla, do tu zbritet sipërfaqe toke. Kështu Ilia thotë:

Ilia: *“Mos var shpresat andej dhe shpresat ti varim nga vetja jonë, kaq muabeti”. Ne përfundim te bisedës, Petraqi i kërkon Ilias qe se bashku me Elenin te takohen ne Fier per ta ndare kete muhabet.*

Petraqi: *“Dëgjo mua, bëhet fjal që ta kesh iden, dëgjo mua se mos, bëhet fjal që nesër ktu bashk me Lenicen, në ora 10:00 apo 11:00 të jesh në Fier dhe do ta them un pse. Më dëgjove?”*

Ilia: *Të mora vesh mo, të vim nesër ne, nesër andej,..në mëngjes ?*

143. Vërtetohet nga procesverbali “Për përgjimin e telekomunikimeve” të datës 10.07.2016, nga e cila rezulton se ne datën 10 Korrik 2016, në orën 19 : 30 p.m., i pandehuri Ilia Çabiri merr në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës konfirmohet se i pandehuri Ilia do të shkonte të nesërmen në mëngjes të merrte në Gjirokastër të pandehurën Eleni dhe të dy bashkë të shkonin në Fier rreth orës 10 e 30 për t’u takuar me të pandehurin Petraq Dashi dhe për të ndare përfundimisht çështjen.

144. Me datën 11 Korrik 2016, në orën 6 e 20 a.m (siç konfirmohet dhe nga procesverbali “Për kryerjen e përgjimeve në vende publike” referojuni faqes 178-181 të volumnit 2 të dosjes gjyqësore), i pandehuri Ilia Çabiri është nisur nga qyteti i Sarandës me automjetin Mercedes Benz, me targë SR 6653 B, për në Fier. Rrugës ka marre në Gjirokastër të pandehurën Eleni Lino dhe të dy kane arritur në Fier në orën 9 e 40 a.m. Aty takohen me të pandehurin Petraq Dashi dhe të tre së bashku shkojnë të noterja Etleva Stamo për të bërë deklaratat noteriale që secili prej tyre pranonte që i kishte nga 17 mijë euro borxh të pandehurit Petraq Dashi.

145. Siç rezultoi dhe nga deklarimet e noteres Etleva Stamo te bëra para Kolegjit Penal te Gjykatës se Larte ne seancën gjyqësore te datës 20.02.2017, I pandehuri Petraq Dashi është paraqitur me te pandehurën Eleni Lino ne zyrën e saj ku kane kërkuar te kryenin një kontrate huaje. Noterja deklaroi se ka kërkuar prej te pandehurve qe te kryenin transaksionin me banke dhe pastaj ajo te përpilonte aktin noterial. Ne kushtet qe noterja ka kërkuar qe veprimet te kryheshin me banke dhe vetëm pasi asaj ti sillej vërtetimi bankar do të kryente aktin noterial (nisur nga fakti që shumë ka qene e konsiderueshme), dy te pandehurit janë larguar dhe nuk janë paraqitur me ne zyrën e noterisë.

146. I pandehuri Ilia Çabiri pretendoi ne gjykimin se ai nuk kishte qene dakord me propozimin e Petraqit per te nënshkruar kete akt noterial, si dhe per te dhënë një shume te tille si shpërblim prandaj dhe nuk ishte paraqitur ne zyrën e noteres. Mosparaqitja ne zyrën e noteres sipas tij, tregon qe ai nuk ishte i përfshire ne veprime korruptive dhe se nuk kishte ndërmend te paguante

per te marre vendimin gjyqësor. Por, ky pretendim i te pandehurit Ilia bie poshtë si me bisedat e zhvilluara deri me tani dhe te analizuara me lart ne kete vendim, ashtu dhe me veprimet qe ai kishte kryer si me përpara, dhe atë dite ku ai kishte marre rrugën sipas bisedës me te pandehurin Petraq dhe kishte shkuar ne Fier se bashku me te pandehurën tjetër Eleni per te biseduar pikërisht per kete çështje.

147. Te tre te pandehurit e pranojnë qe janë takuar me njeri tjetrin. Ky fakt vërtetohet nga procesverbalet e vëzhgimit në vende publike të kryera nga policia gjyqësore me datën 11 korrik 2016, nga te cilat rezulton se ata kane qene para zyrës noteriale te noteres Etleva Stamo, janë ulur ne kafene pasi kane dale nga kjo zyre dhe kane biseduar edhe me vone, kur te tre kane shkuar ne banesën e Petraq Dashit. Vetëm fakti qe i pandehuri Ilia nuk u fut ne zyrën noteriale nuk tregon qe ai nuk ka qene pjese e veprimeve qe po kryenin te pandehurit.

148. Te gjitha transkriptet e bisedave te analizuara me lart (te marra me cilësinë e provës), si dhe veprimet konkrete te kryera nga ky i pandehur ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë (veprime te cilat koordinohen dhe janë ne përputhshmëri me njëra tjetrën), konfirmojnë qarte vullnetin e plote te këtij te pandehuri per arritjen e qëllimit te tij. Ai është ne dijeni se per te marre një vendim ne favor te tij duhet te paguhet shuma prej 50.000 euro, është dakord qe te paguhet kjo shume dhe punon per mbledhjen e saj me bashkëpronaret e tjerë. Ne kushtet qe kjo shume nuk arrihet te sigurohet prej tyre, ai është dakord qe ajo te paguhet dhe nga dikush tjetër dhe bashkëpronareve te tjerë tu zbritet toke nga pjesa qe do te marrin per efekt te kontributit. Kjo bindje del dhe nga fakti qe siç e deklaroi dhe ai “e di se si bëhen këto pune”, qe “vete ka paguar shuma te konsiderueshme” dhe per kete qellim ai është munduar te bind dhe bashkëpronaret e tjerë qe te paguajnë per te marre kete vendim. Pra nga këto prova, konfirmohet plotësisht ezaurimi i anës objektive dhe anës subjektive te subjektit te veprës penale; veprimet konkretet qe ai ka kryer per ta realizuar atë; dashja direkte e tij për të kryer pagesën prej 50 mijë euro në Gjykatën e Lartë.

149. Por këto transkripte te bisedave te cilat u morën me cilësinë e provës nga ana e këtij trupi gjykues dhe qe e kishin burimin nga vendimi 386, date 03.06.2016 i Gjykatës se Shkalles se Pare te Krimeve te Renda u kundërshtuan nga te gjithë avokatet mbrojtës te te gjithë te pandehurve ne konkluzionet e tyre përfundimtare, te cilët kërkuan paperdorshmerine e tyre dhe te mos merreshin parasysh nga ana e këtij trupi gjykues ne baze te nenit 151/4 të K.Pr.Penale .Per rrjedhoje mbrojtja e te gjithë te pandehurve kërkoi edhe paperdorshmerine e transkripteve te bisedave qe rridhnin nga vendimet me nr. 465, datë 07.07.2016, me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Petraq Dashi; dhe nga vendimi nr. 468, datë 09.07.2016 me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Odise Andrea.

150. Sipas mbrojtjes “*procedimi penal kishte filluar dhe ishte regjistruar mbi bazën e referimit te oficerit te policisë gjyqësore mbështetur vetëm ne hamendësime, referime te pabazuara si dhe pa asnjë mbështetje ne ndonjë fakt qofte dhe indicje. Ne analize te vendimi 386 date 3.6.2016 te Gjykatës se Krimeve te renda me te cilin është lejuar ne mënyre te menjëhershme përgjimi i nr telefonit 0697612754 qe i persiste te pandehurit Ilia Cabiri jane shkelur ne mënyre flagrante dispozitat procedurale dhe ne mënyre te veçante parashikimet e nenit 221/1.a te KPrP i cili thotë se: “1.Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, lejohen vetëm kur procedohet: a) për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet;...”, si dhe neni 222/1 në të cilin parashikohet se: “1. Me kërkesën e prokurorit ose të të dëmtuarit akuzues, gjykata autorizon*

përgjimin me vendim të motivuar për rastet e lejuara me ligj, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës. Kundër vendimit të gjykatës që refuzon kërkesën mund të bëhet ankim i veçantë. Përgjimi në vende publike, regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, si dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes autorizohen nga prokurori. Kur njëri nga dy personat që do të përgjohen është i gatshëm të kryejë dhe të regjistrojë veprimin përkatës, sipas marrëveshjes me oficerin e policisë gjyqësore, veprimi është i lejuar me autorizim të prokurorit...”.

151. Per ti dhënë përgjigje këtij pretendimi te ngritur nga te gjithë avokatet mbrojtës, i cili përben dhe thelbin e këtij gjykimi nga ana procedurale, si dhe bazën e provueshmërisë se veprës penale dhe aplikimin e ligjit material (Kolegji ishte shprehur me vendim te ndërmjetëm se per paperdorshmerine e provave do te shprehej ne një faze te mëvonshme), ky Kolegj vlerëson se ka rendësi te analizohet nëse: (i) është respektuar apo jo parimi i ligjshmërisë ne kryerjen e veprimeve procedurale paraprake nga ana e organeve te caktuara me ligj per kryerjen e këtyre veprimeve; si dhe (ii) nëse gjykata ka respektuar apo jo parashikimet e nenit 221/a dhe 222/1 te K.Pr.Penale.

152. Parimi i ligjshmërisë nënkupton se organizimi dhe funksionimi i pushteteve te organeve kushtetuese, parashikohet shprehimisht ne ligj. Dispozitat procedurale disiplinonë tere aktivitetin procedural penal te organeve qe merren me procedimin penal. Hetimet paraprake nuk nxiten nga ekzistenca e veprës penale, por nga marrja dijeni qe mund te kete per kryerjen e një vepre penale. Per kete qellim, prokurori dhe policia gjyqësore ne baze te kompetencave qe ligji u ka dhënë, zhvillojnë hulumtime, hetime te nevojshme qe lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

153. Ne nenin 277 te K.Pr.Penale janë te përcaktuara qarte organet e ngarkuara me ligj per hetimet paraprake. Sipas kësaj dispozite, *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore”*. Ne analize te sa me sipër, del qe hetimet paraprake u janë lejuar si dhe kane detyrimin qe ti kryejnë (a) organi i prokurorisë dhe (b) organi i policisë gjyqësore. Këto veprime paraprake i lejohet te kryhen dhe përdoren nga prokurori si mjete procedurale, menjëherë pas marrjes se njoftimit per ekzistencën e një vepre penale, duke i dhënë mundësinë atij qe ne përfundim te përdorimit te tyre, te vendosi ushtrimin apo jo te ndjekjes penale.

154. Referuar dispozitës ligjore, është prokurori titullar i hetimeve paraprake, te cilat ose i kryen vete ose kontrollon ato qe janë kryer nga policia gjyqësore. Është pikërisht kjo veprimtari e përbashkët hetimore mes këtyre dy organeve, e cila përmbushet sipas parashikimeve ligjore. Ne veprime paraprake te parashikuara ne ligj futen te gjitha ato veprime qe kane lidhje me kërkimin dhe sigurimin e provës, qe përmbledhen ne veprime te tilla si këqyrjet, kontrolllet, sekuestrimit, përgjimet, veprime simuluese, infiltrimet identifikimet, përfitimin e te dhënave nga persona qe mund te tregojnë rrethana te dobishme, përfitimi i te dhënave nga i hetuari etj. Nga kjo veprimtari e përbashkët, sigurohet burimi i provës, burim nga i cili me pas merret prova nga organi procedues sipas parashikimeve te nenit 151/1 te KPrP ne te cilin thuhet se: *“Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”*. Ne analize te kësaj dispozite, del qarte se faza e hetimeve paraprake shërben per marrjen e provës nga prokurori qe është organi proceduralës i kësaj faze.

155. Rezulton nga aktet te cilat u pranuan me cilësinë e provës ne kete gjykim se, ne datën 20 Maj 2016, oficeri i policisë gjyqësore ne prokurorinë pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda ne baze te nenit 283/1 dhe 293 te K.Pr.Penale, ka përpiluar dhe dërguar një informacion me shkrim per Drejtuesin e Prokurorisë se Shkalles se Pare per Krime të Renda, ne te cilën referon dyshime te arsyeshme per kryerjen e veprave penale. Ne kete informacion thuhet

shprehimisht se: “...Sipas informacioneve të marra ka dyshime të arsyeshme se shtetasi I. Çabiri është përfshirë në veprime korruptive me punonjës të veçantë të sistemit të drejtësisë dhe Agjencisë së Kthimit të Pronave. ...Prej vitit 2009 ndërmjet I Çabiri dhe Komunës Ksamil ka pasur disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe në Gjykatën e Lartë, ku është momentalisht për rekurs. Ka dyshime dhe të dhëna se Çabiri është përfshirë në veprime korruptive me punonjës të veçantë të sistemit të drejtësisë që kanë ndjekur proceset gjyqësore dhe konkretisht Av. R.H. dhe Av. A.S, gjyqtarët N.H.(D) dhe E.P. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, si dhe gjyqtarët T.SH. dhe Y.M. në Gjykatën e Apelit Gjirokastër për të fituar pronësinë e kësaj prone. ...për këtë pronë, shtetasi I Çabiri ka dorëzuar dosjen ne AKKP Tiranë që është në proces njohje. Nga të dhëna dhe informacione të besueshme, rezulton se I. Çabiri është përfshirë në veprime korruptive me punonjës të veçantë të AKKP Tiranë dhe konkretisht me ... detyrë si dhe shtetasen ..., me detyrë.....prane AKKP Tiranë për njohjen e dokumentacionit të pronësisë. Sipas Ilia Cabiri-t ai ka negociuar me... për këtë çështje gjatë vitit 2015 dhe pikërisht në muajin gusht është takuar ku ...i ka kërkuar 2 ha nga kjo parcelë prej 40 ha, me qëllim përfundimin e dosjes së pronësisë në AKKP dhe Çabirika pranuar dhënien e saj, përmes veprimeve noteriale. ...në mënyrë të pavarur nga ... I Cabiri ka ndërhyrë edhe tek ..., të cilës i ka premtuar dhënien e 5.000 m2 tokë, në këmbim të përfundimit të procedurave nga AKKP. Të gjitha burimet e informacionit sqarojnë se këto të dhëna janë të vërteta dhe duan një hetim të specializuar dhe me mjete speciale hetimi duke bërë të mundur mbledhjen e provave të nevojshme të përshkruara në informacion...”.

156. Bazuar ne informacionin e mesiperme ka rezultuar qe Prokuroria prane Gjykeses se Shkalles se Pare per Krimet e Renda, me urdherin e dates 23 Maj 2016, ka urdheruar: “Regjistrimin e procedimit penal per veprën penale te “korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, si dhe për veprat penale “korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga nenet 245 dhe 260 i Kodit Penal”. 2. Në rregjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, të shënohet emri i personit nën hetim, i shtetasit Ilia Çabiri..., si i dyshuar për veprat penale “korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe “korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga nenet 319 dhe 245 të Kodit Penal...” (referojuni fq 31-33 të vol 1).

157. Po ne datën 03.06.2016, ky oficer i policisë gjyqësore dërgon një informacion te dYTE ne Prokurorinë pranë Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda per Drejtuesin e Prokurorisë, me anën e se cilës referon vazhdimësinë e veprimeve te kryera nga personat te cilët dyshohen per përfshirjen ne veprime korruptive dhe per kryerjen e një krimi. Në këtë informacion ka pasqyruar se: “...Nga burime të sigurta informacioni rezulton se shtetasi I Cabiri është nisur nga qyteti i Sarandës për në Tiranë me kërkesën e një zyrtari të AKKP dhe pikërisht për të takuar zyrtar drejtues të këtij institucioni me qëllim kryerjen e veprimeve korruptive. Shtetasi Ilia Çabiri ka këtë numër telefoni 0697612754, të cilin e ka përdorur dhe do e përdorin për të lënë takime të rëndësishme me persona të rëndësishëm të këtij institucioni, me qëllim korrupsionin e tyre. Me qëllim marrjen e te dhënave per rrethanat e hetimit dhe autorësisë se veprës penale cmohet e nevojshme kryerja e pergjimeve te telekomunikimeve dhe bisedes qe mund te kryhen nepermjet numrit te telefonit celular 0697612754” (referojuni fq 50 të vol 1 të fshikullit gjyqësor).

158. Nga analiza qe u behet këtyre informacioneve te përpiluara dhe referuara nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, rezulton se ato janë ne përputhje me detyrën funksionale te tij te shprehura qarte dhe ne nenin 30 te K.Pr.Penale ne te cilin parashikohet se: “është pikërisht policia gjyqësore

organi i cili edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijëni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. Pikërisht ne përmbushje të sa me sipër vepronë oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të cilët yejnë dhe çdo lloj veprim hetimor që i është urdhëruar apo deleguar nga prokuroria... ”. Po kështu, në analize të kësaj dispozite del qarte se policia gjyqësore ka detyrimin që të marrë dijëni për kryerjen e çdo veprë penale që ndiqet. Për shkak të karakterit detyrues që ka, policia gjyqësore duhet të përfitojë me iniciativën e saj dijeninë e veprës penale, qoftë dhe nga dijenia apo njoftimi nga të tretet. Dhe jo vetëm kaq, por në një interpretim të normave procedurale mbi kompetencat e këtij organi, del qarte fakti që policia gjyqësore ka një lloj autonomie në kryerjen e këtyre veprimeve, e cila reflektohet në “detyrimin për kryerjen e gjithçkaje” që i shërben ligjit penal apo në kërkimin e autorit të veprës penale, për të cilin ajo ka marrë dijëni.

159. Në informacionet e dërguara nga oficeri i policisë gjyqësore, të pranuar si prova-ndicje nga gjykata (të trajtuara me lart në këte vendim), jepet në mënyrë të detajuar dyshimet që ai ka në lidhje me personat (këta të fundit të individualizuar në informacionet që jep OPGJ), të cilët mund të kryejnë veprime korruptive (madje këto të fundit jepen dhe konkretisht). Në këte informacion, jepen dyshimet që ekzistojnë për veprimet që mendohet se personat që dyshohen se kanë kryer deri tani (me gjykatat dhe punonjësit e AKKP), si dhe veprimet që mendohet se mund të kryejnë në të ardhmen për të finalizuar qëllimin e tyre. Pikërisht këto informacione, siç thuhet edhe në material, janë siguruar nga oficeri i policisë gjyqësore në “*rruge operative, nga individë dhe burime që kanë informacione për grupe të dyshuara si kriminale*”.

160. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se sigurimi i këtij informacioni nga oficeri i policisë gjyqësore është bërë në përmbushje të funksionit të tij ligjor, parashikuar në dispozitat procedurale të interpretuara në këte vendim dhe se informacionet e siguruara deri në atë moment nga OPGJ, nga burimet e tij të informacionit ishin për momentin indicje të mjaftueshme, që e detyronin këte të fundit për të raportuar para prokurorit. Siç ka rezultuar dhe me vone, këto fakte kanë rezultuar të rëndësishme dhe kanë qenë të sakta, në përputhje me njëra tjetrën dhe janë vërtetuar. Këto fakte, dalin qarte edhe nga deklaratimet e dhëna nga Z. Petrit Gjeçaj me detyrën e OPGJ, në seancën gjyqësore të datës 27.2.2017, ku ai është pyetur me cilësinë e dëshmitarit. Mes të tjerash, ky dëshmitar ka deklaruar se: “*...informacioni merret në rrugë operative nga njerëz nga burim të ndryshme duke shfrytëzuar dhe njohjet personale. Burimi ka qenë njeri i besuar i imi, rrugët operative janë duke u konsultuar me disa njerëz për çdo dyshim ku pasi verifikohen të gjitha veprimet ky informacion zbardhet në letër... kam detyrimin që për çdo shqetësim publik pasi e shqyrtoj dhe kur ka dyshime ja referoj prokurorit ...çdo shqetësim që është në shkelje të ligjit unë e marr si informacion dhe me pas e shqyrtoj, kur krijohet bindjen se ka dyshim të arsyeshëm ja kaloj prokurorit i cili shprehet me vendim e në rast të fillimit të ndonjë procedimi shprehet me pas edhe gjykata... ”.*

161. Bazuar në informacionin e mësipërm, Prokurori K. Braho në datë 03.06.2016 vendosi: “*Lejimin e menjëhershëm të përgjimit të bisedave dhe komunikimeve telefonike për nr 0697612754 në përdorim të pandehurit Ilia Cabiri, fillimisht për një periudhë 15 ditore... ”, duke i kërkuar po në këte datë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Renda, vleftësimin si të ligjshëm të këtij vendimi. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Renda me vendimin e saj me nr. 386, datë 4.6.2016 ora 9:00 vendosi: “*Pranimin e kërkesës së prokurorisë. Vleftësimin si të ligjshëm të vendimit të prokurorit datë 03.06.2016 për përgjimin telefonik të numrit celular 0697612754, dhe lejimin e përgjimit të këtij numri për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar ky afat nga data 03.06.2016 ora 10.00.... ”.**

162. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Renda me nr. 386, datë 04.06.2016 është marrë në respektim të ligjit procedural penal dhe për rrjedhojë të gjitha transkriptet dhe procesverbalet e përgjimeve të telekomunikimeve që janë rrjedhojë e këtij vendimi, duhet të pranohen dhe të merren me cilësinë e provës në respektim të nenit 149 të K.Pr.Penale.

163. Po përse themi që ky vendim është i drejtë dhe i bazuar në ligjin procedural penal dhe konkretisht në nenet 221/1/a dhe 222/1 të K.Pr.Penale. Përse të kalojë në këto analize, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, edhe përgjimi është një mjet për kërkimin e provës siç janë dhe të gjitha veprimet e tjera paraprake që kryejnë organet e procedimit si këqyrja, kontrolli, sekuestro etj, nëpërmjet të cilit merret apo përfitohet njohja e komunikimit i kujtdo lloji, forme apo mënyre qofte ai, ndërmjet dy apo me shumë personave. Duke ditur që prova është dijenia mbi faktin dhe rrethanat për kryerjen e veprës penale (neni 149 i KP), arrihet në përfundimin se rezultatet e përgjimit, pra njohja e komunikimit është prove, pasi është ajo që jep njohje mbi faktin.

164. Në respektim të drejtave kushtetuese të shtetasve, ligjvënësi kur ka parashikuar dispozitat konkrete për përgjimin në Seksionin IV, ka bërë shumë kujdes në mënyrë që të mos preken garancitë që jepen këtyre shtetasve të parashikuara në Kushtetute, si dhe të mos cenohet parimi proporcionalitetit. Bazuar në ligjin tone me të lartë, Kushtetutën, të drejtat dhe liritë e shtetasve mund të kufizohen vetëm me ligj, për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve, në përpjesëtim (ky kufizim) me gjendjen që e kanë krijuar atë dhe pa tejkaluar kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

165. Në nenin 221/1.a të K.Pr.Penale, thuhet shprehimisht se: *“1. Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike të bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, lejohen vetëm kur procedohet: a) për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënimi me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet; --- 3. Përgjimi mund të urdhërohet kundër: a) të dyshuarit për kryerjen e një veprë penale; b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari; c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin; ç) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit. 4. Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit. 5. Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë”.*

166. Në analize të kësaj dispozite, kuptojmë se: Është parashikuar si garanci apo siguri themelore për mbrojtjen e subjekteve nga devijimet e mundshme: (i) kufijtë e lejimit të përgjimit si dhe (ii) kompetenca e gjykatës. Kështu, si garanci është parashikuar që lejohet përgjimi në rastet kur bëhet fjalë për krimet e kryera me dashje dhe për të cilat parashikohet dënimi me burgim jo më pak në maksimum se shtatë vjet... Ndërsa të dallueshëm për nga subjekti mbi të cilin drejtohet përgjimi, parashikohen: a) rastet kundër të dyshuarit për kryerjen e një veprë penale, b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari, c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin d)

167. Gjate shqyrtimit nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Renda të kërkesës për vlefësimin e përgjimit për nr. e telefonit të shtetasit Ilia Çabiri, ka rezultuar se, Prokuroria për Krime të Renda kishte regjistruar procedimin penal nr. 104, vitit 2016, e cila bënte fjalë për *“korrupsion pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë “parashikuar nga nenet 319 dhe 319/c të KP si dhe veprat penale të “Korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendore dhe “Korrupsioni pasiv pasiv i*

funskiona freve te larte shteterore ose i te zgjedhurve vendore “parashikuar nga nenet 245 dhe 260 te KP. Gjykata ne vendim e saj ka bere një analize te hollësishme te fakteve qe ekzistonin deri ne atë moment, bazuar kjo ne informacionin qe jepte vendimi prokurorit, si dhe kërkesa e tij parashtruar gjykatës. Ka analizuar veprën penale per te cilën kishte filluar procedimi penal, dyshimin e arsyeshëm se subjekti po merrej me veprime koruptive dhe mund te konsumonte veprat per te cilat kishte filluar ky procedim, karakterin vazhdues te këtyre veprimeve, faktin qe ngjarja mund te ndodhte si dhe domosdoshmërinë e përgjimit te gjitha komunikimeve hyrëse dhe dalëse te nr celular te dyshuarit Ilia Çabiri.

168. Gjykata ka konstatuar se procedimi penal i filluar nga organi i akuzës, ishte regjistruar per vepra penale te parashikuara nga nenet 319, 319/ç, 245 dhe 260 të Kodit Penal, nga të cilat, vepra penale e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, parashikon një dënim në maksimum deri në dhjetë vjet burgim, ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal parashikon një dënim në maksimum deri në dymbëdhjetë vjet burgim. Ne këto kushte, kjo gjykate, pasi i ka gjetur ne rregull dhe ne përputhje me ligjin “Kufijtë e lejimit” ka vlerësuar si te ligjshëm vendimin e prokurorit per përgjimin telefonik te numrit te celularit 0697612754 dhe lejimin e përgjimit të tij për një periudhe 15 ditore, duke filluar ky afat nga data 03.06.2016 ora 10.00.

169. Per sa me sipër, pretendimi i ngritur nga ana e mbrojtjes se gjykata nuk ka verifikuar dhe respektuar kufijtë e lejimit te përgjimit te parashikuar nga ligji, nuk qëndrojnë. Per vete natyrën qe ka ky vendim, i cili behet pa praninë e palëve, duke mos iu nënshtruar parimit te kontradiktoritetit si dhe duke mos njoftuar palët, është vete gjykata ajo e cila kryen funksionin e kontrollit dhe te sigurisë, si ne drejtim te respektimit te ligjshmërisë se përgjimit, ashtu dhe ne respektim te parimit te ruajtjes dhe moscenimit te se drejtës private (privacise) te gjithë atyre qe janë jashtë procedimit penal. Kurse, per ata subjekte per te cilët vihet përgjimi, ligjvënësi ka parashikuar qe vendimi te jete i motivuar. Gjykata ne ketë faze gjykimi, nuk ka si te dije apo parashikojë nëse me vone subjekti i cili vihet ne përgjim do rezultojë apo jo fajtor do ta kryeje apo jo veprën penale, do përgjigjet per një apo me shume vepra penale (pasi po te diheshin këto, s’kishte me nevojë per përgjim). Ne ketë faze procedimi, gjykata nisur nga ato qe i parashtron organi procedurës, ne rast se vlerëson se ka prova, indicje te mjaftueshme se do te kryhet një vepër penale, kjo e fundit dënohet maksimumi 7 vjet dhe se përgjimi është i domosdoshëm per vazhdimin e hetimeve te filluara, bazuar dhe ne bindjen e saj te brendshme, vendos te pranoje apo te rrezoje kërkesën e prokurorit.

170. Nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se te pandehurve se, kjo gjykate ne dhënien e vendimit nr. 386, date 04.06.2016 nuk ka respektuar nenin 222/1 te K.Pr.Penale. Ligjvënësi ne ketë dispozite, kur flet per prova ka parasysh faktin e ekzistencës se tyre para paraqitjes se kërkesës ne gjykate nga ana e organit procedurës, si dhe domosdoshmërinë per vazhdimin e hetimeve te filluara. Pra përgjimi është i mundur te lejohet atëherë kur është rasti se mund te ndodh një vepër penale ne vazhdimësi, ose ekziston një procedim i lidhur, nga i cili pritet apo është ne vazhdim kryerja e një ose disa veprave te tjera penale. Kjo, pasi ç’kuptim dhe çfarë vlere do te kishte përgjimi nëse vepra penale ishte kryer dhe per te ekzistonin te gjitha provat. Sipas se drejtës sonë penale “*përgjimi mund te klasifikohet si një mjet i sofistikuar per kërkimin e provës*”.

171. Siç e thamë dhe me lart ne ketë vendim, prova ne kuptim te nenit 149 te K.Pr.Penale “*është njoftimi apo dija mbi faktin*”, duke përcaktuar se nga pikëpamja substanciale, per shkak te njohjes ajo është e afte te krijojë bindjen mbi ekzistencën e faktit. Ne analizën qe i behet nenit 151 dhe 152 te K.Pr.Penale del konkluzioni se jo thjesht ekzistenca formale e provës, por verifikimi i qenësisë substanciale te provës, është ajo suate qe te krijon besimin per ekzistencën e faktit. Çmuarja e provës është përcaktimi i vertetesise dhe fuqisë provuese te tyre. Pikërisht, çmuarja e

provës ne analize te nenit 152 te K.Pr.Penale, ne të cilën pasqyrohet se “*është gjykata ajo e cila vlerëson vertetesine dhe fuqinë e provës, sipas bindjes se saj te brendshme*”, behet sipas bindjes se brendshme te gjykatës, pas shqyrtimit te tyre ne tërësi.

172. Po te marrësh dhe te analizosh pikërisht kushtet kur u mor vendimi nr. 386, date 04.06.2016 nga Gjykata e Shkalles se Pare te Krimeve te Renda, rezulton qarte se te gjitha informacionet e dhëna nga OPGJ ishin te rëndësishme, te sakta dhe ne përputhje me njëra tjetrën duke plotësuar kushtin e parashikuar ne nenin 152/1.2 te K.Pr.Penale. Ne nenin 152/2 te K.Pr.Penale parashikohet se: “*ekzistenca e një fakti nuk mund te nxirret nga indicjet perveçse kur këto janë te rëndësishme te sakta dhe ne përputhje me njëra tjetrën*”. Referuar te drejtës sonë procedurale, nëse prova-indicje nuk është një e vetme, por ka disa, janë te rëndësishme, te sakta dhe ato përputhen me njëra tjetrën, ligjvënësi i kategorizon ato si te mundshme qe te japin njoftimin mbi faktin objekt i te provuarit dhe per këtë, ato janë te afta per te krijuar bindjen tek gjyqtari per ekzistencën e faktit penal.

173. Ne çështjen objekt gjykimi, ne materialet e referuara nga OPGJ, ne vendimin e prokurorit te datës 03.06.2016, si dhe ne vendimin e gjykatës nr. 386, date 04.06.2016, ne gjejmë një sere prova –indicje te cilat kane lidhje me njëra tjetrën , janë te rëndësishme, janë serioze dhe te sakta, te cilat jo vetëm qe nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por ato mbështesin njëra-tjetrën dhe janë ne vazhdimësi. Këto prova-indicje, shërbejnë vetëm per njoftimin mbi rrethanat dhe faktin dhe nuk ka lidhje me fajësinë apo akuzën e te pandehurit, te cilat ne fund dhe mund te mos realizohen ne rast se vepra penale nuk kryhet. Ndërkohe, vepra penale per te cilën kishte filluar procedimi penal, u vërtetua qe kishte karakter vazhdues. Sa me sipër u konfirmua nga te gjitha transkriptet dhe procesverbalet e përgjimit ne vazhdimësi te pranuar si prova nga kjo gjykate, si dhe nga veprimet dhe u kryhen nga i dyshuari I. Çabiri si dhe te dyshuarit e tjerë ne vazhdim.

174. Ne këtë aspekt, vendimi i Gjykatës se Shkalles se Pare per Krime te Renda nr. 386, date 04.06.2016, është një vendim i marre konform dispozitave te ligjit procedural per sa kohe ai është marre: (i) brenda kufijve te lejuar nga ligji; (ii) është përcaktuar qarte personi kundër te cilit autorizohet përgjimi; (iii) janë përcaktuar subjektet te cilët do te realizojnë përgjimin; (iv) është përcaktuar lloji i përgjimit, i cili futet ne kategorinë e përgjimit privat duke përgjuar te gjitha komunikimet, bisedat, telefonatat hyrëse dhe dalëse etj; (v) si dhe objekti i përgjimit ka një akt te motivuar nga ana e organit procedurës ne lidhje me lejimin e këtij përgjimi konform ligjit ne te cilën janë parashtruar ne mënyre te detajuar arsyet se perse duhet te vendoset përgjimi; (vi) del qarte domosdoshmëria per vendosjen e subjektit nen përgjim per shkak te vazhdimësisë se veprimeve qe ai kryen per realizimin e veprës penale; (vii) ka prova te mjaftueshme ne momentin e pare per vërtetimin e ne te ardhme te akuzues; (viii) është përcaktuar qarte kohëzgjatja e përgjimit, si dhe procedura qe duhet ndjekur; (viii) ekzekutimi i tyre dhe dokumentimi përkatës i veprimeve interceprive; (ix) si dhe e drejta e ankimit te subjektit kur vihet ne dijeni per këtë përgjim.

175. Ne përfundim te kësaj analize, ky Kolegj vlerëson se transkriptet dhe procesverbalet e përgjimit qe rrjedhin nga ky vendim, si dhe nga vendimet e tjera te kësaj gjykate (dhe per vendimet e tjera te marra nga Gjykata e shkalles se Pare per Krime te Renda me nr. 465, datë 07.07.2016; nr. 468, datë 09.07.2016 dhe nr. 477, datë 13.07.2016 vlen i njëjti arsyetim ligjor), nuk mund te deklarohen te papërdorshme, pasi ajo janë marre ne përputhje me ligjin dhe këto prova janë te vlefshme per gjykatën ne marrjen e vendimit te saj. Paperdorshmeria si sanksion qe i vishet provës per shkak te rëndësisë se veçante qe ka, mund te ndodhe vetëm ne ato raste kur kjo e fundit merret ne shkelje te parashikimeve ligjore, ne mënyre qe ajo te jete e dobishme per gjykatën ne përfundim të gjykimit kur do te marre vendimin.

176. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se nuk qëndron gjithashtu pretendimi i mbrojtjes se të pandehurve se, rezultatet e përgjimeve të përfuara si rrjedhim i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Renda nr. 386, datë 04.06.2016 (për vënien në përgjim të nr të telefonit të këtij të pandehuri) nuk duhet të pranohen dhe ato duhet të konsiderohen “*te papërdorshme*”, pasi kjo e fundit në vendimin e saj i është referuar “*Përgjimit parandalues*”. Ky Kolegj, nisur nga natyra e këtyre përgjimeve, lloji i tyre, organi që e ka vlerësuar dhe që e ka vendosur, mënyra se si është parashikuar të realizohet ai, përcaktimi në mënyrë të individualizuar i subjektit që është vënë në përgjim dhe që mendohet se mund të kryejë një veprë penale, afati, mënyra e ekzekutimit, përcaktimi i subjekteve që do ta ekzekutojnë etj, konstaton se nuk jemi para përgjimeve me natyrë “*parandaluese*” dhe nuk ka se si përgjimet e mësipërme të karakterizohen si përgjime me karakter parandalues.

177. Përgjimi parandalues, ndryshe nga përgjimi privat, nuk rregullohet nga K.Pr.Penale, por nga Ligji nr. 9157, datë 04.12.2003. Fusha e zbatimit të këtij ligji është e lidhur me veprimet e institucioneve shtetërore informative për zbulimin e veprimtarive antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse. Ajo që dallon këtë lloj përgjimi nga ai privat, ku ky i fundit parashikohet drejtpërdrejt në K.Pr.Penale, është fakti që vendimi i përgjimit me natyrë parandaluese merret nga Prokurori i Përgjithshëm (dhe jo nga gjykata siç merret vendimi për përgjimin privat), ose prokurori i autorizuar prej tij, me kërkesë të institucioneve përkatëse (neni 8 i ligjit). Përgjimet e parashikuara në K.Pr.Penale (si në rastin objekt gjykimi), zbatohen vetëm për rastet e një procedimi penal të filluar dhe autorizohen nga gjykata dhe prokurorët, duke patur si qëllim vërtetimin e veprës penale për rastin konkret. Ndërsa përgjimi parandalues, kërkohet nga institucionet informative me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm apo një prokurori të autorizuar prej tij, dhe ka si qëllim zbulimin e veprave penale. Rezultatet e përgjimit parandalues nuk mund të përdoren si prova, kurse transkriptet e bisedave të përgjuara me vendim të gjykatës, janë prova për provimin e veprës penale etj.

178. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se është i pabazuar pretendimi i mbrojtjes se të pandehurve se, përgjimi dhe transkriptet e tyre janë të papërdorshme, pasi gjykata në vendimin e saj i është referuar përgjimit parandalues. Përfundimisht Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se provat e mësipërme janë marrë në përputhje me parashikimet e K.Pr.penale, harmonizohen me njëra tjetrën dhe provojnë faktet objekt akuze. Ky Kolegj, në përfundim të këtij gjykimi, bazuar në provat e administruara në proces, deklaratimet e dëshmitareve si dhe të pandehurve (ata që kërkuan të jepnin shpjegime), të vlerësuara këto deklaratime në unitet me të gjitha provat e tjera dhe faktet objekt akuze, të paraqitura si nga organi akuzës dhe nga mbrojtja e të pandehurve, arrijnë në përfundimin se nga ana e të pandehurve janë konsumuar veprat penale për të cilat ata akuzohen.

179. Nga analiza sa më sipër, del qartë kryerja e veprës penale nga i akuzuari Ilia Çabiri. Ai është subjekt i veprës penale dhe rezultoi person i përgjegjshëm para ligjit.

180. Po kështu, u provua gjatë gjykimit konsumimi nga ana e të pandehurës Eleni Lino, të elementeve të veprës penale për të cilën ajo akuzohet. Siç u trajtua edhe më lart në këtë vendim, edhe e pandehura Eleni Lino, në cilësinë e trashëgimtares së ish-pronarit Spiro Mihal Gjoka, ishte e interesuar që të kthehej prona prej 40 ha, e ndodhur në rrethinat e Ksamilit, Sarandë. Ajo kishte lidhje familjare me të pandehurin Petraq Dashi (kushëriri me gruan e tij) dhe njohje me Ilia Çabirin, të cilin e kishin autorizuar të merrej me gjithë procedurën për njohjen e kthimin e pronës. Për këtë të pandehur, mbrojtja pretendoi se ajo nuk kishte konsumuar veprën penale për të cilën ajo akuzohej pasi sipas saj, ajo thjesht ishte interesuar për mbarëvajtjen e procesit. Ajo nuk ishte marre me asnjë procedurë, pasi me këtë ish-in marre persona të tjerë të ngarkuar nga nëna e saj që

kur ajo ishte gjalle. Ajo nuk e njeh te pandehurën Majlinda Andrea dhe asnjëherë nuk ka premtuar, propozuar apo dhëne ndonjë përfitim te paligjshëm ne shkëmbim te një vendimi ne favor te saj.

181. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, pasi dëgjoji konkluzionet përfundimtare te mbrojtjes se te pandehurës, si dhe mori ne shqyrtim provat mbi te cilat mbrojtja kërkon te mbështesë kërkesën e saj per pafajësinë e te pandehurës Eleni Lino, vlerëson se këto pretendime te mbrojtjes janë te pabazuara ne provat e pranuar per shqyrtim ne këtë proces gjyqësor, si dhe nga veprimet e kryera nga kjo e pandehur. Pa përsëritur ato qe u thane me lart ne këtë vendim (kur u analizuan provat dhe veprimet e te pandehurit Ilia Çabiri), rezulton e provuar se edhe e pandehura Eleni Lino ka qene ne dijeni te gjitha veprimeve qe po kryenin te pandehurit e tjerë, ka qene dakord me ta dhe ka pranuar qe te jepet shpërblim ne Gjykatën e Larte, ne kompensim te marrjes se vendimit ne favor te tyre.

182. Kështu, siç vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07.07.2016 (fq 136-137 e dosjes vol 2), ne datën 7 Korrik ajo ka biseduar me Petraq Dashin në orën 13:13 p.m dhe nga biseda e zhvilluar del qarte interesimi qe ka e pandehura Eleni Lino per çështjen ne fjale, si dhe fakti qe ajo është dakord qe te takohen ne Gjyrokastër se bashku me te pandehurin Ylli Çabiri per te biseduar per “*koston*” qe duhej per Gjykatën e Larte. Fakti qe do bisedonin per “*koston*” shpërblimin ne Gjykatën e Larte, del edhe nga biseda e Petraqit me Yllin e analizuar me lart ne këtë vendim dhe nga biseda qe zhvillon po ne këtë dite Eleni me Yllin.

Eleni : *O, Petraq, ç'bëni ?*

Petraqi : *Ee, për atë të mora sepse nesër i thash dhe Yllit, nga ora 11-11 e 30, do takohemi aty në Gjyrokastër.*

Eleni : *E mir, shum mir, ndonjë lajm të mirë ?*

Petraqi : *I mir, i mir, po hajt.*

Eleni : *E mir pastaj, nga ora 11 e 30, e ?*

Petraqi : *Po, po, hajt.*

183. Katër minuta pasi mbaron bisedën me të pandehurin Petraq Dashi, e pandehura Eleni Lino siç vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07.07.2016 (fq 140 e dosjes vol 2), ka folur ne telefon (po ne datën 07.7.2016) me të pandehurin Ilia Çabiri. Midis tyre është zhvilluar kjo bisede:

Ilia : *E Lenica ?*

Eleni : *O Ylli ç'kemi ?.....*

Eleni : *Mir, të mori Petraqi ?*

Ilia : *Edhe mua e, edhe ju ju mori ?*

Eleni : *E tani sapo më mori dhe thoshja prit se isha unë nja një javë tutje dhe thash të të marr Yllin për ndonjë të re dhe dje harrova, kur më mori tani Petraqi, me tha do vi nesër në 11:30, do vij dhe Ylli tha të bisedojmë.*

Ilia : *E, është ajo për Gjykatën e Lartë, nuk e di tani ç'a kanë bërë ...*

Eleni : *E, i thashë unë ndonjë lajm të mirë ? Të mirë, të mirë, më tha mua po kaq.*

Ilia : *Ka kosto, ka kosto.*

Eleni : *E kuptova unë që tha, edhe unë për atë mendova për koston, e për koston.*

Ilia : *Ajo është tani t' shohim, po ajo tani s'është me 2000 evro, e 3000 evro.*

Eleni : *Po sa do të jetë shuma andeja ?*

Ilia : *Nuk e, do bisedojmë, s'më tha gjë në telefon.*

Eleni : *Edhe mua s'më tha gjë, se kaq më tha. I thashë unë ndonjë lajm të mirë ? I mir, i mir, më tha mua, po e kuptova që do të thotë për lek.*

Ilia : *Patjetër mo, se s'bëhen ashtu ato, e kam thënë atë muhabet me koh un.*

Eleni : *E, të na besojnë neve që sa kemi harxhuar që ishim këteja.*

Ilia : *Unë der tani, përvec tuajat që dhatë ti edhe Petraqi, kam harxhuar 8000 euro, 9000 euro, të miat.*

Eleni : *Do t'ja themi sa kemi harxhuar, ne kemi harxhuar kaq do ti themi.*

Ilia : *une i kam me ashu bankare mo te tera i kam me ashu*

Eleni : *Emo mir qe ke ti themi , une jo qe makar te kisha ti jipja jo qe skam po edhe sikur te kisha do benim llogarine , kaq jemi neve , kaq jorgjia , kaq mihali , le ti japi mihali po ska ai , ai ka*

Ilia : *neser do degjo cik tani*

Eleni : *tani llafosemi tani llafosemi bashke ai per te patur ka nuk dua qe te them skam une ose ka tjetra ose ka tjetra ai ka ,*

Ilia : *tani llafosem me ty une*

Ilia : *duhet te jemi sa me t bashkuar per kete problem pasi tani eshte finalja*

Eleni : *Duhet te jemi te bashkuar por eshte puna qe kur ske cte bejme kur ska pa*

Ilia : *Po mire mo do bejme do.... ne borxhe ca do bejme o, une ckisha ato 8000-9000 evrot e mia pervec tuajat qe vajten larte*

Ilia : *Tani nuk do zëm të tilla llogarira, sepse tani po, është halli se të kthyen prapë në shkallë të parë, e në shkallë të dytë, u dogjëm, është kot na venë dëm ato.*

Ilia : *Tani, ne nuk e dimë sa kanë kërkuar.*

Eleni : *Nuk e dimë, jo, themi neve, pa.*

Ilia : *Do të rrimë ta dëgjojmë, do vi unë, do llafosemi, do vi më shpejto un atje.....*

Eleni : *e ndonje lajm te mire i thashe une , te mir me tha mua te mir poo, me la keshu dmth e kuptova une thashe....*

Eleni : *E mir, mir.*

Ilia : *Po mendimi im është që të bëjmë sakrifica që ta mbarojmë këtë muhabet.*

Eleni : *Duhet bërë sakrificë, po kush ta bëj sakrificën se, kur nuk ke ...*

Ilia : *Do vrasim veten se ndryshe tani na ven puna dëm, 10 vjet punë na vete dëm, ne vetëm me këtë llaf.*

Eleni : *Degjo degjo ne rast se jane shume e rregullojme pastaj me vone prape me njeri tjetrin neve po skemi tani me kupton tani....*

Ilia : *te mora vesh*

Ilia : *na vete dem gjithë puna te gjitha shpenzimet*

Eleni : *E di, e di, prandaja të them, në qoftë se ka ai, po jan kaq shumë ?*

Ilia : *Un do vi më shpejto ...*

Eleni : *Le ti japi ai dhe e rregullojmë më vonë pastaja neve, mos e neve përshëmbull, neve i dimë kto gjëra që jan të tilla. Makar të jetë dhe ashtu të mos jetë ndonjë pengesë tjetër, makar të jet dhe ashtu.*

Ilia : *Hajde, do llafosemi, do ...*

184. Nga kjo bisede, vërtetohen faktet si me poshtë:

(i) e pandehura Eleni Lino bie dakord qe te takohet me te pandehurit e tjerë, per te biseduar dhe ajo e di qe qëllimi i bisedës është shpërblimi qe do te jepet, pasi i pandehuri Ilia i thotë: “ka kosto, ka kosto” dhe vete Eleni pohon qe edhe ajo ketë kishte kuptuar, qe biseda do te behej per koston. Ndërkohe ajo pyet se sa mund te jete, por Ilia i përgjigjet qe ende nuk e di se Petraqi nuk ja ka thënë.

(ii) Nga biseda del qarte fakti qe te dy te pandehurit janë te shqetësuar per sasinë e shpërblimit, pasi ata kane harxhuar dhe deri tani shuma te caktuara. *“Eleni: Do t’ja themi sa kemi harxhuar, ne kemi harxhuar kaq do ti themi”*, ndërkohë bien dakorte qe po te gjendet dikush ta japë shpërblimin ata bien dakord qe te rregullohen me vone me njeri tjetrin. Ky fakt, tregon vullnetin e tyre dhe dashjen per te dhëne shpërblim , qofte dhe nga një i trete per marrjen e vendimit te favor te tyre. Ata pranojnë qe duhet te bëjnë sakrifice, ne mënyre qe mos tu iki mundi i 10 vjetëve. *“Eleni: Le ti japi ai dhe e rregullojmë më vonë pastaja neve, mos e neve përshëmbull, neve i dimë kto gjëra që jan të tilla. Makar të jetë dhe ashtu të mos jetë ndonjë pengesë tjetër, makar të jet dhe ashtu”*.

(iii) Nga biseda del qarte premtimi per te dhëne shpërblim ne këmbim te përfitimit te vendimit qe do te jete ne favor te tyre. Në përfundim, konfirmohet fakti se të nesërmen do takoheshin në Gjirokastër të tre, për të marrë vesh, konkretisht se sa duhej të paguanin dhe se si do e realizonin pagesën.

185. Siç rezultoi dhe nga analiza qe u me be lart ne këtë vendim, ne datën 8 Korrik 2016, i pandehuri Petraq Dashi ka shkuar në Gjirokastër dhe është takuar me të pandehurit Ilia Çabiri dhe Eleni Lino. Takimi është zhvilluar në dyqanin e Eleni Linos. Fakti që takimi është zhvilluar në dyqanin ku punonte e pandehura Eleni Lino, konfirmohet nga procesverbali i bisedave telefonike te datës 10 Korrik 2016, e zhvilluar ndërmjet të pandehurve Eleni Lino dhe Petraq Dashi, ku ndërmjet te tjerash i pandehuri Petraq i thotë të pandehurës Eleni: *“ashtu e para dhe e dyta, e di ç’më tha atje prapa banakut ai, (e ka fjalën për të pandehurin Ilia) kur po merreshe me atë ti, që erdhi për sandalle?”*. Në këtë takim tre të pandehurit kanë biseduar në lidhje me shumën që kërkohej për t’u paguar në Gjykatën e Lartë.

186. Fakti qe tre te pandehurit janë takuar ne Gjirokastër dhe qe kane biseduar pikërisht per *“Koston”*, vërtetohet dhe nga procesverbali *“Per përgjimin e telekomunikimeve”* te datës 08.07.2016 (fq 149 e dosjes vol 2), ku nga biseda e zhvilluar mes te pandehurit Petraq Dashi dhe një shtetasi me emrin Malo, pasi ka mbaruar ky takim, bisede e zhvilluar ne orën 24: 11 p.m. të datës 8 Korrik 2016, del qarte qëllimi i takimit, muhabetet qe ata kishin bere, shqetësimin se ku do gjendeshin leket, pasi Eleni shprehej qe nuk kishte mundësi, fakti qe Ilias i ishte lënë detyre qe te fliste me bashkëpronaret e tjerë per te kontribuar te gjithë etj.

Petraqi : *E, Malo.*

Malo : *E re Petro, ku je ?*

Petraqi : *Ja ktu, po kthehem tani.*

Malo : *He, ça bëre ?*

Petraqi : *Ee, ato muhabete që prisja, i thash Yllit, se Lenica thoshte s’kam, s’kam..... s’prisja un ndonjë gjë, tani për un, për të mos thënë që dakort, un jam shumë, shumë në siklet - i thash unë, se s’mund ti gjej për 3 – 4 ditë aq lek...*

Malo : *Ehe, ehe.*

Petraqi : *Kshu që, ça do bëjmë.*

Malo : *Ee.*

Petraqi : *Ylli, ti, i thashë un, t’del për detyrë të dalësh atje, ti thuash atyre miqve, sikur sonte t’shkosh n’Tiranë, a ti marrësh n’telefon, ta ndash muhabetin, sa do kontriboni. Jo tha, un n’qoftëse nuk kontrobojnë me lek ata, tha do ti them sa zbrisni tha nga 15 –shja, më kupton ? që kan pjesë.*

Malo : *Po, po.*

Petraqi : *Edhe kjo është ashtu, i thash un. Dakort, më kupton ?*

Malo : *Po.*

Petraqi : *Po jo, po ti bëj njëher muhabet të hënën, se mos ai bie dakort, që ti bëj me kto, me kto. Mir se e bëj un muhabetin i thash un, edhe ktë, po po qe se s'ra dakort ai, qysh do ti bëjmë ? Ku do ti gjejmë ? Na ngeli pikpyetja ku do gjënden pastaj.*

Malo : *Ehe.*

Petraqi : *Që ta shtrydh Yllin sa t'kem mundësi.*

Malo : *Po.*

Petraqi : *Edhe pastaj ti jap në momentin e fundit, ti them okej..., i gjeta, më bëni kaq, më detyroheni kaq. Po do vi ti bëjmë muhabetet.*

187. Ndërkohe, rezulton se e pandehura Eleni Lino vazhdonte te kishte kontakte me dy te pandehurit e tjerë, qofte duke i marre ne telefon dhe duke u interesuar ne lidhje me çështjen dhe shpërblimin, qofte dhe duke kryer veprime aktive duke i takuar ata. Ky fakt, vërtetohet me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 10.07.2016 (fq 159-160 te dosjes vol 2), ku ne datën 9 Korrik 2016, në orën 12 e 20 p.m., e pandehura Eleni Lino ka marre ne telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës rezulton se e pandehura Eleni kërkon të dijë nga i pandehuri Ilia, nëse mori përgjigje nga takimi qe ky i fundit kishte pasur me bashkëpronaret e tjerë dhe ai i thotë se deri ne darke, do te kishte një përgjigje. Siç rezulton nga konteksi i gjithë bisedave te zhvilluara dhe me vone mes te pandehurve Petraç dhe Ilia, takimi me bashkëpronaret do te behet me qellim sigurimin e shpërblimit per çështjen ne Gjykatën e Larte.

188. Siç vërtetohet me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 10.07.2016 (fq 84-91 te dosjes vol 2), ne datën 10 Korrik 2016, në orën 18:39 p.m., i pandehuri Petraç Dashi merr në telefon të pandehurën Eleni Lino. Nga përmbajtja e bisedës të zhvilluar ndërmjet tyre dhe qe jepet me poshtë ne këtë vendim, dalin qarte dhe konfirmohen përsëri disa fakte te rëndësishme.

(i) Konfirmohet fakti se i pandehuri Petraç kishte vazhduar veprimet konkrete duke u takuar me personat qe kishin marre përsipër zgjidhjen e kësaj çështje;

(ii) Ai kishte bere propozimet konkrete, duke propozuar qe shpërblimi te ishte ne te holla ose ne natyre (sipërfaqe toke); dhe kishte marre përgjigje qe shpërblimi kërkohej ne te holla po nga 60 ishte bere 50;

(iii) konfirmohet fakti qe tre te pandehurit do takoheshin te nesërmen ne Fier per te biseduar per sigurimin e kësaj shume;

(iv) konfirmohet gatishmëria e Elenit per te kontribuar me sa te mundet, si dhe dijenia e saj per masën e shpërblimit dhe fakti qe ajo është e gatshme te nënshkruaje aktin noterial qe kërkon Petraçi;

(v) nga biseda konfirmohet fakti qe shumë Petroçi mund ta siguroje edhe nëpërmjet një miku te tij dhe Eleni pranon qe te gjejnë dike qe ti ndihmoje dhe pastaj rregullohen.

Petraçi : *O Lenica.*

Eleni : *Urdhro.*

Petraçi : *Petraçi jam.....*

Petraçi : *Nga ato që bëm neve muhabetet, me propozimet që i thash me tok, ose me kshtu, më kupton?*

Eleni : *Po.*

Petraçi : *Ai nuk pranoj, se i do lek të thata, dakort ashtu, tani dhe i vetmi lajm i mir, është që nga 60 e uli 50.*

Eleni : *50 ?*

Petraçi : *Më kupton ?*

Eleni : *Po.*

Petraqi : Kjo është llaf i fundit, tani un nuk e di as vet se si e se qysh do bëjm nesër, po di t'them këtë, se sa po fola dhe me Yllin, po ai ishte atje n'mes të liqenit, po gjuante për peshk.

Eleni : Për peshkim ?

Petraqi : Dhe un nesër do ti them Yllit, edhe tyja, që na ora 08:30 - 09:00 - 09:30 të jeni ktu në Fier.

Eleni : Vim o t'kegen, po e di sa jam mërzhitur, nuk më zë gjumi natën dhe më jan bër

Petraqi : Mir, mir, dëgjo Petraqin, dëgjo.

Eleni : Jo, nuk më kuptove, ngaqe u gjënda kshu edhe më duket sikur të vim deri në këtë pike edhe të mos, ti ke të drejt, un në fakt nja 20 do rregullohem me Petraqin thash, ja për kok të fëmijve po s'kam thën kshu.

Petraqi : Tani, dëgjo mua që të kesh iden ti për ç'a do vish nesër.

Eleni : Po ?

Petraqi : Un kam shpresa nga një miku im të më ndihmoj.

Eleni : Mbase do perendia të na ndihmoj Petraq, pa pastaj e gjejmë pastaj, më von e gjejmë.

Petraqi : Ashtu, më dëgjo me, po nuk diskutohet, po më dëgjo.

Eleni : Po.

Petraqi : Qe ti dhe Ylli nesër, që ta bëjm të ..., do vish tek Noteri edhe do hedhim firmën që un Petraq Dashit i kam marr kaq, sa na bie me tresh, euro borxh, po të njëjtën gjë do bëj edhe Ylli.

Eleni : E bëjmë mo Petraq, e bëj un, e bëj un.

Petraqi : Ashtu, që të thuash se si e qysh dhe tani un këtë muabet e kam me ty, po ti nuk do ta marrësh Yllin, se un Yllit dua ti bëj muabetin që të bëj te Noteri, të bëj të njëjtën gjë. Më kupton ?

Eleni : Jo, jo, nuk i them asnjë gjë Yllit un..

Petraqi : Ashtu, tani Ylli në qoftë se do kërkoj akt dhurimi që të marri ato mbrapsh, pa më dhën lekët, edhe pa më dhën atë, ato lek, ç'a do më japi ose lekët se nuk po kërkoj atë që m'takon dua, nuk ka akt dhurimi dhe un do dua që t'ja them në sy këtë, këtë Yllit dhe ta kem na afër edhe t'kem dhe ty si dëshimtare.

Eleni : Akt ? Për ç'ar akt dhurimi për Yllin ?

Petraqi : Po do vi momenti që do t'kalohet në emrin e Yllit ajo pjes, a kupton, moj do merret ajo, si, si pron ?

Eleni : Ajo e madhja, po.

Petraqi : Po, nga a madhja, do thot ai un dua 15-shen time ?

Eleni : E Yllit po.

Petraqi : Po edhe un do ti them, nëm lekët të marrësh pjesën.

Eleni : Lekët e këtyre që do prishim tani ?

Petraqi : Lekët e këtyre, po, po.

Eleni : E, lekët e këtyre, po ato, po do ti..

Petraqi : E kupton? E bravo.

Eleni : Po.

Petraqi : Pra ti i do po, nëm lekët e të të kthej hajt të bëjm aktin që dhe ti merre pjesën tende.

Eleni : Po.

Petraqi : Kurse me ty, me ty nuk e bëj këtë gjë. Më kupton ?

Eleni : E di o, e di o Petraq, e di.

Petraqi : E që ta dish pse do vish nesër.

Eleni : Dëgjo tani.

Petraqi : He ?

Eleni : Tani është shpejto nuk dua të llafosem nga kto gjëra po, në fakt Ylli në mes është një, është ai i pari, pastaj vijnë neve, po ta zesh nga një an të punëve.

Petraqi : Për çfar ?

Eleni : Ca do ti japim, ca do ti japim Yllit përshembëll nesër, pasnesër un dhe ti, se në këtë mes ta dish un dhe ti jemi, ta dish kshu më mir t'mos ket fare se sa është. Kur më tha dhe ato fjal që më ka thënë mua i tha dhe pardje, më është prishur kaq zemra ku di un..

Petraqi : Po pse ca fjalësh ka thënë Mihali ?

Eleni : Ka thënë c'doni që të veni, babai im vdiq si mbret, un do vdes mbret, juve doni të mirrni për fëmijët, doni për ... do për vajzat, ti do për Janin e për Enaden. Po ti dhe un tani pse kujdesohemi për fëmijët kujdesohemi. Ç'ka pësuar ai, i ka vrarë trurin perendia, ku di un se ç'ka ai burri, ... ku di unë, i mungon një, ku di un si llogjikon ashtu, të mos iki un dhe ti tani për ca përpiqemi, për fëmijët përpiqemi.

Petraqi : Po për fëmijët, po për ç'ne, jo moj s'ma merr mendja të jet shprehur kshu Mihali, mbase ka qen nuk e di se si ësh kjo pun.

Eleni : Ku di unë, unë kam ç'kam, nuk jap, nuk i mirrni dot kot ashtu, e di sa më është, më ka prekur, nuk di fare të llafoset, të thot një fjalë, të thotë përpiquni sa keni mundësi, po i morrëm, po ku di un, është bër fare është bër ai, nuk di të llafoset, nuk di të, ku di un ç'të të them, ç'të të them.

Petraqi : Po jo moj ca jan kto muabete.

Eleni : Ashtu ka thënë, përpiqet Adela përshembëll, ç'do Adela i tha për vajzat e tij i do, për Enadën i tha, do vdesi, siç vdiq babai im mbret ashtu do vdes dhe unë, ku e di ti si do vdes dhe mamaja ime mbretëresh vdiq i tha po, un dhe Adela i tha, e di si do vdesim i tha, ne dhe fëmijët, e di ku do vemi në këtë situatë i tha, ç'ne ku di un se ç'është ai, flet tër anapota, tër anapota flet ai, e mir, e themi nesër e themi nesër.

Petraqi : Dëgjo moj, dëgjo se un tani para dava gjysëm ore fola me Mihalin për letrën e asaj që ka bër me Yllin.

Eleni : Ee.

Petraqi : Edhe folëm normal, tani un nuk e di, nuk e di ç'a jan kto muabete, un se besoj dot që t'ket folur në këtë mënyrë Mihali.

Eleni : Ja mo, ja kshtu thoshte, ç'doni që përpiqeni, nuk i mirrni, kot ashtu, i doni për fëmijët, ee, si vdiq babai im mbret do vdes dhe unë, pse të, nuk kam, s'kam, nuk jap. Nuk e kam fjalën te lekët, e kam fjalën tek shprehja që flet. Jo, jo për Yllin mir bëre që, që bëre këte, atje do shkruhem dhe unë sikur, edhe un do shkruhem atje brenda.

Petraqi : Po mir, mo mir, shiko Petraqin, dëgjo mua tani...

Eleni : Ee.

Petraqi : Dëgjo mua tani, se është gjë e madhe, që të dish dhe ti që t'jemi t'sinqertë përpara vetes, përpara njëri - tjetrit dhe përpara zotit, se kemi fëmij mbrapa.

Eleni : Ashtu, ashtu.

Petraqi : Dhe nuk duam ta fusim shpirtin në gjynah, atë që do ti bëjmë, i bëjmë me të drejtë. Në rregull ?

Eleni : Me të drejtë, me të drejtë.

Petraqi : A rrofsh, pa i futur askujt në pjes, por të dish që, Petraqi me tyja nuk ka ç'a të bëj, të thot nëm kto, që t'jap këtë, apo sepse kur të vij momenti që do shiten, do nxirret lek, do themi, Lenica e lekët jan kaq euro që mi ke borxh po, më jep rregullohem, do rregullohem me njëri -

tjetrin bashk dhe ti t'ja u thuash motrave ta din.

Eleni : *E di, e di.*

Petraqi : Ashtu de, kurse në marrdhënie me Yllin un e dua këtë gjë, që në qoft se Ylli më thot un nuk kam lek, nuk kam lek, at'herë nuk ke lek, nuk t'jap tokën dot.

Eleni : *Dëgjo..*

Petraqi : Më kthe lekët të marrësh pjesën. Më kupton ? Pra të kem dhe un një letër në dor që i kam dhën ktij njeriu kaq lek. Më kupton Petraqin ?

Eleni : Dëgjo ti, nesër do thuash do ndahen të tre, do marrim kaq lek me që e gjeta un njeriun, do marrim kaq lek, do ndahen në tresh. O, të them dhe këtë tani, më tha Ylli dhe rradhën e par që e mora n'telefon edhe pardje që ike ti ndenji një çik pas, më tha mua kam prishur 8.000 evro tani që kur hodhëm ato në Tiran tha, e këteja i kam të shkruara një nga një, një nga një tha, tani as i kërkova se ishte momenti që nuk ësh...

Petraqi : *Për ça ka prishur 8.000 evro ai ?*

Eleni : Nuk e di un tani ta them ti, më tha ashtu, nuk i kërkova llogari, as i thash gjë, se thash nuk është momenti që ti them tani unë ç'ke prishur, është momenti tani për të gjetur lek, un vras mendjen për të gjetur lek, nuk vras mendjen se ç'kemi bër, ç'kemi prishur.

Petraqi : *Po qysh paska prish, ja fut kot ai, po lëre. 9.000 më tha mua euro kam hyr borxh, që nga koha e asaj, tani nëjse flet si të doj ai, po muabete kot ato, tani dëgjo mua.*

Eleni : E mir, un tani të kuptova, nesër do thuash, nesër ti do marrësh lekët nga filani, do vim të shkruajm atje që ato lekët do kthehen nga ti, nga mua dhe

Petraqi : *Jo, moj jo, jo nga ti, nga mua, dëgjo se nuk marr un njerz të huaj, dëgjo.*

Eleni : *Po, mir mo, e kuptoj un po..*

Petraqi : *Ashu de, po kjo do bëhet nesër, në rregull, që un ktu, ktu, kam, por un më tepër e kam me Yllin, se sa me ju. Më kupton ?*

Eleni : *E di un, e di.*

Petraqi : *A rrofsh, ne bashk nuk kemi ndonjë më jep të jap se jemi një.*

Eleni : *Të kuptoj, të kuptoj.*

Petraqi : Kurse Ylli në rast se thot dua që të shkruhet në emrin tim pjesa ime, i them po do ti të shkruhet në emrin tënd po, më kthe lekët edhe merr atë që të takon, të marr un këtë që më takon, që të kam dhën vërtet, më kupton Petraqin, ta kem një letër që ti them urdho vlla i dashur më ke kaq mi kthe.

Eleni : ... që do vij dita që këto lekët do ti kthehen filanit që do ti marrim, ku do ti gjej un dhe ai..

Petraqi : *Po mir moj, mir ajo, mund t'jet n'emër t'filanit, mund t'jet n'emrin tim, s'ka problem.*

Eleni : *Nuk më kuptove, të themi ashtu pavarsisht se do ti japim, ti apo mu, apo tjetrit. Ato lekët do kthehen.*

Petraqi : *O po do kthehen po, moj i marr Petraq Dashit, moj mua, un Lenica filan fisteku, un Ylli filan fisteku, i kam marr Petraq Dashit kto, kaq borxh. Më kupton ?*

Eleni : O Petraq, bëni muabet dhe për këtë, e morëm këtë, po kur të vij hera tjetër që do andeja mos japim dhe atje o Petraq ?

Petraqi : *Për kto lek, e për gjëra, për kto ?*

Eleni : *Ee.*

Petraqi : *Jo moj jo, i thash un ati, un lek s'jap më, i thash, un s'gjej më sepse lekët...*

Eleni : Të dëgjova unë, të dëgjova un, që i the,i kam thën dhe un më përpara, tani si thash kto dit se kto dit vrasim mendjen për tjetër gjë, i thash po të na kërkojnë atje shum ç'do bëjmë ?

Petraqi : At'herë atje do ta zgjidhi vet, sepse vet e ka marr përsipër, un mora përsipër ktej, prandaj po ..

Eleni : *E mir, e mir, ai thot, jo, jo, jo, jo, pastaja nuk e di se ç'do bëjmë, mir.*

Petraqi : *Jo, jo, ai mund të thoj jo e jo, se ai është edhe nuk i besoj shumë un, jo e jot e tija po, le të bëj ç'të doj, po të mbledhim mendjen ne ktej Lenica, se kjo është gjëja më e madhe, në rregull, pastaj kto të tjerat ...*

Eleni : *Ja të të them dhe një gjë, të them një gjë në qoftë se nuk ta them dot nesër. Në qoftë se mirren, Yllit ç'do ti japim ?*

Petraqi : *Jo në qoft se mirren moj, ato do mirren, qysh n'qoft se mirren.*

Eleni : *Mir mo, do mirren, do ti marrim. Ç'do ti japim Yllit ?*

Petraqi : *Po si ç'do ti? Kush do ti ? Ka 15-shen Ylli moj.*

Eleni : *O Petraq.*

Petraqi : *He ?*

Eleni : *Dëgjo ta them për shpirt të asaj nënës që na ka ikur, dëgjo tani, ato 15 i kan ata, që i kanë, ai s'ka asnjë gjë.*

Petraqi : *Moj, me gjith mend e ke ti? Se ka ata të tyret, po ai muabetin me ata e ka bërë, se ka bër ai, pasi bëri muabetin me ta, të erdhi të takoj tyja dhe Mihalini.*

Eleni : *Dëgjo, dëgjo.*

Petraqi : *Muabetin dhe pjesën e ka me ata ai, se ka me ne pjesën.*

Eleni : *Dëgjo tani, un tani dua atë të drejtën tamam, ato i kan, ata i kemi bër un, i kemi bër atë që 15 hektar do ti marrin ata, ata, ai s'ka asnjë gjë në mes, edhe i tha*

Petraqi : *Më fal, më fal një minut, një minut.*

Eleni : *Ata që jan atje në Tiran, nuk e di.*

Petraqi : *Po, jo aty, 15 hektar ata i shkruan n'emër të Yllit, se ata nuk i njofe ti si fytyra.*

Eleni : *Po, po.*

Petraqi : *E, po, e po*

Eleni : *Po, në emër të Yllit, po nuk jan të atija, dëgjo tani, ç'do ti themi.*

Petraqi : *Dëgjo mua, dëgjo o ti Lenica, ata të dy në Tiranë, e par e punës është ai muabeti që kemi bër bashkë që ata nuk e di egzistojnë apo s'egzistojnë, e para, e para, dëgjo mua e para.*

Eleni : *Për Yllin, atë më ka vajtur në mendje, vetëm ajo më ka vajtur.*

Petraqi : *Ashu e para dhe e dyta, e di ç'ma tha atje prapa banakut ai, kur po merreshe me atë ti që erdhi për sandalle ?*

Eleni : *Po, po.*

Petraqi : *Un atyre nuk u jap gjë, më tha mua.*

Eleni : *Si, si ?*

Petraqi : *Un atyre tha, po t'ma bëjn kshu tha, nuk u jap gjë fare tha, e s'ma bën syri terr, m'tha mua.*

Eleni : *O, e mir.*

Petraqi : *E pra, e more vesh tani ti ?*

Eleni : *E kuptoj.*

Petraqi : *E, dhe Ylli më thot mua ishin ktu ata në Sarandë, ngelën ktu, ata nuk jan ata, nuk e din me një fjal, un 99% them që ata nuk egzistojn.*

Eleni : *Makar t'mos egzistojn, un gëzohem të mos egzistojn, më mir të mos egzistojn.*

Petraqi : *Tani me fal, me fal një minut, më dëgjo me kujdes, mos bëj gaf ti, ça ti japim Yllit, ne Yllit i kemi dhën 15 hektar në emër t'Yllit dhe nga ky 15, Ylli t'vrasi veten me ata atje, me emrin se është në emër të Yllit ajo dhe Ylli ka emrin e tija nëpër 15 dhe duke pasur emrin për kto 15 le ta*

bëj pazarin me ta. Me ne s'ka bër pazar Ylli.

Eleni : *O Petraqi, dëgjo tani, do ta them prap, ato vërtet jan të atireve, pavarisht se kujt jan, un nuk e di se kujt janë, po un ta kam vet mos është ndonjë gjë e till, po tamam, tamam, si bisedojmë që në ditën e parë që biseduam ato 15 jan të atire, se ato ishin 30 -të ngaqë gjetëm këtë këtu që shkruante 40-të.*

Petraqi : *Ej, ej, se jemi n'telefon, e di Petraqi, tani po them këtë përfundimisht, Ylli pretendon 15, jo pretendon po është bër muabeti për 15 dhe 15 do marri, në rregull.*

Eleni : *Dëgjom dhe njëher, është bërë 15 edhe i tha mamaja për Yllin jan të tjera edhe i ka thën dhe këtë mamaja ja un nuk të gënjej, për Mihalin i tha jo që dhe ai do të të japi, se at'here Mihali bënte naze, s'donte që të bënte fare për Yllin, që të pleksej Ylli në mes.*

Petraqi : *Po, po, e di, e di.*

Eleni : *Edhe i tha mamaja jo dhe Mihali do të të jap i tha, nuk e bën atë tha, po edhe sikur mos të të japi, do të të jap un i tha nga pjesa ime, i tha, ja ta them ashtu, nuk të gënjej un, tani nuk se këtu është pjesa ime edhe tënde bashk, nuk është pjesa tënde, të gënjej un, të, të ...*

Petraqi : *Mir, mir, të kuptoj Petraqi, tani më dëgjo me kujdes, ti nuk ke pse ta vrasësh mendjen për këtë gjë, sepse un ta thash përgjigjen e parë 99% Ylli i ka vet ato atje, e para, e dyta, ne nuk i kemi premtuar gjë dhe un në muabet e siper i kam then...*

Eleni : *I kemi premtuar, i kemi premtuar...*

Petraqi : *Mir, në qoft se i keni premtuar ju, është tjetër gjë.*

Eleni : *I kemi premtuar, i kemi premtuar.*

Petraqi : *E bëjm bashk këtë muabet, kur t'jet koha e*

Eleni : *E mir, e mir.*

Petraqi : *Lëm një dit tjetër, qysh e tek edhe ashu, por dëgjo mua*

Eleni : *O, ta bëjm kur të vij koha pastaj.*

Petraqi : *Dëgjo ktu ti dhe un do ta bëjm veshin shurdh, sepse Ylli nuk ka pjestar.*

Eleni : *...ai s'ka fare tani në këtë mes, ai pret nga neve ç'do ti japim neve me të thënat, te ..*

Petraqi : *Ja dhe njëher kjo, moj Lenica, mos të ngatrrrohem me këmbët tona e motër, un po t'them kaq, Ylli, Ylli nuk pretendon pjes nga ne, un nuk kam bër muabet tha me ju, tha ç'të më jepni, më tha mua.*

Eleni : *Ee, ç'do ti japim neve, e .*

Petraqi : *Kshtu, un nuk kam bër muabet tha.*

Eleni : *Jo, nuk ke bër ..*

Petraqi : *Dhe un i thash dhe përgjigja ime ishte kjo: Ylli ti ke letrën në xhep me emrin tënd për 15 i thash, prandaj në qoft se ke bër pazare nuk i ke bër me ne, në rregull, se un se dija këtë muabetin e ndjes pastë Jorgjia, un po them, jo tha nuk kam bër muabete pazare, mua ç'të më jepni tha, po më dhat.*

Eleni : *E, po më dhat, e*

Petraqi : *E bravo, bravo, pra mos e zgjasim këtë muabet, se Ylli është andej në krahun tjetër dhe pazaret i ka me ta. Më kupton Petraqin ?*

Eleni : *Nuk ka Ylli, me fjalët që kemi thënë mir do ta llafosemi prap, po do ta them dhe njëher....*

Petraqi : *Dëgjo mua, dëgjo, mos e vrit mendjen ti se do të të them un se si e qysh e ashu..*

Eleni : *Do të të them edhe këtë un, do ti themi ata me që nuk ndihmuan në këto pjesë të tëra*

Petraqi : *Po lëre, se e di un.*

Eleni : *Do ti mbash atireve ti, mba sa të duash atireve ti, do ti themi.*

Petraqi : *Po moj moter, po, mbaj sa të duash.*

Eleni : *Atireve ti mbaj sa të doj.*

Petraqi : *E di una në ktë muabet do jesh ti dhe un, pasi të mbarojmë ato nesër edhe do bëjm ktë, jo do bëjm muabetin e ksaj, po asaj, se më premtoj tha mua, ata tha nuk japin më shum se 1 hektar e kupton, at'here un do ti them atë 1 hektarshin që dhan ata merre ti ashu de, në rregull edhe ky muabet merr fund.*

Eleni : *Dakort, tani në ç'or nesër do jemi atje ?*

Petraqi : *Tani un dua që ju nesër të jeni sikur nga ora 10:00 -10:30 ktu.*

Eleni : *Tani Yllin un nuk e marr në telefon, nisem vet.*

Petraqi : *Jo, jo, mos e merr, do ta marr un Yllin, ishte për peshk e se dëgjonim, jam me njerëz të tjer më tha mua dhe s'flas dot.*

Eleni : *Jo, jo, në qoft se më merr gjë mua do më thot që do ..*

Petraqi : *Jo, po të mori që do vi më tha Petraqi për nesër, vemi thoj, vemi, vetëm të zgjidhet puna i thoj dhe vemi.*

Eleni : *Ee, të t'them që të dish un tani edhe themi vemi, mos më thot që do kaloj un do të marrë, po patjetër do ti them, do më thot them un.*

Petraqi : *Po, patjeter, patjeter.*

Eleni : *Mir bëm që biseduam që të dim ç'të themi, që të di dhe un të llafos, mir pastaja Petraq.*

Petraqi : *Mir Lenica, kshu do ta bëjm.*

Eleni : *Shum, faleminderit, shum, shumë.*

Petraqi: *Hajt, mirupafshim.*

189. U provua gjate gjykimit me procesverbalin “Për kryerjen e përgjimeve në vende publike” (faqes 178-181 të volumit 2 të dosjes gjyqësore), si dhe me deklaratimet e dëshmitarëve se ne daten 11 Korrik 2016, e pandehura Eleni Lino ka shkuar ne qytetin e Fierit sebashku me te pandehurin Ilia Çabiri, me automjetin Mercedes Benz me targë SR 6653 B, dhe kane mberritur aty ne oren 9 e 40 a.m. Aty jane takuar me të pandehurin Petraq Dashi dhe të tre së bashku kane shkuar tek noterja Etleva Stamo për të bërë deklaratat noteriale që secili prej tyre pranonte që i kishte nga 17 mijë euro borxh të pandehurit Petraq Dashi.

190. Siç rezultoi edhe nga deklaratimet e noteres Etleva Stamo, te bera para Kolegjit Penal te Gjykates se Larte ne seancen gjyqësore te dates 20.02.2017, i pandehuri Petraq Dashi eshte paraqitur me te pandehuren Eleni Lino ne zyren e saj, ku kane kerkuar te kryenin nje kontrate huaje. Noterja deklaroi se ka kerkuar prej te pandehurve qe te kryenin transaksionin me banke dhe pastaj ajo te perpilonte aktin noterial. Ne kushtet qe kjo notere u ka thene qe veprimet ti kryenin me banke (pasi shumat kane qene te konsiderueshme) dhe pasi asaj ti sillnin vertetimin bankar te kryenin aktin noterial, dy te pandehurit jane larguar dhe nuk jane paraqitur me.

191. Te gjitha veprimet e te pandehurve ate dite jane te fiksuara ne procesverbalet e vëzhgimit në vende publike të kryera nga policia gjyqësore qe i perkasin dates 11 korrik 2016, te pranuar me cilesine e proves ne kete gjykim, nga ku ku rezultojne te fotografuara te gjitha veprimet e te pandehurve. Vertetohet qe ata jane takuar ne Fier, kane shkuar ne zyren noteriale te noteres Etleva Stamo dhe pasi kanë dalë nga kjo zyrë, te tre jane ulur ne kafene. Me pas te tre kane shkuar ne banesen e Petraq Dashit dhe me vone kane dale, ku Ilia dhe Eleni jane nisur drejt Tepelenes, ndersa Petraq Dashi eshte kthyer ne shtepine e tij, nga ku ka vazhduar me vone veprimet e tjera per marrjen e te hollave.

192. Vazhdimi i bisedave ne ditet ne vijim, midis te pandehures Eleni Lino dhe dy te pandehurve te tjere, hedh poshte te gjitha pretendimet e mbrojtjes se ajo nuk kishte dijeni per shperblimin, nuk kishte marre pjese ne diskutimet qe beheshin mes te pandehurve te tjere per te siguruar shperblimin, si dhe faktin qe nuk po bashkepunonte me ta per arritjen e qellimit. Pervec transkripteve te bisedave qe u permenden me lart, si dhe veprimeve konkrete te Elenit per tu takuar me dy te pandehurit e tjere dhe per te zgjidhur çeshtjen e shperblemit, vertetohet me procesverbalin “Për përgjimin e telekomunikimeve” te dates 12 Korrik 2016 (referojuni faqes 92 te dosjes gjyqesore, volumi 2), se ne daten 12 Korrik 2016, në orën 17 e 36 p.m., kjo e pandehur ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi duke e pyetur pikerisht nese kishte” vajtur sot tutje “e (nga konfirmohet fakti se ajo e dinte qe i pandehuri Petraq Dashi do te shkonte te takonte personin dhe do conte pagesen prej 50 mijë Euro) dhe ky i fundit, ja konfirmon qe i çoi dhe qe ishin ne pritje.

Eleni : *E mir, vajte sot tutje ?*

Petraqi : *Po, po, i çova, edhe të shikojm, po të shikojm, na nesër, ose pasnesër mos e marrim në dorë, më tha ktë jav ishalla.*

Eleni : *O, fjal të mira ...*

Petraqi : *Kur ta marr do të them un, se më tha do ta jap në dor më tha mua, kupton ? Po do të marr un n'telefon gjer at'here, që mos të mundohesh.*

193. Po kështu, vërtetohet me procesverbalin “Për përgjimin e telekomunikimeve” te datës 15 Korrik 2016 (referojuni faqes 92 te dosjes gjyqesore, volumi 2), se ne datën 15 Korrik 2016, në orën 20 e 36 p.m., e pandehura Eleni Lino ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre konfirmohet fakti se e pandehura Eleni është e shqetësuar se si kane shkuar punët, ndërkohë qe i pandehuri Petraq Dashi i thotë qe gjerat janë pozitive, por nuk duhet te flasin me ne telefon.

Eleni : *C'bëni mirë ? Nuk më zihet mua, prit, prit, thash un do ta marr..*

Petraqi : *Jo, jo, dëgjo, mos, mos marrim asnjë dhe do t'jap një këshill, mos fol fare n'telefon me askend, kur të vi vet un dhe do takoj vet mirë ?*

Eleni : *E mir.*

Petraqi : *Gjërat jan pozitive kaq.*

194. Te gjitha bisedat e analizuara me larte, si dhe veprimet konkrete te kryera nga kjo e pandehur, ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë (veprime te cilat koordinohen dhe janë ne përputhshmëri me njëra tjetrën), konfirmojnë qarte faktin se ajo është ne dijeni te plote te shumës qe duhet te jepet si shpërblim, është dakord qe kjo shume te jepet qofte dhe duke u siguruar nga te tretet dhe pastaj te rregulloheshin me vone, duke u kompensuar ne natyre (sipërfaqe toke). Edhe pse vete është ne pamundësi pagese, e pandehura Eleni Lino është dakord qe te kontribuojte ne këtë shpërblim me sip toke (ajo dhe motrat e saj), dhe per këtë ishte dakord te nënshkruante edhe aktin noterial, ku te deklaronte se i kishte një borxh te pandehurit Petraq ne shumën 17.000 euro. Pra, konfirmohet plotësisht ezaurimi i anës objektive dhe anës subjektive te subjektit te veprës penale, veprimet konkretet qe ajo ka kryer per ta realizuar atë, dashja direkte e saj per tu premtuar dhe dhëne shuma 50 mijë euro, ne këmbim te një vendimi ne favor te saj dhe bashkëpronareve te tjerë, si dhe dëshira per te kontribuar. E pandehura Eleni Lino është subjekt i veprës penale dhe rezulton person i përgjegjshëm para ligjit.

195. Mbrojtja e te pandehurës Eleni Lino thirri ne këtë gjykim si dëshmitar edhe te birin e te pandehurës , shtetasin Xhorxhi Lino nëpërmjet te cilit nuk arriti te provonte asgjë, dhe as nuk mundi te hidhte poshtë provat e akuzës. Ky dëshmitar në seancën gjyqesore te datës 27.02.2017 deklaroi se: *“Kam folur me mamane time per gjyqet, per gjera te vogla. Ne kemi lënë që Ilia Çabiri do te na ndjek çështjet, pasi kete perfaqesues e ka caktuar gjyshja. Kam bashkebiseduar me*

mamanë, kam diskutuar edhe për shpenzimet e kryera, por persa i perket gjykimit në Gjykatën e Lartë, nuk di gjë”.

196. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përfundim të analizës së mësipërme vlerëson se e pandehura Eleni Lino e ka konsumuar veprën penale për të cilën ajo akuzohet por në dhënien e masës së dënimit për këtë të pandehur, duhet të aplikohet dhe nenin 59 i Kodit Penal, në të cilin thuhet shprehimisht se: *“Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit”.*

197. Ky Kolegj, vlerëson aplikimin e kësaj dispozite për arsye se çmon se jemi para rrethanave të posaçme të parashikuara nga kjo e fundit. Ky Kolegj, vlerëson aplikimin sa me sipër për shkak se e pandehura paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore. Ajo nuk ka qene e dënuar me parë, është mbi 60 vjeç dhe nga diagnoza e përcaktuar në raportin mjekësor nr. 38/02 të Komisionit Shëndetësor të Shkallës së Parë, Njësia Vendore e Shëndetësisë Ermoupoli, ka rezultuar se subjekti Eleni Lino është e paaftë në masën 25% nga diagnoza “Neurologjike”, fakt ky që detyroi dhe Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë që me vendimin nr. 18/1, datë 18.07.2016 të të ndryshonte masën e sigurimit nga “arrest burg” në “arrest shtëpie”. Përveç sa me sipër, ky Kolegj vlerëson se duhet të aplikohen kushtet e posaçme të kësaj dispozite dhe për shkak të gjendjes familjare që ka kjo e pandehur, ku ajo përveç faktit që është vete e sëmure, i duhet të kujdeset dhe për bashkëshortin e saj që është mbi 70 vjeç. Ky Kolegj, vlerëson se në këtë rast dhënia e një dënimi me kusht pezullues, e ka arritur qëllimin për të cilin jepet dënimi.

198. Në lidhje me të pandehurin **Petra Dashi**, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se edhe ky i pandehur, ka konsumuar veprën penale të “Korrupsioni aktiv i gjyqtareve, prokurorit dhe funksionareve të tjerë të drejtësisë” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të K.Penal.

199. Rezulton nga të gjithë provat të cilat u morën në shqyrtim në këtë proces gjyqësor, si dhe nga deklaratimet e vete të pandehurit të dhëna në seancën e datës 27.02.2017, se ai ka qene një nga personat e interesuar për përfitimin e pronës prej 40 Ha të ndodhur në Ksamil Sarandë. Kjo për arsye se, bashkëshortja e tij ishte njëra nga trashëgimtarët e trashëgimlënesit Spiro Mihal Gjoka, ky i fundit në cilësinë e ish pronarit. Siç rezulton dhe nga të gjitha procesverbalet e përgjimeve të telekomunikimeve të trajtuara me lart në këtë vendim, si dhe nga veprimet konkludente të pandehurit, ka qene pikërisht ai i cili ka marrë persiper të kryejë të gjitha veprimet për të siguruar një vendim pozitiv (dashja, dhe pasoja e ardhur) në favor të pronareve në Gjykatën e Lartë, për çështjen civile me objekt vërtetimin e faktit juridik “Përcaktimin e kufijve për sipërfaqen 40 ha e ndodhur në Ksamil”. Këtë ndërhyrje, ai do ta siguronte nëpërmjet atyre që ai i quante “njerëzit e tij”. Nga pyetja që ju bë të pandehurit në seancën e datës 27.02.2017 se çfarë lidhje kishte me të pandehurit e tjerë, ai ka deklaruar se të pandehurën Majlinda Andrea e kishte kushëriri, të pandehurin Odhise Andrea burrin e kushëririt dhe të pandehurën Eleni Lino, kushërirën e parë të gruas.

200. Po cilat janë provat konkrete, te cilat vërtetojnë se i pandehuri Petraq Dashi ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën ai akuzohet? Marre në mënyrë kronologjike, faktet siç u trajtua dhe më lart në këtë vendim dhe të pranuarat dhe nga vete i pandehuri në deklaratimet e tij të datës 27.02.2017, janë si më poshtë.

201. Në muajin Qershor 2016, i pandehuri Petraq Dashi deklaroi se, sëbashku me të pandehurin Ilia Çabiri kanë qene pranë Gjykatës së Lartë për të marrë ndonjë informacion në lidhje me ecurinë e çështjes civile, që kishte lidhje me vërtetimin e faktit juridik të përcaktimit të kufijve të pronës me sipërfaqe 40 ha, të ndodhur në Ksamil, Sarandë. Interesi për këtë çështje, ka vazhduar në ditët në vijim, ku siç vërtetohet dhe me procesverbalin e përgjimeve të telekomunikimeve të datës 4 Qershor 2016 (faqja 101 e dosjes gjyqësore, vol. 2), në orën 11 e 39 a.m i pandehuri Petraq Dashi ka marrë në telefon të pandehurin Ilia Çabiri.

202. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre vërtetohen faktet e mëposhtme:

(i) të dy janë të shqetësuar për faktin se si do të zgjidhet kjo punë. Kështu, i pandehuri Petraq Dashi thotë se: *“unë e di për çfarë më more, po vallai kam filluar që kshu me atë nuk dua të dal llaft... e kupton, që të më thote orë në e lamë se unë do të marr vete, me kupton pse. Po mua sikur më kanë hyrë ethe, nuk e di më del gjumi natën për atë muhabet, po matem ti vete tek shtëpia, ta marr në telefon, po meqë e lam”*;

(ii) Rezulton se i pandehuri Petraq Dashi, kishte bere dhe biseda të meparshme në lidhje me këto çështje dhe se muhabeti kishte shkuar mirë dhe puna kishte mbetur, pasi duhej të bëhej një premtim ajo që ata quanin në zhargon “graso”. Sa më sipër, del nga konteksti i bisedës: *“Jo, po muhabeti vajti mirë fare, me një fjalë nga muhabeti i fundit që u ulëm në, u bë e qartë që ky muhabet do grason, në rregull graso graso, e kupton?”*;

(iii) nderkohe po nga biseda në vazhdim, del qarte fakti që ata janë të gatshëm të japin shpërblim për të përfituar vendimin. I pandehuri është gati të japë shpërblimin, mjafton që ajo të mos jete një gjë e rende;

(iv) nga fjalet që ai thote, del qarte se ai ka dijeni dhe informacion për ecurinë e dosjes, që gjërat janë në *“proces dhe që duhet të nxitojnë që të fusin njëherë në xhep këte vendim”*.

203. Siç vërtetohet me procesverbalin “Për transkriptimin e bisedave telefonike” e datës 06.07.2016 (referojuni faqes 125 të dosjes gjyqësore, vol 2), në datën 24 Qershor 2016, në orën 9: e 35 minuta a.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marrë në telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre vërtetohen faktet si më poshtë:

(i) se i pandehuri Petraq Dashi është në pritje të një përgjigje në lidhje me çështjen civile që është në Gjykatën e Lartë, nga personi me të cilin kishte biseduar (pra ai vazhdon të merret aktivisht me këtë çështje)

Petraqi: *Hiç asgjë fare, as nuk më ka marrë as ashu... nuk e di si e qysh e tek do vijë. Nuk po e marr vesh fare, më tha më prit, më prit, po të marr vetë në telefon e kaq;*

(ii) se ai merret me njerezit e tij aty për këte çështje (tregon lidhjen që ka me personat të cilët po merren me këte çështje).

Ilia : *Mos është e nevojshme të vete unë një herë lart vetë...?*

Petraqi : *Po jo orë vlla se e bezdis, unë merrem me njerezit e mi atje, thashë një mendje me gocën e xhaxhait, ti veja të shpija, por më duket si. Nqs të ka thën kshu tha është kot tha...”;*

(iii) vërtetohet fakti që pritet që kjo punë të mbyllet në korrik të 2016.

Ilia : *Erdhi finalja, në korrik ishalla e mbylлим...*

Petraqi : *Ai muhabet do vete mirë e të gjitha...*

204. Vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07.06.2016 (referojuni faqes 126 te dosjes gjyqësore, vol 2),se ne datën 6 Korrik 2016, në orën 8 e 49 minuta a.m., i pandehuri Ilia Çabiri ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre konfirmohet fakti se:

(i)I pandehuri Petraq Dashi vazhdon te merret ne mënyre aktive me këtë çështje, “*i ka dërguar fjalë atij mikut me të atin*”, duke treguar dhe lidhjet qe ka me personin qe do ta ndihmoje ne zgjidhjen e kësaj çështje.

Petraqi : *Ati mikut i çova fjalë me të jatin me një fjalë.*

Ilia : *Po ?*

(ii) po kështu konfirmohet fakti qe ai vazhdonte te kishte informacion per ecurinë e dosjes, pasi thotë se ende s’qe bere asgjë ne lidhje me shqyrtimin e çështjes.

Petraqi : *Edhe tha është akoma në ashu, tha po e shikojmë, tha mos ki merak. Kjo ishte përgjigja.*

Ilia : *Mos ki merak ? Kaq ?*

(iii) si dhe konfirmohet fakti qe ai i ka bere muhabetet me personat qe do te ndihmonin per këtë pune, pasi ai kishte folur qarte dhe shkoqur dhe se s’kishte arsye pse te vonoheshin.

Ilia : *Këto punë kanë gjykatat mo vlla, nuk ashu, po ta kishim mbaruar, ta kishim mbledh mendjen.*

Petraqi : *Nuk e di ç’a të t’them or ti, muhabetet jan bërë t’shkoqura, t’pjekura, t’sakta, nuk e di tani.*

205. Siç rezulton nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 7 Korrik 2016, në orën 12 e 58 minuta p.m., i pandehuri Ilia Çabiri ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës ndërmjet tyre konfirmohet se:

(i)I pandehuri Petraq Dashi ka marrë përgjigje sa është shuma që duhet të paguanin në Gjykatën e Lartë pasi i pandehuri Ilia e pyet “Sa është kostua mo Petraq?”

(ii)për këtë çështje nuk mund të flitej në telefon, por duhet të takoheshin atë ditë mbasdite në Gjirokastër për të biseduar në detaje (pra per koston).

Petraqi: Tashti po atë do takohemi, jan gjëra që s’bëhen n’telefon kto, me një fjal, o bëhet këtë javë që vjen, o s’bëhet, me një fjal, kshu që kostua është veri ato, po takohemi sot mbasdite n’Gjirokastër dhe kaq, mir, hajt.

206. Siç vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07.07.2016 (referojuni faqes 134-137), nga dy biseda te zhvilluara ne datën 7 Korrik 2016, vërtetohet fakti qe dy te pandehurit Petraq Dashi dhe Ilia Çabirit e lëne qe te takohen te nesërmen ne Gjirokastër, bashke me te pandehurën Eleni Lino, per te biseduar rreth pagesës dhe ky i fundit bie dakord.

207. Po ne datën 7 Korrik 2016, në orën 13:12 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marr në telefon edhe te pandehurën Eleni Lino me te cilën e len qe te takohen ne Gjirokastër dhe ndërkohë i thotë se ka lajme te mira (shikoni procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07.07.2016, fq 136-137 e dosjes gjyqësore, vol 2).

Eleni : *Alo..*

Eleni : *O, Petraq, ç’bëni ?*

Petraqi : Ee, për atë të mora sepse nesër i thash dhe Yllit, nga ora 11-11 e 30, do takohemi aty në Gjirokastër.

Eleni : *E mir, shum mir, ndonjë lajm të mirë ?*

Petraqi : I mir, i mir, po hajt.

Eleni : *E mir pastaj, nga ora 11 e 30, e?*

208. Provohet se tre te pandehurit bien dakord qe te takohen. Takimi do te zhvillohet ne Gjirokastër ku është edhe vendbanimi i Elenit dhe ata e dine qëllimin e takimit. Te tre te pandehurit Petraq, Ilia dhe Eleni do te takoheshin per te marre vesh “*koston*”, fakt ky qe del nga bisedat e bëra mes Petraqit dhe Ilias dhe këtij te fundit dhe Elenit, bisede te cilën nuk mund ta zhvillonin dot ne telefon por do ta diskutonin nga afër. Nga provat e analizuara me poshtë ne këtë vendim, vërtetohet se ne datën 8 Korrik 2016, ora 7 e 56 a.m., te tre te pandehurit janë takuar. Takimi është zhvilluar në dyqanin e te pandehurës Eleni Lino. Fakti që takimi është zhvilluar në dyqanin ku punonte e pandehura Eleni Lino, konfirmohet nga procesverbali i bisedave telefonike te datës 10 Korrik 2016 (referojuni faqes 89 te dosjes gjyqësore, vol. 2) e zhvilluar ndërmjet të pandehurve Eleni Lino dhe Petraq Dashi, ku ndërmjet te tjerash i pandehuri Petraq i thotë të pandehurës Eleni: “*ashtu e para dhe e dyta, e di ç’më tha atje prapa banakut ai, (e ka fjalën për të pandehurin Ilia) kur po merreshe me atë ti, që erdhi për sandalle ?*”

209. Po kështu fakti qe ky takim u realizua, del dhe nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 08.07.2016 (referojuni faqes 149 e dosjes gjyqësore, vol. 2), ku ne bisedën e zhvilluar ne këtë date, ne orën 14:11 p.m., mes te pandehurit Petraq Dashi dhe nje shtetasi me emrin Malo, Petraqi i shpjegon qëllimin pse ishte ne Gjirokastër, se nuk priste ndonjë gjë nga Eleni, ndërsa Ilias i kishte thënë qe te bisedonte me bashkëpronaret e tjerë per te siguruar shumën. Vete konteksti i bisedës, si dhe veprimet qe ai ka kryer me pare (te trajtuara ne dy paragrafët me lart te këtij vendimi), tregojnë se Petraqi ne këtë moment e di shumën qe i kane kërkuar dhe po mundohet qe te përdori kontributin e gjithë bashkëpronareve per te siguruar këtë shume. Nga konteksti i bisedës, del qe ai është dakord dhe te gjeje paratë, por qe bashkëpronaret e tjerë tja njohin kete kontribut, duke i dhene siperfaqe toke.

Petraqi : *Ja ktu, po kthehem tani.*

Malo : *He, ça bëre ?*

Petraqi : *Ee, ato muhabete që prisja, i thash Yllit, se Lenica thoshte s’kam, s’kam..... s’prisja un ndonjë gjë, tani për un, për të mos thënë që dakort, un jam shumë, shumë në siklet - i thash unë, se s’mund ti gjej për 3 – 4 ditë aq lek..*

Malo : *Ehe, ehe.*

Petraqi : *Kshu që, ça do bëjmë.*

Petraqi : *Ylli, ti, i thashë un, t’del për detyrë të dalësh atje, ti thuash atyre miqve, sikur sonte t’shkosh n’Tiranë, a ti marrësh n’telefon, ta ndash muhabetin, sa do kontriboni. Jo tha, un n’qoftëse nuk kontrobojnë me lek ata, tha do ti them sa zbrisni tha nga 15 –shja, më kupton ? që kan pjesë.*

Malo : *Po, po.*

Petraqi : *Edhe kjo është ashtu, i thash un. Dakort, më kupton ?*

Malo : *Po.*

Petraqi : *Po jo, po ti bëj njëher muhabet të hënën, se mos ai bie dakort, që ti bëj me kto, me kto. Mir se e bëj un muhabetin i thash un, edhe ktë, po po qe se s’ra dakort ai, qysh do ti bëjmë ? Ku do ti gjejmë ? Na ngeli pikpyetja ku do gjënden pastaj.*

Malo : *Ehe.*

Petraqi : *Që ta shtrydh Yllin sa t’kem mundësi.*

Malo : *Po.*

Petraqi : *Edhe pastaj ti jap në momentin e fundit, ti them okej..., i gjeta, më bëni kaq, më detyroheni kaq. Po do vi ti bëjmë muhabetet.*

210. Në datën 9 Korrik 2016, në orën 8 e 35 a.m., siç u provua nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 09.07.2016, (fq 154-156 te dosjes vol 2), i pandehuri Ilia

Çabiri ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Nga përmbajtja e bisedës së zhvilluar, konfirmohet qarte fakti se i pandehuri Ilia Çabiri, po bënte veprime konkrete për të siguruar shumën ai kishte mbledhur personat në cilësinë e bashkëpronareve që ai përfaqësonte dhe kishte biseduar për ta siguruar atë, por nuk po arrinte, pasi ata nuk mundeshin nga ana financiare.

Ilia : *Edhe i thash, dolën problemi këtu, këtu, këtu, i thashë. Dëgjo më tha mua, neve nuk është halli se kemi lek edhe si dhamë, jemi në këto pozicione të ngushta, tha, me një llaf..... un su pash as librezat, as ato gjërat. I thashë, dëgjo, i thash, kjo pun ka një kosto, i thash ju meqë jeni në pjacë, i thashë, e dini si funksionojnë gjykatat, si funksionojnë të gjitha gjërat. Un i thashë, deri tani kam qënë korrekt me juve, apo jo ? Po më thanë mua. Tani i thash si i bëhet sepse mua më ka ikur shum lek nga kjo punë e gjykatave i thash. Kur kemi bërë ca muhabetë i thash, i kemi bërë ndryshe thash, po më dilni ndryshe. Dhe bëra shumë debate me ta.*

211. Ndërkohe, nga ana tjetër Petraqi insiston dhe thotë se shpërblimi duhet të jepej dhe u duhej thënë troç bashkëpronareve që ne rast se nuk do të kontribuonin në të holla, kontributi do të zbritej nga sipërfaqja që ata do të merrnin (pra pjesa e kontributit do të mbahet në natyrë). Për këtë qëllim, duhet të punohej sa më shpejt dhe të kthehej një përgjigje. Ndërkohe, po nga kjo bisedë rezultoi se ai ishte në dijeni dhe të lëvizjeve të personave që do të ndihmonin për këtë çështje, duke thënë se s'kanë ikur në Itali, po nuk e di ku kanë vajtur.

Ilia : *Për këtë problem, më thanë mua, ne nuk kemi dhe nuk të ndihmojmë dot. Mir i thashë, do keni kosto nesër për tokën, i thash....*

Petraqi : *Ja the troç ti atë punën e atyre hektarëve vlla ?*

Ilia : *Po, po, po, po re.*

Petraqi : *Merr përgjigje nga ata se unë do nesër, po që se ata, se më than një llaf, sikur s'kan ikur në Itali, nuk e di ku kanë vajtur. Un do interesohem sonte, po ashtu nesër vete i takoj për të bërë ato muhabetet, po ma nda këtë njëher mua ti, që t'jem me këmbë në tok un.*

Ilia : *Ore, do të jap unë haber në darkë, të thash mo.*

Petraqi : *A, rrofsh.*

Ilia : *Ashtu, tani më kupton mua ti, muhabeti është ki, që kta supozojnë me këtë gjë që thuaj me një justifikim që nuk na latë kohë, përshëmbull, një javë kohë. Si ti mbledhim kaq lek ?*

Petraqi : *Ore, ja o Ylli, mir e ke ti t'keqen vëllai, dëgjo Petraqin, dëgjo mua një sekondë. Ja më thanë ata dakort, sa do ti ? Një javë ? Mir, merr një javë kohë. Po ç'a do bëj për një javë o Ylli ?, Po aman të keqen vëllai, po lem...*

Ilia : *Jo të marrësh një javë kohë mo, ta shtym der na shtatori, po prap dhe na shtatori neve.*

Petraqi : *Po, jo re, nuk ma mban bytha në shtator mua, ç'a thua ti. Po nuk bëhet fjalë ajo, e ç'a un ? Un që mbrëmë jam takuar me një 2 – 3 vet, po ti e di si janë ato. T'gjith mbledhin shpatllat e burr....*

Ilia : *E marr vesh mo pasha, e marr vesh.*

Petraqi : *Dëgjo mua, më sqaro muhabetin e atyre, me ato ti, më sqaro muhabetin e atyre njëher.*

Ilia : *E, në dark, e në dark.*

Petraqi : *Edhe mender, mos e çaj bythën fare, i thuaj o byrazer, sa kishe ti ? 15 ? I rruan bythën 15 – es ti i thuaj, kaq.*

Ilia : *Po e di, mo...*

Petraqi : *I rruan bythen 15 – es ti thoj, po mbaj 12 atje, a mbaj 11 atje, mbaj 13 maksimumi, se nën 2, jo njëher, harroje ti thuaj atija, edhe andej nga ke ardhur.*

212. Ndërkohë, siç u provua dhe gjate gjykimit, të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea kishin ikur një ditë më pare në Greqi ne datën 08.07.2016 dhe po kështu, një ditë më pare, kishin rezervuar bileta për të udhëtuar për në Itali me traget me datën 15 Korrik 2016.

213. U provua ne gjykim nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 10.07.2016 (fq 159-160 te dosjes vol 2), se ne datën 10 Korrik 2016, ora 7 e 30 a.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marre në telefon të pandehurin Ilia Çabiri. Nga përmbajtja e bisedës konfirmohet përsëri se i pandehuri Ilia Çabiri ishte duke punuar me veprime aktive per arritjen e qëllimit dhe sigurimin e shpërblimit. Ai kishte patur në shtëpinë e tij një natë më parë bashkëpronaret, por ata nuk kishin pranuar te kontribuonin ne te holla, pasi nuk kishin mundësi financiare dhe Ilia ua kishte bere te qarte se, do tu ulte sipërfaqe toke nga pjesa qe do te përfitonin ndërkohë qe Petraqi i thotë qe duhet te ndaje muhabetin me ata.

Ilia : *Mir është ? I kisha ktu mbrëm ata miqtë.*

Petraqi : *Ehe.*

Ilia : *Kam bërë lëre debate, vari lesht, nuk kan gjëndje, mu betuan, prandaj erdhën poshtë, se un i bëra alarmante gjërat, se janë alarmante. Thash ndodhem në këtë pozicion i thash, na vete puna dëm edhe juve kenë pjesën tuaj dhe ju veni dëm, i thash, se po s'mora unë, s'merrni dhe juve i thash. Nuk kemi o Yllo, më tha mua, prandaj erdhëm poshtë, tha që të na besosh. Un e dija këtë përgjigje i thash, edhe i thash do tu ul hektarë, i thashë, në metro. Ky ishte muhabeti me ta.....*

Ilia : *O pasha, as ata kanë gjë në dorë, as unë s'kam gjë në dorë kur vjen finalja, unë bëj punët e mia pa merak për ato gjëra nuk e ... ato janë muhabetet e fundit që do bëhen. Këto këtu, unë doja të nxirrja ndonjë diçka ktej, të paktën dhe 20 mijë euro, 10 mijë euro, 15, sa të mund të nxirrnim, nuk nxorrëm, mbaroj filmi, atë e kam unë në dorë, ore në fund fare un su jap gjë fare ore, e ke idenë ti se sa inat kam marrë unë këtë radhë me ata ? Kam bërë debat deri në 12 me ata mbrëm, prandaj s'të mora në telefon.*

Petraqi : *Dëgjo, dëgjo Ylli, ndaje muhabetin me ata..*

214. Po ne datën 10 Korrik 2016, në orën 18 : 35 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marre ne telefon përsëri të pandehurin Ilia Çabiri, fakt ky qe konfirmohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 10.07.2016 (fq 159-160 te dosjes vol 2). Nga përmbajtja e bisedës konfirmohet fakti se i pandehuri Petraq ,po vazhdonte veprimet e tij ne mënyre aktive, per te realizuar qëllimin dhe se ai kishte biseduar “*direkt me mikun*” dhe ja kishte thënë propozimin e tij por përgjigja ishte qe “*ai nuk pranon as me toka as me gjë, i do të thata*”. Sipas komunikimit qe ky i pandehur ka pasur me te pandehurin tjetër Ilia, ka rezultuar se:

Petraqi : *e vetmja gjë që na bëri ai ne është që nga 60 e çoj 50. Dakort ? Ktë po ta them ty, do marr dhe Lenicen, do t'ja them dhe asaj tani, sepse për ne është gjë e madhe që e uli 10*

Ilia : *Po shum ashu, ta kishte ul dhe njëçik.*

Petraqi : *Jo shum, është një gjë e mirë, nuk po them shum e mirë, po sido që të jetë, në pozitë që jemi ne është një gjë e mirë, dhe na jep goxha, goxha, na jep çik krah.*

215. Nga analiza qe i behet bisedës me larte si dhe ne vijim, konstatohet se: (i) konfirmohet fakti qe ai e ka bere propozimin; (ii) te dy te pandehurit tashme janë ne dijeni te masës se shpërblimit qe kërkohet dhe qe duhet te japin, per te përfituar vendimin ne favor te tyre (thjesht diskutojnë per masën e shpërblimit pasi u duket shume); (iii) te pandehurit po përpiqen per te siguruar shumën , pasi bashkëpronaret e tjerë nuk kishin mundësi te kontribuonin dhe se këtë duhet ta zgjidhnin pikerisht ata. Ndërkohë, te dy te pandehurit bien dakord qe bashkëpronaret qe nuk kishin mundësi te kontribuonin ne shumën qe do te jepej, tu zbritej pjesa e kontributit nga toka qe do te merrnin.

Ilia: “ Mos var shpresat andej dhe shpresat ti varim nga vetja jonë, kaq muhabeti.” Ne përfundim te bisedës petraqi i kërkon Ilias qe se bashku me Elenin te takohen ne fier per per ta ndare kete muhabet

Petraqi: “ Dëgjo mua, bëhet fjal që ta kesh iden, dëgjo mua se mos, bëhet fjal që nesër ktu bashk me Lenicen, në ora 10:00 apo 11:00 të jesh në Fier dhe do ta them un pse. Më dëgjove ?

Ilia: Të mora vesh mo, të vim nesër ne, nesër andej...në mëngjes ?

216. U provua me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 10.07.2016 (fq 84 -91 e dosjes gjyqësore, vol 2), se ne vazhdim te bisedave qe te pandehurit kane kryer me njeri tjetrin , po ne datën 10 Korrik 2016, ne orën 18: 39 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka marre në telefon të pandehurën Eleni Lino. Nga përmbajtja e bisedës së zhvilluar ndërmjet tyre, dalin qarte dhe konfirmohen përsëri disa fakte te rëndësishme.

(i) Konfirmohet fakti se i pandehuri Petraq kishte takuar personat qe do ta ndihmonin per te realizuar qëllimin e tij, per përfundimin e çështjes;

(ii) kishte bere propozimet përkatëse dhe kishte marre nje përgjigje ne lidhje me shumën qe kërkohet per te dhëne vendimin ne favor te bashkëpronareve;

(iii) Ndërkohë, konfirmohet fakti qe ata te tre duhet te takoheshin te nesërmen ne Fier per te biseduar si dhe per te nënshkruar nje akt noterial, pasi Petraqi i deklaronte se shumën mund ta siguronte dhe nga nje shok, por i duhej garanci dhe këtë mund ta realizonte duke bere aktin noterial dhe duke e zbritur me vone këtë shume nga pjesa e Ilias, sipërfaqe toke. Eleni bie dakord qe ai te vazhdoje përpjekjet, këtë shume ta sigurojnë dhe nga te tretet dhe me vone te rregullohen. Ndërkohë bien dakorte qe te takohen te nersemen ne Fier.

Petraqi : O Lenica.

Eleni : Urdhro.

Petraqi : Petraqi jam.....

Petraqi : Nga ato që bëm neve muabetet, me propozimet që i thash me tok, ose me kshtu, më kupton ?

Eleni : Po.

Petraqi : Ai nuk pranoj, se i do lek të thata, dakort ashtu, tani dhe i vetmi lajm i mir, është që nga 60 e uli 50.

Eleni : 50 ?

Petraqi : Më kupton ?

Eleni : Po.

Petraqi : Kjo është llaf i fundit, tani un nuk e di as vet se si e se qysh do bëjm nesër, po di t'them ktë, se sa po fola dhe me Yllin, po ai ishte atje n'mes të liqenit, po gjuante për peshk.

Eleni : Për peshkim ?

Petraqi : Dhe un nesër do ti them Yllit, edhe tyja, që na ora 08:30 - 09:00 - 09:30 të jeni ktu në Fier.

Eleni : Vim o t'keqen, po e di sa jam mërztur, nuk më zë gjumi natën dhe më jan bër

Petraqi : Mir, mir, dëgjo Petraqin, dëgjo.

Eleni : Jo, nuk më kuptove, ngaqe u gjënda kshu edhe më duket sikur të vim deri në këtë pike edhe të mos, ti ke të drejt, un në fakt nja 20 do rregullohem me Petraqin thash, ja për kok të fëmijve po s'kam thën kshu.

Petraqi : Tani, dëgjo mua që të kesh iden ti për çka do vish nesër.

Eleni : Po ?

Petraqi : Un kam shpresa nga një miku im të më ndihmoj.

Eleni : Mbase do perendia të na ndihmoj Petraq, pa pastaj e gjejmë pastaj, më von e

gjejmë.

Petraqi : *Ashtu, më dëgjo me, po nuk diskutohet, po më dëgjo.*

Eleni : *Po.*

Petraqi : *Qe ti dhe Ylli nesër, që ta bëjm të ..., do vish tek Noteri edhe do hedhim firmën që un Petraq Dashit i kam marr kaq, sa na bie me tresh, euro borxh, po të njëjtën gjë do bëj edhe Ylli.*

Eleni : *E bëjmë mo Petraq, e bëj un, e bëj un.*

Petraqi : *Ashtu, që të thuash se si e qysh dhe tani un ktë muabet e kam me ty, po ti nuk do ta marrësh Yllin, se un Yllit dua ti bëj muabetin që të bëj te Noteri, të bëj të njëjtën gjë. Më kupton ?*

Eleni : *Jo, jo, nuk i them asnjë gjë Yllit un..*

Petraqi : *Ashtu, tani Ylli në qoftë se do kërkoj akt dhurimi që të marri ato mbrapsh, pa më dhën lekët, edhe pa më dhën atë, ato lek, ça do më japi ose lekët se nuk po kërkoj atë që m'takon dua, nuk ka akt dhurimi dhe un do dua që t'ja them në sy ktë, ktë Yllit dhe ta kem na afër edhe t'kem dhe ty si dëshmimtare.*

Eleni : *Akt ? Për çar akt dhurimi për Yllin ?*

Petraqi : *Po do vi momenti që do t'kalohet në emrin e Yllit ajo pjes, a kupton, moj do merret ajo, si, si pron ?*

Eleni : *Ajo e madhja, po.*

Petraqi : *Po, nga a madhja, do thot ai un dua 15-shen time ?*

Eleni : *E Yllit po.*

Petraqi : *Po edhe un do ti them, nëm lekët të marrësh pjesën.*

Eleni : *Lekët e këtyre që do prishim tani ?*

Petraqi : *Lekët e këtyre, po, po.*

Eleni : *E, lekët e këtyre, po ato, po do ti..*

Petraqi : *E kupton? E bravo.*

Eleni : *Po.*

Petraqi : *Pra ti i do po, nëm lekët e të të ktjej hajt të bëjm aktin që dhe ti merre pjesën tende.*

Eleni : *Po.*

Petraqi : *Kurse me ty, me ty nuk e bëj ktë gjë. Më kupton ?*

Eleni : *E di o, e di o Petraq, e di.*

Petraqi : *E që ta dish pse do vish nesër.*

Eleni : *Dëgjo tani.*

Petraqi : *He ?*

Eleni : *Tani është shpejto nuk dua të llafosem nga kto gjëra po, në fakt Ylli në mes është një, është ai i pari, pastaj vijnë neve, po ta zesh nga një an të punëve.*

Petraqi : *Për çfar ?*

Eleni : *Ca do ti japim, ca do ti japim Yllit përshembëll nesër, pasnesër un dhe ti, se në ktë mes ta dish un dhe ti jemi, ta dish kshu më mir t'mos ket fare se sa është. Kur më tha dhe ato fjal që më ka thën mua i tha dhe pardje, më është prishur kaq zemra ku di un..*

Petraqi : *Po pse ca fjalësh ka thën Mihali ?*

Eleni : *Ka thën c'doni që të veni, babai im vdiq si mbret, un do vdes mbret, juve doni të mirrni për fëmijët, doni për ... do për vajzat, ti do për Janin e për Enaden. Po ti dhe un tani pse kujdesohemi për femijet kujdesohemi. Ç'ka pësuar ai, i ka vrrar trurin perendia, ku di un se ç'ka ai burri, ... ku di unë, i mungon një, ku di un si llogjikon ashtu, të mos iki un dhe ti tani për ca përpiqemi, për fëmijët përpiqemi.*

Petraqi : *Po për fëmijët, po për ç'ne, jo moj s'ma merr mendja të jet shprehur kshu Mihali, mbase ka qen nuk e di se si ësh kjo pun.*

Eleni : *Ku di unë, unë kam ç'kam, nuk jap, nuk i mirrni dot kot ashtu, e di sa më është, më ka prekur, nuk di fare të llafoset, të thot një fjalë, të thotë përpiquni sa keni mundësi, po i morrëm, po ku di un, është bër fare është bër ai, nuk di të llafoset, nuk di të, ku di un ç'të të them, ç'të të them.*

Petraqi : *Po jo moj ca jan kto muabete.*

Eleni : *Ashtu ka thënë, përpiqet Adela përshembëll, ç'do Adela i tha për vajzat e tij i do, për Enadën i tha, do vdesi, siç vdiq babai im mbret ashtu do vdes dhe unë, ku e di ti si do vdes dhe mamaja ime mbretëresh vdiq i tha po, un dhe Adela i tha, e di si do vdesim i tha, ne dhe fëmij, e di ku do vemi në këtë situatë i tha, ç'ne ku di un se ç'është ai, flet tër anapota, tër anapota flet ai, e mir, e themi nesër e themi nesër.*

Petraqi : *Dëgjo moj, dëgjo se un tani para dava gjysëm ore fola me Mihalin për letrën e asaj që ka bër me Yllin.*

Eleni : *Ee.*

Petraqi : *Edhe folëm normal, tani un nuk e di, nuk e di ç'a jan kto muabete, un se besoj dot që t'ket folur në këtë mënyrë Mihali.*

Eleni : *Ja mo, ja kshtu thoshte, ç'doni që përpiqeni, nuk i mirrni, kot ashtu, i doni për fëmijë, ee, si vdiq babai im mbret do vdes dhe unë, pse të, nuk kam, s'kam, nuk jap. Nuk e kam fjalën te lekët, e kam fjalën tek shprehja që flet. Jo, jo për Yllin mir bëre që, që bëre këte, atje do shkruhem dhe unë sikur, edhe un do shkruhem atje brenda.*

Petraqi : *Po mir, mo mir, shiko Petraqin, dëgjo mua tani...*

Eleni : *Ee.*

Petraqi : *Dëgjo mua tani, se është gjë e madhe, që të dish dhe ti që t'jemi t'sinqertë përpara vetes, përpara njëri - tjetrit dhe përpara zotit, se kemi fëmij mbrapa.*

Eleni : *Ashtu, ashtu.*

Petraqi : *Dhe nuk duam ta fusim shpirtin në gjynah, atë që do ti bëjmë, i bëjmë me të drejtë. Në rregull ?*

Eleni : *Me të drejtë, me të drejtë.*

Petraqi : *A rrofsh, pa i futur askujt në pjes, por të dish që, Petraqi me tyja nuk ka ç'a të bëj, të thot nëm kto, që t'jap këtë, apo sepse kur të vij momenti që do shiten, do nxirret lek, do themi, Lenica e lekët jan kaq euro që mi ke borxh po, më jep rregullohemi, do rregullohemi me njëri - tjetrin bashk dhe ti t'ja u thuash motrave ta din.*

Eleni : *E di, e di.*

Petraqi : *Ashtu de, kurse në marrdhënie me Yllin un e dua këtë gjë, që në qoft se Ylli më thot un nuk kam lek, nuk kam lek, at'herë nuk ke lek, nuk t'jap tokën dot.*

Eleni : *Dëgjo..*

Petraqi : *Më kthe lekët të marrësh pjesën. Më kupton ? Pra të kem dhe un një letër në dor që i kam dhën ktij njeriu kaq lek. Më kupton Petraqin ?*

Eleni : *Dëgjo ti, nesër do thuash do ndahen të tre, do marrim kaq lek me që e gjeta un njeriun, do marrim kaq lek, do ndahen në tresh. O, të them dhe këtë tani, më tha Ylli dhe rradhën e par që e mora n'telefon edhe pardje që ike ti ndenji një çik pas, më tha mua kam prishur 8.000 evro tani që kur hodhëm ato në Tiran tha, e këteja i kam të shkruara një nga një, një nga një tha, tani as i kërkova se ishte momenti që nuk ësh...*

Petraqi : *Për ç'a ka prishur 8.000 evro ai ?*

Eleni : *Nuk e di un tani ta them ti, më tha ashtu, nuk i kërkova llogari, as i thash gjë, se*

thash nuk është momenti që ti them tani unë ç'ke prishur, është momenti tani për të gjetur lek, un vras mendjen për të gjetur lek, nuk vras mendjen se ç'kemi bër, ç'kemi prishur.

Petraqi : *Po qysh paska prish, ja fut kot ai, po lëre. 9.000 më tha mua euro kam hyr borxh, që nga koha e asaj, tani nëjse flet si të doj ai, po muabete kot ato, tani dëgjo mua.*

Eleni : E mir, un tani të kuptova, nesër do thuash, nesër ti do marrësh lekët nga filani, do vim të shkruajm atje që ato lekët do kthehen nga ti, nga mua dhe

Petraqi : *Jo, moj jo, jo nga ti, nga mua, dëgjo se nuk marr un njerz të huaj, dëgjo.*

Eleni : *Po, mir mo, e kuptoj un po..*

Petraqi : *Ashu de, po kjo do bëhet nesër, në rregull, që un ktu, ktu, kam, por un më tepër e kam me Yllin, se sa me ju. Më kupton ?*

Eleni : *E di un, e di.*

Petraqi : *A rrofsh, ne bashk nuk kemi ndonjë më jep të jap se jemi një.*

Eleni : *Të kuptoj, të kuptoj.*

Petraqi : Kurse Ylli në rast se thot dua që të shkruhet në emrin tim pjesa ime, i them po do ti të shkruhet në emrin tënd po, më kthe lekët edhe merr atë që të takon, të marr un ktë që më takon, që të kam dhën vërtet, më kupton Petraqin, ta kem një letër që ti them urdho vlla i dashur më ke kaq mi kthe.

Eleni : ... që do vij dita që këto lekët do ti kthehen filanit që do ti marrim, ku do ti gjej un dhe ai..

Petraqi : *Po mir moj, mir ajo, mund t'jet n'emër t'filanit, mund t'jet n'emrin tim, s'ka problem.*

Eleni : *Nuk më kuptove, të themi ashtu pavarsisht se do ti japim, ti apo mu, apo tjetrit. Ato lekët do kthehen.*

Petraqi : *O po do kthehen po, moj i marr Petraq Dashit, moj mua, un Lenica filan fisteku, un Ylli filan fisteku, i kam marr Petraq Dashit kto, kaq borxh. Më kupton ?*

Eleni : O Petraq, bëni muabet dhe për këtë, e morëm këtë, po kur të vij hera tjetër që do andeja mos japim dhe atje o Petraq ?

Petraqi : Për kto lek, e për gjëra, për kto ?

Eleni : *Ee.*

Petraqi : *Jo moj jo, i thash un ati, un lek s'jap më, i thash, un s'gjej më sepse lekët...*

Eleni : Të dëgjova unë, të dëgjova un, që i the, i kam thën dhe un më përpara, tani si thash kto dit se kto dit vrasim mendjen për tjetër gjë, i thash po të na kërkojnë atje shum ç'do bëjmë ?

Petraqi : At'herë atje do ta zgjidhi vet, sepse vet e ka marr përsipër, un mora përsipër ktej, prandaj po ..

Eleni : *E mir, e mir, ai thot, jo, jo, jo, jo, pastaja nuk e di se ç'do bëjmë, mir.*

Petraqi : *Jo, jo, ai mund të thoj jo e jo, se ai është edhe nuk i besoj shum un, jo e jot e tija po, le të bëj ç'të doj, po të mbledhim mendjen ne ktej Lenica, se kjo është gjëja më e madhe, në rregull, pastaj kto të tjerat ...*

Eleni : *Ja të të them dhe një gjë, të them një gjë në qoftë se nuk ta them dot nesër. Në qoftë se mirren, Yllit ç'do ti japim ?*

Petraqi : *Jo në qoft se mirren moj, ato do mirren, qysh n'qoft se mirren.*

Eleni : *Mir mo, do mirren, do ti marrim. Ç'do ti japim Yllit ?*

Petraqi : *Po si ç'do ti? Kush do ti ? Ka 15-shen Ylli moj.*

Eleni : *O Petraq.*

Petraqi : *He ?*

Eleni : *Dëgjo ta them për shpirt të asaj nënës që na ka ikur, dëgjo tani, ato 15 i kan ata,*

që i kanë, ai s'ka asnjë gjë.

Petraqi : *Moj, me gjith mend e ke ti? Se ka ata të tyret, po ai muabetin me ata e ka bërë, se ka bër ai, pasi bëri muabetin me ta, të erdhi të takoj tyja dhe Mihalin.*

Eleni : *Dëgjo, dëgjo.*

Petraqi : *Muabetin dhe pjesën e ka me ata ai, se ka me ne pjesën.*

Eleni : *Dëgjo tani, un tani dua atë të drejtën tamam, ato i kanë, ata i kemi bër un, i kemi bër atë që 15 hektar do ti marrin ata, ata, ai s'ka asnjë gjë në mes, edhe i tha*

Petraqi : *Më fal, më fal një minut, një minut.*

Eleni : *Ata që janë atje në Tiran, nuk e di.*

Petraqi : *Po, jo aty, 15 hektar ata i shkruan n'emër të Yllit, se ata nuk i njofe ti si fytyra.*

Eleni : *Po, po.*

Petraqi : *E, po, e po*

Eleni : *Po, në emër të Yllit, po nuk janë atija, dëgjo tani, ç'do ti themi.*

Petraqi : *Dëgjo mua, dëgjo o ti Lenica, ata të dy në Tiranë, e par e punës është ai muabeti që kemi bër bashkë që ata nuk e di egzistojnë apo s'egzistojnë, e para, e para, dëgjo mua e para.*

Eleni : *Për Yllin, atë më ka vajtur në mendje, vetëm ajo më ka vajtur.*

Petraqi : *Ashu e para dhe e dyta, e di ç'ma tha atje prapa banakut ai, kur po merreshe me atë ti që erdhi për sandalle ?*

Eleni : *Po, po.*

Petraqi : *Un atyre nuk u jap gjë, më tha mua.*

Eleni : *Si, si ?*

Petraqi : *Un atyre tha, po t'ma bëjnë kshu tha, nuk u jap gjë fare tha, e s'ma bënë syri terr, m'tha mua.*

Eleni : *O, e mir.*

Petraqi : *E pra, e more vesh tani ti ?*

Eleni : *E kuptoj.*

Petraqi : *E, dhe Ylli më thot mua ishin ktu ata në Sarandë, ngelën ktu, ata nuk janë ata, nuk e din me një fjal, un 99% them që ata nuk egzistojn.*

Eleni : *Makar t'mos egzistojn, un gëzohem të mos egzistojn, më mir të mos egzistojn.*

Petraqi : *Tani me fal, me fal një minut, më dëgjo me kujdes, mos bëj gaf ti, ç'a ti japim Yllit, ne Yllit i kemi dhënë 15 hektar në emër t'Yllit dhe nga ky 15, Ylli t'vrasi veten me ata atje, me emrin se është në emër të Yllit ajo dhe Ylli ka emrin e tija nëpër 15 dhe duke pasur emrin për kto 15 le ta bëj pazarin me ta. Me ne s'ka bër pazar Ylli.*

Eleni : *O Petraqi, dëgjo tani, do ta them prap, ato vërtet janë të atireve, pavarësisht se kujt janë, un nuk e di se kujt janë, po un ta kam vet mos është ndonjë gjë e till, po tamam, tamam, si bisedojmë që në ditën e parë që biseduam ato 15 janë të atire, se ato ishin 30 -të ngaqë gjetëm këtë këtu që shkruante 40-të.*

Petraqi : *Ej, ej, se jemi n'telefon, e di Petraqi, tani po them këtë përfundimisht, Ylli pretendon 15, jo pretendon po është bër muabeti për 15 dhe 15 do marrin, në rregull.*

Eleni : *Dëgjom dhe njëher, është bërë 15 edhe i tha mamaja për Yllin janë të tjera edhe i ka thënë dhe këtë mamaja ja un nuk të gënjej, për Mihalin i tha jo që dhe ai do të të japi, se at'here Mihali bënte naze, s'donte që të bënte fare për Yllin, që të pleksej Ylli në mes.*

Petraqi : *Po, po, e di, e di.*

Eleni : *Edhe i tha mamaja jo dhe Mihali do të të japi i tha, nuk e bënë atë tha, po edhe sikur mos të të japi, do të të japi un i tha nga pjesa ime, i tha, ja ta them ashtu, nuk të gënjej un, tani nuk se këtu është pjesa ime edhe tënde bashk, nuk është pjesa tënde, të gënjej un, të, të ...*

Petraqi : *Mir, mir, të kuptoj Petraqi, tani më dëgjo me kujdes, ti nuk ke pse ta vrasësh mendjen për këtë gjë, sepse un ta thash përgjigjen e parë 99% Ylli i ka vet ato atje, e para, e dyta, ne nuk i kemi premtuar gjë dhe un në muabet e siper i kam then...*

Eleni : *I kemi premtuar, i kemi premtuar...*

Petraqi : *Mir, në qoft se i keni premtuar ju, është tjetër gjë.*

Eleni : *I kemi premtuar, i kemi premtuar.*

Petraqi : *E bëjm bashk këtë muabet, kur t'jet koha e*

Eleni : *E mir, e mir.*

Petraqi : *Lëm një dit tjetër, qysh e tek edhe ashu, por dëgjo mua*

Eleni : *O, ta bëjm kur të vij koha pastaj.*

Petraqi : *Dëgjo ktu ti dhe un do ta bëjm veshin shurdh, sepse Ylli nuk ka pjestar.*

Eleni : *...ai s'ka fare tani në këtë mes, ai pret nga neve ç'do ti japim neve me të thënat, te ..*

Petraqi : *Ja dhe njëher kjo, moj Lenica, mos të ngatrohemi me këmbët tona e motër, un po t'them kaq, Ylli, Ylli nuk pretendon pjes nga ne, un nuk kam bër muabet tha me ju, tha ç'të më jepni, më tha mua.*

Eleni : *Ee, ç'do ti japim neve, e .*

Petraqi : *Kshtu, un nuk kam bër muabet tha.*

Eleni : *Jo, nuk ke bër ..*

Petraqi : *Dhe un i thash dhe përgjigja ime ishte kjo: Ylli ti ke letrën në xhep me emrin tënd për 15 i thash, prandaj në qoft se ke bër pazare nuk i ke bër me ne, në rregull, se un se dija këtë muabetin e ndjes pastë Jorgjia, un po them, jo tha nuk kam bër muabete pazare, mua ç'të më jepni tha, po më dhat.*

Eleni : *E, po më dhat, e*

Petraqi : *E bravo, bravo, pra mos e zgjasim këtë muabet, se Ylli është andej në krahun tjetër dhe pazaret i ka me ta. Më kupton Petraqin ?*

Eleni : *Nuk ka Ylli, me fjalët që kemi thënë mir do ta llafosemi prap, po do ta them dhe njëher....*

Petraqi : *Dëgjo mua, degjo, mos e vrit mendjen ti se do të të them un se si e qysh e ashu..*

Eleni : *Do të të them edhe këtë un, do ti themi ata me që nuk ndihmuan në këto pjesë të tëra*

Petraqi : *Po lëre, se e di un.*

Eleni : *Do ti mbash atireve ti, mba sa të duash atireve ti, do ti themi.*

Petraqi : *Po moj moter, po, mbaj sa të duash.*

Eleni : *Atireve ti mbaj sa të doj.*

Petraqi : *E di una në këtë muabet do jesh ti dhe un, pasi të mbarojmë ato nesër edhe do bëjm këtë, jo do bëjm muabetin e ksaj, po asaj, se më premtoj tha mua, ata tha nuk japin më shum se 1 hektar e kupton, at'here un do ti them atë 1 hektarshin që dhan ata merre ti ashu de, në rregull edhe ky muabet merr fund.*

Eleni : *Dakort, tani në ç'or nesër do jemi atje ?*

Petraqi : *Tani un dua që ju nesër të jeni sikur nga ora 10:00 -10:30 ktu.*

Eleni : *Tani Yllin un nuk e marr në telefon, nisem vet.*

Petraqi : *Jo, jo, mos e merr, do ta marr un Yllin, ishte për peshk e se dëgjonim, jam me njerëz të tjer më tha mua dhe s'flas dot.*

Eleni : *Jo, jo, në qoft se më merr gjë mua do më thot që do ..*

Petraqi : *Jo, po të mori që do vi më tha Petraqi për nesër, vemi thoj, vemi, vetëm të zgjidhet puna i thoj dhe vemi.*

Eleni : *Ee, të t'them që të dish un tani edhe themi vemi, mos më thot që do kaloj un do të marrë, po patjetër do ti them, do më thot them un.*

Petraqi : *Po, patjeter, patjeter.*

Eleni : *Mir bëm që biseduam që të dim ç'të themi, që të di dhe un të llafos, mir pastaja Petraq.*

Petraqi : *Mir Lenica, kshu do ta bëjm.*

Eleni : *Shum, faleminderit, shum, shum.*

Petraqi: *Hajt, mirupafshim.*

217. Nga biseda e zhvilluar ne orën 20:36 te datës 10 Korrik 2016., mes te pandehurit Ilia Çabiri dhe të pandehurit Petraq Dashi, konfirmohet fakti se i pandehuri Ilia do të shkonte të nesërmen ne mëngjes të merrte në Gjirokastër të pandehurën Eleni dhe të dy bashkë të shkonin në Fier rreth orës 10 e 30 për t'u takuar me të pandehurin Petraq Dashi (vërtetohen me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te dt 10.07.2016, faqja 163 e dosjes gjyqësore, vol 2).

Petraqi : *Ylli.*

Ilia : *E mo pasha, ça bën ti ?*

Petraqi : *Dole ti ?*

Ilia : *E dola, nesër në orën 10:00 më do në Fier ?*

Petraqi : *Dëgjo mua, po do shkosh, do marrësh ..*

Ilia : *Lenicen, e di.*

Petraqi : *Do marrësh Lenicen..*

Ilia : *Po, po, do vete un, e bisedova ...*

Petraqi : *Edhe hajde, të pres ktu nesër, në 10:00 - 10:30, mire ?*

Ilia : *Dakort, hajde.*

Petraqi : *Natën e mirë.*

218. U provua gjate gjykimit se ne datën 11 Korrik 2016, (konfirmohet dhe nga procesverbali “Për kryerjen e përgjimeve në vende publike”, faqja 178-181 të volumit 2 të dosjes gjyqësore), te pandehurit janë takuar ne orën 9 e 40 a.m ne qytetin e Fierit. Pasi janë takuar, kane shkuar të tre së bashku tek noterja Etleva Stamo për të bërë deklaratën noteriale, që secili prej tyre pranonte që i kishte nga 17 mijë euro borxh të pandehurit Petraq Dashi. Siç rezultoi edhe nga deklarimet e noteres Etleva Stamo te bëra para Kolegjit Penal te Gjykatës se Larte ne seancën gjyqësore te datës 20.02.2017, i pandehuri Petraq Dashi është paraqitur me te pandehurën Eleni Lino ne zyrën e saj ku kane kërkuar te kryenin nje kontrate huaje. Noterja deklaroi se ka kërkuar prej te pandehurve qe te kryenin transaksionin me banke dhe pastaj ajo te përpilonte aktin noterial. Ne kushtet qe kjo notere u ka thëne qe veprimet ti kryenin me banke, pasi shumat kane qene te konsiderueshme (pra akti noterial do te kryhej nga noterja vetëm pasi asaj ti depozitohej vërtetimi bankar), dy te pandehurit janë larguar dhe nuk janë paraqitur me.

219. Te gjitha veprimet e te pandehurve atë dite, janë te fiksuara ne procesverbalet e vëzhgimit në vende publike të kryera nga policia gjyqësore qe i përkasin datës 11 korrik 2016, te cilat janë pranuar nga gjykata me cilësinë e provës ne këtë gjykim. Nga këto procesverbale, rezultojnë te fotografuara te gjitha veprimet e te pandehurve. Vërtetohet qe ata janë takuar ne Fier, kane qene ne zyrën noteriale te noteres Etleva Stamo, te tre janë ulur ne kafene dhe pasi kane dale nga kjo zyre dhe kane biseduar, te tre kane shkuar ne banesën e Petraq Dashit. Me vone kane dale prej saj, ku Ilia dhe Eleni janë nisur drejt Tepelenës, ndërsa Petraq Dashi është kthyer ne shtëpinë e tij nga ku ka vazhduar me vone veprimet e tjera per marrjen e te hollave.

220. Pasi te pandehurit Ilia dhe Eleni janë larguar, i pandehuri Petraq Dashi ka shkuar fillimisht te filiali i Raiffeisen Bank, që ndodhet në qendër të qytetit Fier. Pas dhjetë minutash i pandehuri Petraq Dashi ka dale nga banka dhe ka shkuar në pikën e transfertave monetare MoneyGram “Troka”, që ishte përballë bankës. Siç rezulton dhe nga (a) deklarimet e shtetasit Xhevahir Troka te bëra ne seancën gjyqësore te datës 20.02.2017; (b) nga procesverbalet e përgjimeve ambientale te kësaj dite; si dhe (c) regjistrimet e kamerave te kësaj agjencie, i pandehuri Petraq Dashi i ka kërkuar atij shumën prej 50.000 euro. Pasi shtetasi Xhevahir Troka ka marrë nga kasaforta e zyrës së tij shumën 50 mijë euro dhe e ka futur në çantë, në orën 11 e 40 a.m., te dy kanë shkuar në filialin e Raiffeisen Bank, që ndodhej përballë zyrës së këmbimit. Në bankë i pandehuri Petraq Dashi ka urdhëruar xhirimin e shumës prej 6,850,000.00 lekë, vërtetuar ky fakt nga mandat pagesa e datës 11.07.2016 (referojuni faqes 143 te dosjes gjyqësore, vol. 1) nga llogaria e tij personale në llogarinë e shtetasit Xhevahir Troka. Ky i fundit, pasi është siguruar se është bërë xhirimi i shumës në llogarinë e tij, ka shkuar te sporteli i bankës për të depozituar shumën prej 50 mijë euro në llogarinë e tij dhe për t’ia kaluar pastaj në llogarinë e të pandehurit Petraq Dashi. Por i pandehuri i ka kërkuar që t’ia jepte shumën në dorë cash, sepse i duhej shpejt (ky fakt është deklaruar nga shtetasi Xhevahir Troka ne seancën gjyqësore te datës 20.02.2017).

221. Në këto kushte, i pandehuri Petraq Dashi dhe dëshmitari Xhevahir Troka, kanë dalë te dy sebashku në orën 11 e 55 a.m nga banka dhe janë kthyer në zyrën e këmbit “Troka”. Aty shtetasi Xhevahir Troka, në ambjentet e brendshme të zyrës, nën monitorimin e kamerave (janë regjistrimet e pranuar si prova ne gjykim), i ka numëruar 50 mijë euro të pandehurit Petraq Dashi dhe ja ka dhënë ato atij, të futura brenda një qese plasmasi me ngjyrë të bardhë. Në orën 12 e 10 p.m., kanë dalë të dy nga zyra e këmbit “Troka” dhe janë përshëndetur. Shtetasi Xhevahir Troka është rikthyer brenda në zyrë, duke bërë raportimin e transaksionit që kishte kryer me të pandehurin, ndërsa i pandehuri Petraq Dashi ka hipur në motor dhe është kthyer për në shtëpinë e tij. Faktet e mësipërme konfirmohen nga raportet e policisë gjyqësore për vëzhgimin në ambjente publike, si dhe nga dëshmitë e dhëna para gjykatës nga shtetasit Xhevahir Troka.

222. Vërtetohet me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” date 11.07.2016 (fq 164 e dosjes gjyqësore, volumi 2), se ne orën 12:38 p.m., pra 28 minuta pasi ka marre prej agjencisë Troka shumën prej 50 mijë euro në cash, i pandehuri Petraq Dashi ka marrë në telefon të pandehurin Odhise Andrea, te cilit i kërkon qe te takohen dhe se kur mundej ky i fundit, qe te takoheshin. I pandehuri Odhise i përgjigjet: *“sa më shpejt aq më mirë, sepse është vapë e madhe dhe ikin njerëzit”*. Pra te pandehurit bien dakorte qe leket duhet te jepeshin sa me shpejt dhe per këtë arsye, i pandehuri Petraq Dashi vendos te niset atë mbasdite për në Tiranë. Dy te pandehurit Petraq dhe Odhise janë takuar nga ora 6 – 7 e mbasdites.

Odhisea : *E Petraq ?*

Petraqi : *Odise çu po bën ti vlla, mir je ?*

.....Petraqi : *Si e ke më mir, takohemi sontë në dark në Tiran, apo nesër ? Si është, si është, si e ke më mirë ?*

Odhisea : *Po sa më shpejt, aq më mir, vap e madhe, ikin njerëzit.*

Petraqi : *E, në rregull at'here, un po ashtu pastaj, për mbasdite sot.*

Odhisea : *Flasim mbasdite, 6 - 7 mbasdite që të mir e ?.....*

223. U provua ne gjykim me ane te raportit të shërbimit “Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016”, fakti se po atë ditë në orën 17 e 30, pm i pandehuri Petraq Dashi është nisur nga banesa e tij për në Tiranë, me automjetin “Volksvagen Cady” me targë AA 493 OB. Në orën 19 e 12, i pandehuri Petraq Dashi ka arritur në Tiranë, në rrugën “Sulejman Delvina”, ku ndalon mjetin dhe merr brenda tij të pandehurin Odhise Andrea, i cili po e priste në

rrugë. Në orën 19 e 15, automjeti “Volksvagen Cady” me targë AA 493 OB parkohet në rrugën “Margarita Tutulani”, në afërsi të një lokali të quajtur “Harli Cafe”. Te dy te pandehurit Petraq Dashi dhe Odhise Andrea kane zbritur nga automjeti dhe i pandehuri Petraq Dashi mban në dorë qesen e plasmasit e cila siç rezulton edhe nga fotografitë e raportit të shërbimit “Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016”, është po ajo e marre ne agjencinë “Troka” me ngjyre te bardhe dhe me stemën e agjencisë, e cila kishte brenda shumë prej 50.000 euro. Fakti qe brenda ne qese ishte shuma e mësipërme, konfirmohet dhe nga vete deklarimet e te pandehurve Petraq Dashi dhe Odhise Andrea, te dhëna ne seancat gjyqësore te datave 12.01.2017 dhe 27.02.2017. Por, ne ndryshim nga akuza dhe provat e shqyrtuara ne gjykim, te dy te pandehurit Odhise dhe Petraq, pretendojnë se kjo shume ishte dhëne hua per biznes.

224. Po nga procesverbali i përgjimeve ambientale te kësaj dite, rezulton qe, pasi dalin në rrugë dhe ndahen nga njëri tjetri, i pandehuri Odhise Andrea (i cili e ka tashme ai qesen e bardhe ku qe shuma e mësipërme) futet në një pallat që ndodhej pas lokalit “Harli Cafe” qe është dhe banesa e tij, ndërsa i pandehuri Petraq Dashi, merr automjetin “Volksvagen Cady” me targë AA 493 OB dhe nisat për t’u kthyer në Fier. Faktet e mësipërme, konfirmohen nga raportet e policisë gjyqësore për vëzhgimet e kryera në ambjente publike, të dokumentuar me fotot dhe filmimet përkatëse te datës 11.07.2016 te pranuar me cilësinë e provës ne këtë gjykim. Pasi ndahet nga i pandehuri Odhise Andrea dhe hipën në makinë për t’u kthyer në Fier, në orën 19 e 44, i pandehuri Petraq Dashi ka folur në telefon me shtetasen Sonela Dashi, vajzën e tij (ky fakt provohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” të datës 11.07.2016, ora 19.44 min, faqja 166 e dosjes gjyqësore, vol. 2). Nga biseda e zhvilluar ndërmjet tyre, vërtetohet fakti se: (i) i pandehuri ka ardhur ne Tirane per ti dhëne porosinë atij shokut si dhe (ii) konfirmon faktin qe “*ktë jav mbyllet, e merr në dorë*”.

Sonela : *Alo ?*

Petraqi : *He re babi, ku je ti ?*

.....Petraqi : *Un jam ktu te sheshi "Ëillson", se erdha i çova atë porosinë ati shokut.*

Sonela : *Kujt shoku re ?*

.....Petraqi : *I prura atë plaçken o ba, që .*

Petraqi : *.....ktë jav mbyllet tha ai, e merr n'dor.*

Sonela : *Ehe.*

225. Rezulton nga vendimi nr. 2171, date 12.07.2016 i Kolegjit Civil te Gjykatës se Larte (referojuni faqes 83-84 te dosjes gjyqësore, vol. 1), qe ne datën 12.07.2016 është mbledhur kolegji civil për shqyrtimin e çështjes me palë kërkuese Gjeorgjia Gjoka dhe persona të tretë Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë, ZAMT pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, Dega Sarandë, Këshilli i Komunës Ksamil dhe Fatos Mihaj, me objekt “*Përcaktimi i sipërfaqes prej 40 Ha e ndodhur në Ksamil*”, për të cilën është marrë edhe vendimi i sipërcituar, me të cilin është vendosur: “*Mospranimi i rekursit të paraqitur Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Gjirokastër ndaj vendimit nr. 118, datë 04.03.2014 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër*”.

226. Nga procesverbali “Per përgjimet e telekomunikimeve” te datës 12.07.2016 (referojuni faqes 92 te dosjes gjyqësore, vol. 2), provohet se ne datën 12 Korrik 2016, në orën 5 e 36 p.m., e pandehura Eleni Lino ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi dhe nga bashkëbisedimi mes tyre konfirmohet fakti se: (i) ajo ishte ne dijeni te veprimeve qe do te kryente i pandehuri Petraq Dashi; (ii) i pandehuri Petraq ia konfirmon faktin qe e ka “*çuar*”, dhe qe ishin ne pritje mos e merrnin ne dore brenda javës , duke i thënë se do ta njoftonte per çdo gjë.

Eleni : *E mir, vajte sot tutje ?*

Petraqi : *Po, po, i çova, edhe të shikojm, po të shikojm, na nesër, ose pasnesër mos e*

marrim në dorë, më tha ktë jav ishalla.

Eleni : *O, fjal të mira ...*

Petraqi : *Kur ta marr do të them un, se më tha do ta jap në dor më tha mua, kupton ? Po do të marr un n'telefon gjer at'here, që mos të mundohesh*

227. Rezulton qe nje dite pas zhvillimit te seancës gjyqësore ne datën 13 Korrik 2016, i pandehuri Petraq Dashi ka marre 6 herë në telefon të pandehurin Odhise Andrea, në numrin e tij të telefonit 694083111. Thirrjet janë bërë në 9 e 10 a.m., 9 e 23 a.m., 9 e 46 a.m., 7 e 57 p.m., 9 e 04 p.m. dhe 9 e 04 p.m. Në asnjë thirrje, i pandehuri Odhise Andrea nuk i përgjigjet. Me datën 14 Korrik 2016, i pandehuri Petraq Dashi ka marre edhe 3 herë të tjera në telefon të pandehurin Odhise Andrea, përsëri në numrin e tij të telefonit 694083111. Thirrjet janë bërë në 10 e 15 a.m., 11 e 50 a.m. dhe 12 e 42 p.m. Në asnjë thirrje i pandehuri Odhise Andrea nuk i përgjigjet (sa me sipër këto fakte konfirmohen nga Akti i Ekspertimit nr. 9365, datë 08.09.2016, si dhe procesverbali datë 27.09.2016 i oficerit të policisë gjyqësore, mbi këqyrjen e të dhënave të përfituara nga akti ekspertimit të telefonave celularë).

228. Ne kushtet qe nuk kane arritur te komunikojnë, i pandehuri Petraq Dashi, i shqetësuar ne datën 14 Korrik 2016, është nisur per ne Tirane per te takuar te pandehurin Odhise Andrea. Ky fakt, vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 14.07.2016 (referojuni faqes 95-97 te dosjes gjyqësore, vol. 2), ne te cilin është pasqyruar se, rrugës duke shkuar per ne Tirane në orën 5 e 38 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka folur ne telefon nëpërmjet nr 693520130, me te pandehuri Odhise Andrea, i cili i thote qe ishte nisur per tek ai dhe ishte ne Fier.

Odhisea : *Odesea jam, ça bëre ?*

....Petraqi : *Degjo, unë jam nisur për Tiran, burrash jam ktu në atë, isha dhe jam drejt Tiranës kshu që mirupafshim n'Tiran.*

Odhisea : *Un jam n'Fier.*

Petraqi : *A në Fier je ti, at'here po kthehem un.*

....Petraqi : *Për dhjet min shum, shum, njëzet minuta jam aty un.*

Odhisea : *E mir....*

229. Njëzet minuta më vonë, në orën 5 e 58 p.m., të datës 14 Korrik 2016, i pandehuri Petraq Dashi ka folur përsëri me te pandehurin Odhise Andrea në numrin 693520130. Nga analiza qe u behet te dyja bisedave, konfirmohet fakti se te dy po nxitoheshin per te takuar njeri tjetrin. Sapo janë takuar, ata kane shkuar tek zyra e noterit Durim Lekdushi, e cila ndodhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kane nënshkruar nje akt noterial te datës 14.07.2016, me nr. 1840 rep. nr. 1045 kol. Sipas këtij akti, rezulton qe i pandehuri Petraq Dashi, i kishte dhënë të pandehurit Odhise Andrea në Tiranë, ne datën 11.07.2017, ora 19 e 25, nje shume prej 50.000 Euro, shume e cila ishte dhëne borxh për arsye biznesi, pasi kane kanë lidhje familjare me njëri tjetrin. Sipas këtij akti, borxhi do të kthehej nga i pandehuri Odhise Andrea ne datën 31.12.2016. Të njëjtin deklarim bën dhe i pandehuri Odhise Andrea.

230. Ndërkohë, ne vijim te komunikimit qe te pandehurit Benin me njeri tjetrin, siç vërtetohet dhe nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” date 15.07.2016 (referojuni faqes te dosjes gjyqësore, vol. 2), ne datën 15 Korrik 2016, në orën 20 : 36 p.m., e pandehura Eleni Lino ka marre në telefon të pandehurin Petraq Dashi. Ata kane biseduar mes njeri tjetrit dhe nga biseda vërtetohen faktet: (i) e pandehura Eleni ishte ne pritje te nje përgjigje per çështjen dhe donte te dinte rezultatin; (ii) dhe i pandehuri Petraq i përgjigje qe gjerat ishin pozitive, por ngaqë ishte vene ne dijeni qe tashme ndaj tij ishin duke u kryer veprime nga organet proceduese (po përgjoheshin bisedat), e porosit Elenin qe te mos fliste asnje fjale ne telefon me askend.

Petraqi : *E moj Lenica?*

Eleni : *O Petraq.*

Petraqi : *Mir ?*

Eleni : *C'bëni mirë? Nuk më zihet mua, prit, prit, thash un do ta marr.*

Petraqi : *Jo, jo, dëgjo, mos, mos marrim asnjë dhe do t'jap një këshill, mos fol fare n'telefon me askend, kur të vi vet un dhe do takoj vet mirë?*

Eleni : *E mir.*

Petraqi : *Gjërat jan pozitive kaq.*

Eleni : *E mir.*

231. Te gjitha transkriptet dhe procesverbalet e analizuara me lart ne mënyre kronologjike, te cilat janë marre me cilësinë e provës nga kjo gjykate, si dhe veprimet konkrete te kryera nga ky i pandehur ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë (veprime te cilat koordinohen dhe janë ne përputhshmëri me njëra tjetrën), konfirmojnë qarte faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale per te cilën akuzohet. Ne te gjithë këto veprime del qarte konsumimi i anës objektive dhe subjektive te veprës penale. I pandehuri Petraq Dashi nuk e pranon akuzën, duke pretenduar para gjykatës ne deklarimet e tij se, shumën prej 50.000 euro ja ka dhëne te pandehurit Odhise Andrea per arsye biznesi, per shkak te marrëdhënieve familjare qe ata kishin. Ai e pranon faktin ashtu siç është (siç ka ndodhur). Ne lidhje me dy te pandehurit e tjerë Ilia Çabiri dhe Eleni Lino, pranon qe ka bere te gjitha bisedat me te pandehurit, faktin qe u ka thëne atyre se shumën prej 50 mijë euro do ti jepte ne Gjykatën e Larte per marrjen e vendimit ne favor te tyre, por deklaroi se sa me sipër është nje mashtrim qe ai u ka bere dy te pandehurve, sepse donte që të përfitonte më shumë sipërfaqe toke në përfundim të procesit.

232. I pandehuri Petraq Dashi nuk e pranon akuzën. Mbrojtja e këtij te pandehuri ne konkluzionet përfundimtare, kërkoi nga ana e këtij trupi gjykues paperdorshmerine e provave dhe konkretisht te transkripteve dhe procesverbaleve te analizuara me lart ne këtë vendim, te përfituara si pasoje e përgjimeve te telekomunikimeve qe rridhnin nga marrja e vendimit nr. 386, date 03.06.2016 te Gjykatës se Shkalles se Pare te Krimeve te Renda dhe per rrjedhoje, edhe te gjitha transkriptet e përfituara si pasoje e përgjimeve te telekomunikimeve qe rridhnin nga vendimet me nr. 465, datë 07.07.2016, me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Petraq Dashi; nga vendimi nr. 468, datë 09.07.2016 me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Odhise Andrea. Argumentet e përdorur nga kjo mbrojtje per paperdorshmerine, janë te njëjta me te gjitha argumentet qe kanë ngritur edhe te gjithë avokatet e tjerë dhe te analizuara me lart ne këtë vendim. Pra, Gjykata e Shkalles se Pare te Krimeve te Renda ne vendimin e saj 386, date 03.06.2016 dhe ne vendimet ne vijim, nuk kishte respektuar kërkesat e parashikuar nga neni 221/a , 222/a te KPrP dhe se kjo gjykate ne vendimin e saj, i referohet përgjimit parandalues. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se, pikerisht këtij pretendimi, ne mënyre te detajuar i është dhëne përgjigje me lart ne këtë vendim, nga pika 149-178 (pa qene nevoja te përsëriten), argumente te cilat kane vlere te plote ligjore dhe ne rastin konkret.

233. Për të vërtetuar pretendimet e tij mbrojtja e te pandehurit Petraq Dashi, përveç deklaratës noteriale të administruar qe gjatë hetimit paraprak dhe te pranuar me cilësinë e provës, kërkoi qe te pyeten si dëshmitare para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe shtetaset Matilda Dashi (bashkëshortja e tij) dhe Sonela Dashi (vajza e tij), si dhe kërkuan te pranoheshin me cilësinë e provës, dy foto të ambienteve të brendshme të banesës së të pandehurit Petraq Dashi.

234. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se provat e paraqitura nga mbrojtja e te pandehurit, nuk kane asnjë lidhje logjike me njëra tjetrën dhe nuk mund te provojnë te kundërtën

e asaj qe provoi akuza. Kjo pasi janë te gjitha episodet e përmendura me lart ne këtë vendim, ne mënyre kronologjike, te cilat vërtetojnë se i pandehuri Petraq Dashi nga qershor i vitit 2016 deri ne Korrik 2016 ka punuar intensivisht, me veprime aktive direkte ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë, me dashje per arritjen e qëllimit te tij dhe konkretisht duke premtuar, propozuar dhe dhëne direkt shpërblim, ne këmbim te marrjes se nje vendimi ne favor te tyre.

235. Siç e shpjeguam edhe me lart ne këtë vendim, te gjitha faktet e ndodhura janë pranuar dhe nga vete i pandehuri, me te vetmin ndryshim se ai deklaroi se këto para, te pandehurit Odhise i janë dhëne borxh dhe jo ne këmbim te marrjes se nje vendimi ne favor te tij. Ai deklaroi se gjithë sjellja e tij karshi te pandehurve Ilia dhe Eleni është e vërtete, por kjo është bere me qellim qe te mashtroje këta te dy me qëllime përfitimi. Ne seancën e datës 27.2.2017, ai ka deklaruar se: *“Ne këtë situatë pas kaq vjetësh, I.Çabiri duke qene se merrej me gjyqet, ne dy vitet e fundit thoshte vazhdimisht se ka shpenzuar leke, kishte dy njerëz te tij ne Tirane qe sipas tij ju kishte marre lek borxh qe nuk ja kthente dot, por u kishte premtuar toke. Duke shfrytëzuar këtë rrugë per shpenzimet, vajtje-ardhje pretendonte se kishte hardhuar 8-9 mije euro. Përballe këtij fakti u ndjeva i mashtruar dhe pikësynimi i tij mu duk vetëm per te përfituar. Shtetasin I.Çabirin e kam marre ne telefon, ku i them se atje ne Tirane duhet te paguash, do graso kjo pune. Ne bisedën e datës 10 te bere me E.Lino, i kam thënë se nuk e besoj per ato qe thotë, por unë dua qe I.Çabiri te vije me ty ne Fier me te cilën te thuash qe i nje nje borxh. I kam thënë nuk kam asnjë gjë me ju, e dua per Yllin, sepse dua ti them qe do te marresh aktin, me kthe leket qe me ke dhe hajde te marresh aktin. Kur ka ardhur ne Fier nuk dinte gje, kur kemi vajtur tek noterja, me tha qe nuk te kam kerkuar lek, kemi bere replike dhe I.Çabiri nuk ka pranuar. Kjo qe them une bazohet ne prova. Kur kam biseduar me E.Lino, i kam thene qe kam folur me miqte, por nuk duan toke por leke, nga 60 ne 50 ka qene dicka e stisur nga une. Nuk ekziston asnje bisede e bere me te tjere, vet ine i stisja dhe vet i jepja pergjijge, per ti thene I.Çabirit qe nese ke harxhuar leke kam harxhuar dhe une. Keto muhabetete ja kam bere Yllit nje muaj me pare. Shtiresha qe do paguaja leke”*.

236. Këto deklarime te pandehurit, nuk përputhen me veprimet dhe bisedat konkrete qe ai ka bere, pasi ishte ai i cili qe nga Qershor i vitit 2016 deri ne korrik te po këtij viti, ka qene ne veprimtari intensive per te përfunduar çështjen ne Gjykatën e Lartë, si dhe per te siguruar shumën e kërkuar. Te gjitha bisedat dhe veprimet e kryera ndërmjet te pandehurve (te analizuara me lart), përputhen plotësisht me pasojën qe ka ardhur nga këto veprime. Ishte i pandehuri Petraq Dashi ai i cili i ka thënë ne datën 24 Qershor 2016, te pandehurit Ilia Çabiri se, nuk ke pse shkon ti, se merrem unë me njerëzit e mi atje, me gocën e xhaxhait dhe se “ajo do zgjidhet në muajin korrik” 2016. Ishte ky i pandehur, i cili ne datën 6 Korrik 2016, i konfirmon te pandehurit Ilia Çabiri se i ka dërguar fjalë atij mikut me të atin. Është po ky i pandehur qe ka informacion per çështjen kur thotë se: *“çështja është në shqyrtim, akoma ne po e shikojmë, po mos ki merak”*, dhe qe konfirmon faktin se: *“muhabetet janë bërë t’shkoqura, t’pjekura, t’sakta”*. Është ky i pandehur, i cili kërkon te takohet me dy te pandehurit e tjerë ne Gjyrokastër per te folur per “koston”, *“se është ajo ne Gjykatën e Lartë”*. Është po ky i pandehur, i cili udhëzon te pandehurin Ilia qe te punoje me bashkëpronaret e tjerë per te siguruar shumën, si dhe bëjnë propozime se si mund te paguhet shpërblim me toke apo ne te holla (ndërkohë qe Ilia ndiqte udhëzimet e tij me bashkëpronaret). Është po i pandehuri Petraq Dashi ai qe ka dijeni per lëvizjet e Odhise dhe Majlinda Andreas, dhe qe nga bisedat qe zhvillon me Ilian dhe Elenin u konfirmon atyre faktin qe personi *“nuk ka rene dakorte që të jepej si shpërblim një sasi toke, por ne cash dhe shuma që do paguhej të ulej nga 60 mijë euro në 50 mijë euro”*.

237. Gjate këtij gjykimi, janë te vërtetuara faktet qe te tre te pandehurit Ilia, Petraqi dhe Eleni, kane shkuar ne Fier per te bere nje akt noterial, gjë te cilën nuk e kane realizuar. Ishte rene

dakord qe, dy te pandehurit Ilia dhe Eleni duhet te deklarorin se i kishin borxh Petraqit shumën prej 17.000 euro. Është i vërtetuar fakti qe ky i pandehur mori nga agjencia e këmbimit valutor “Troka” shumën prej 50.000 euro ne cash dhe i kaloi kësaj shoqërie shumën prej 6,850,000.00 ne leke. Është po ky i pandehur qe brenda ditës ka shkuar ne Tirane, per te takuar te pandehurin Odhise Andrea dhe i ka dorëzuar atij qesen e marre nga agjencia “Troka” me shumën 50 mijë euro. Këtë fakt ja konfirmon dhe te bijës, duke i thënë se “*sapo i kishte çuar porosinë atij shokut dhe se këtë javë mbyllet, e merr në dorë*”. Po kështu, është ky i pandehur qe pasi ka mbaruar çështja ne Gjykatën e Larte, i thotë Elenit se çdo gjë do shkoje mire, brenda javës do te mbyllet dhe e ka “çuar” atë.

238. Alibia e ngritur nga ky i pandehur, nuk mund te vërtetohet me provat qe ka sjelle mbrojtja e tij. I pandehuri mundohet qe ta interpretoj shprehjen qe i thotë te bijës se “*sapo i kishte çuar porosinë atij shokut dhe se këtë javë mbyllet, e merr në dorë*”, se ai bashke me qesen qe kishte 50.000 euro i kishte çuar te pandehurit Odhise edhe nje mostër mermeri, pasi po bënte punime ne shtëpi dhe se ishin këto punime qe priteshin te mbaronin brenda javës. Sa me sipër, ky interpretim bie ne kundërshtim me provat pasi: (i) Nga fotografitë e raportit të shërbimit “Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016” rezulton qarte qe qeska qe I pandehuri Petraq jep te pandehurit Odhise është po ajo e marre nga agjencia Troka dhe qe ka brenda Shumën prej 50.000 euro; (ii) Shprehja “*këtë javë mbyllet, e merr në dorë*”, e nxjerre nga konteksti i bisedës, nuk mund te përdoret per punimet e mermer granitit apo per rikonstruksione ne shtëpi; (iii) Fotografitë me pamje nga shtëpia e Petraq Dashit, te sjella ne gjykim nga mbrojtja e tij, s’kanë asnjë lidhje me ngjarjen konkrete (ajo është nje pamje e ambientit te gatimit). Këto fotografi nuk dihet kur janë bere, si kane qene këto ambiente me pare, çfarë ndryshimesh janë bere dhe çfarë ka dashur te vërtetoje mbrojtja me to; (iv) Shprehja mbaron këtë jave qe ai i thotë te bijës, përputhet plotësisht me përfundimin e procesit gjyqësor i cili zhvillohet te nesërmen e dhënies se te hollave, ne dt 12.06.2017 ne favor te te pandehurve; (v) biseda e zhvilluar mes tij dhe te pandehurës Eleni, kuptohet qarte qe s’kanë lidhje me rikonstruksionet e shtëpisë se tij, por me mbarimin e procesit gjyqësor. Është Petraqi, ai qe i thotë asaj se: “*po i çova edhe të shikojmë, nesër ose pasnesër mos e marrim në dorë, këtë javë ishalla*” (perdorur e njejtja shprehje, kete jave qe perdor dhe me te bijen).

239. Po kështu, pretendimi se shuma e mësipërme ishte dhëne borxh te pandehurit Odhise Andrea, nuk rezulton e provuar nga provat qe u paraqiten si nga mbrojtja e te pandehurit Petraq Dashi, ashtu dhe nga mbrojtja e te pandehurit Odhise Andrea. Kjo pasi: (i) nga gjithë kronologjia e bisedave dhe veprimeve te kryera nga tre te pandehurit (te analizuara me lart ne këtë vendim), si dhe rezultati i ardhur, del qarte qëllimi perse është dhëne shuma e mësipërme; (ii) Kryerja e kësaj deklarate ne datën 14.07.2016, pasi kishte mbaruar çështja gjyqësore dhe pasi dy te pandehurit Odhise dhe Majlinda Andrea, ishin vene ne dijeni te ekzistencës se nje dosje dhe nje procedimi penal, konfirmon dhe njëherë faktin qe sa me sipër ky akt nuk pasqyron realitetin. Shqetësimi per te realizuar nje akt te tille, del nga biseda e zhvilluar ndërmjet dy te pandehurve Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea “*bei ato veprimet sot me shume kujdes*”, si dhe nga fakti qe te dy te pandehurit nxitojne per tu takuar dhe sapo takohen, shkojne menjehere per te perpiluar aktin noterial; (iii) Nuk kishte asnjë arsye apo pengese ligjore qe ne kushtet qe leket jepeshin borxh, shuma e mësipërme te paguhej me banke (siç e kërkon edhe ligji per procedurat tatimore dhe ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar) ne llogarinë e ortakut, ose te shoqërisë, meqe pretendohet se ky është nje borxh i marre per te blere makineri dhe kontribut i ortakut ne shoqëri; (iv) Nuk ka asnjë derdhje te kësaj shume, as ne banke dhe as me fature te thjeshte ne shoqëri nga i pandehuri ose personi i besuar ne shoqërinë “*Marmor*

Production” sh.p.k, qe te vërtetojnë faktin se kjo shume është marre per qëllime biznesi dhe per te blere makineri; (v) fakti qe shuma është dhëne nje dite para zhvillimit te procesit gjyqësor krijon dhe me tepër bindjen tek Kolegji Penal qe shuma është dhëne per këtë qëllim.

240. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se deklaratimet e dhëna nga shtetaset Matilda Dashi dhe Sonela Dashi në cilësinë e dëshmitarëve te thirrura ne këtë gjykim, duhet te merren me rezerve. Kjo per shkak te faktit se te dyja këto dëshmitare, janë te afërmit e te pandehurit Petraq Dashit e konkretisht, Matilda Dashi është bashkëshortja dhe Sonela Dashi është vajza e tij. Ne deklaratimet e tyre, këto dëshmitare nuk sollën asgjë te re ne lidhje me ngjarjen, por vetëm përsëriten te njëjtat fakte dhe ngjarje qe kishte thënë edhe vete i pandehuri Petraq. Per me tepër qe, dëshmitarja Matilda Dashi kishte qene e pranishme ne çdo seance gjyqësore. Ky Kolegj, vlerëson se deklaratimet e te dyja dëshmitarëve vine ne kundërshtim te plote me faktet dhe provat e paraqitura nga akuza dhe te provuara ne gjykim e te analizuara me lart ne këtë vendim.

241. Ne përfundim te analizës se provave te bëra me lart ne këtë vendim, konfirmohet fakti qe vepra penale është kryer nga ky i pandehur ne bashkëpunim me te pandehurit e tjere. Bisedat dhe veprimet e kryera prej tij te analizuara me lart ne këtë vendim konfirmojnë vullnetin e plote te tij per arritjen e qëllimit, per kryerjen e veprimeve korruptive ne këmbim te marrjes se nje vendimi ne favor te pronareve. Me veprime konkrete ai ka bashkëpunuar si me te pandehurin Odhise, ashtu edhe me te pandehurit e tjerë, Ilija dhe Eleni per dhënien e nje vendimi ne favor te tij. Nga bisedat dhe veprimet e tij, del qarte dashja direkte ne kryerjen e këtyre veprimeve si dhe bindja qe vetëm me këtë rruge, mund te marrin nje vendim ne favor te tyre. Pra, konfirmohet plotësisht ezaurimi i anës objektive dhe anës subjektive te subjektit te veprës penale.

242. Per te pandehurin Odhise Andrea, ndryshe nga akuza, Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se ai ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë Petraq Dashi, Ilija Çabiri dhe Eleni Lino, ka konsumuar elementet e veprës penale te “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionareve te tjerë te drejtësisë”, parashikuar nga neni 319 te K.Penal dhe jo veprën penale te “Korrupsionit pasiv i gjyqtareve, prokuroreve dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë te parashikuar nga neni 319/ç i KP.

243. Ne rast se do te analizojmë këto dy vepra penale, do te shohim se objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike te vendosura per te siguruar nje veprimtari te rregullt e korrekte te organeve gjyqësore, te prokurorisë si dhe te funksionareve te tjerë te drejtësisë, si dhe interesat e ligjshme te shtetasve te mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Nga ana objektive te dyja veprat kryhen me veprime aktive te shprehura ne mënyra te ndryshme, me ane te premtimit, propozimit ose dhënies, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çfarëdo përfitimi të parregullt gjyqtarit, prokurorit ose funksionarëve të sistemit të drejtësisë, e lidhur kjo me kryerjen ose moskryerjen e një veprimi që lidhet me detyrën a funksionin e tij. Referuar te drejtës sonë penale, vepra penale konsiderohet e kryer qe nga çasti i premtimit ose i propozimit për një nga funksionarët e sistemit te drejtësisë si gjyqtarit, prokurorit ose punonjësit të organeve të drejtësisë, pavarësisht nga ardhja e pasojave te tjera.

244. Dallimi mes këtyre dy veprave, është te subjekti i veprës penale. Ndërsa ne veprën penale te parashikuar ne nenin 319 te Kodit Penal, subjekt është çdo person i cili ka mbushur moshën per përgjegjësi penale, i përgjegjshëm dhe qe premtion propozon ose jep përfitim te parregullt personit qe është me detyre gjyqtar, prokuror ose funksionar i sistemit te drejtësisë, subjekt i veprës penale te parashikuar nga neni 319/ç te Kodit Penal janë: “*gjyqtaret, prokuroret dhe funksionaret e tjerë te organeve te drejtësisë, pra janë subjekte te posaçëm (ndryshe nga korrupsioni aktiv qe mund te jete çdo shtetas, mjafton qe te këtë mbushur moshën per përgjegjësi*

penale)” te cilët, mund te kërkojnë te marrin ne mënyre te drejtpërdrejte apo te tërthorte, çdo lloj përfitimi te parregullt ose premtime te tilla, per vete ose per persona te tjerë, per te kryer apo moskryer nje veprim qe lidhet me detyrën e funksionin e tij.

245. Nga ana subjektive, te dyja veprat kryhen me dashje te drejtpërdrejte dhe me qellim përfitimi. Nga analiza e mësipërme, nisur nga cilësia qe ka ky subjekt (ai nuk është as gjyqtar, as prokuror dhe as funksionar i drejtësisë), ky Kolegj vlerëson se i pandehuri Odhise Andrea ka konsumuar veprën penale te parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal ne bashkëpunim me te pandehurit e tjerë, te trajtuar me lart ne këtë vendim. U provua ne gjykim lidhja qe ekzistonte mes te pandehurit Petraq dhe bashkëshortes se tij (ata ishin kushërinj). Ndërkohë u provua se bashkëshortja e te pandehurit Odhise ishte nje prej anëtareve te Kolegjit Civil te Gjykatës se Larte, e cila mori ne shqyrtim çështjen civile me objekt: “*Përcaktimi i kufijve për sipërfaqen 40 ha e ndodhur në Ksamil*”, bazuar në rekursin e bërë nga ish-Komuna Ksamil, si dhe nga Avokatura e Shtetit, regjistruar në Gjykatën e Lartë me datën 21.11.2014.

246. Ne analize te gjithë kronologjisë se ngjarjes, si dhe procesverbaleve te transkripteve te bisedave te trajtua me lart ne këtë vendim dhe te marra me cilësinë e provës, u vërtetua fakti se i pandehuri Petraq Dashi, ishte kushëri me bashkëshorten e Odhise Andreas, si dhe nje nga subjektet e interesuara per përfitimin e pronës per shkak te bashkëshortes se tij. Ne bisedën e datës 24 Qershor 2016, qe i pandehuri Petraq ka kryer me te pandehurin Ilia Çabiri, është shprehur dhe i thotë ndër të tjera se: “*nuk ke pse shkon ti në Tiranë të interesohesh, se merrem unë me njerëzit e mi atje, me gocën e xhaxhait*”, duke treguar si faktin qe po merrej me këtë pune, ashtu dhe subjektin me te cilën po merrej. Po kështu, bazuar ne procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 06.07.2016, rezulton se ne bisedën e kësaj date qe zhvillohet ndërmjet te pandehurit Ilia Çabiri dhe të pandehurin Petraq Dashi, ky i fundit i thotë “*se i ka dërguar fjalë atij mikut me të atin,*” ku siç del nga ngjarjet e mëvonshme tashme te vërtetuara, ka lënë te nënkuptohet qe behej fjale per te pandehurën Majlinda Andrea (pasi baballarët e tyre janë kushërinj te pare). Nga kjo bisede, del qarte dhe fakti qe i pandehuri Petraq Dashi ka informacion te sakte per te gjitha lëvizjet e dosjes. Ai thotë se “*edhe tha se çështja është në shqyrtim akoma, ne po e shikojmë, po mos ki merak, si dhe i konfirmon se muhabetet janë bërë t’shkoqura, t’pjekura, t’sakta.*”

247. Siç u trajtua dhe me lart ne këtë vendim (pa rene ne përsëritje te bisedave) dhe siç del nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07 Korrik 2016 (fq 133 e dosjes gjyqësore, vol 2), po ne këtë date në orën 12:43 minuta p.m., i pandehuri Petraq Dashi është takuar në Rrogozhinë me të pandehurin Odhise Andrea, Nga komunikimi qe kane pasur dy te pandehurit ne këtë date, ka rezultuar se:

Petraqi: *Po?*

Odhise: *Ktu ke furgonat jam un, ku je ti?*

Petraqi: *Ee degjo ja ja po dal ne rrug un tani nje sekond, ja ja jam ktu mu te rruga te fugonat ku te fugonat?*

Odhise: *Ke fugonat..*

Petraqi: *Te ai fugoni i verdhe?*

Odhise: *E e e.*

Petraqi: *Aty rri e leje se te pash ja erdha erdha*

248. Nga bisedat qe zhvillohen menjëherë pas këtij takimi mes te pandehurve Petraq dhe Ilia, te vërtetuara këto te fundit me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” po te datës 07.07.2016 (faqja 134 e dosjes gjyqësore, vol 2), si dhe nga biseda qe zhvillohet mes Petraqit dhe Elenit e vërtetuar me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 07.07.2016 (fq

136-137 e dosjes gjyqësore vol 2), krijohet bindja se dy te pandehurit Petraq dhe Odhise kur janë takuar ne Rrogozhine, kane biseduar per shumën qe duhet te jepnin ne shkëmbim te vendimit.

Ilia : *Sa është kostua mo Petraq ?*

Petraqi : *Tashti po atë do takohemi, jan gjëra që s'bëhen n'telefon kto, me një fjal, o bëhet ktë javë që vjen, o s'bëhet, me një fjal, kshu që kostua është veri ato, po takohemi sot mbasdite n'Gjirokastër dhe kaq, mir, hajt.*

Ilia : *E mir nga ora 6-7*

Petraqi: *Hajt*

249. Po keshtu dhe biseda e Petraqit me Elenin.

Eleni : *O, Petraq, ç'bëni ?*

Petraqi : *Ee, për atë të mora sepse nesër i thash dhe Yllit, nga ora 11-11 e 30, do takohemi aty në Gjirokastër.*

Eleni : *E mir, shum mir, ndonjë lajm të mirë ?*

Petraqi : *I mir, i mir, po hajt.*

Eleni : *E mir pastaj, nga ora 11 e 30, e ?*

Petraqi : *Po, po, hajt.*

250. Është tashme i provuar fakti qe takimi mes tre te pandehurve është realizuar ne datën 8 Korrik 2016 në Gjirokastër, per te diskutuar ne lidhje me shumën qe duhet te jepnin dhe se si duhet ta siguronin atë brenda një kohe shumë të shkurtër (analizuar me lart ne këtë vendim). Nga trajtimi qe u është bere me lart ne këtë vendim, bisedave te zhvilluara mes te pandehurve, kane dale qarte dhe faktet qe provojnë këto biseda.

251. U provua gjate gjykimit se, ne datën 8 Korrik 2016, në orën 17 e 25, të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea me automjetin me targa AA307LT, kane dale nga territori i Republikës së Shqipërisë për në Greqi, nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Bota, Sarandë. Ndërkohë kishin rezervuar dhe bileta trageiti për të udhëtuar për Itali me datën 15 Korrik 2016.

252. Nga procesverbalet e bisedave te analizuara me lart ne këtë vendim, u vërtetua ne gjykim se i pandehuri Petraq Dashi ka dijeni per lëvizjet e dy te pandehurve dhe kjo del nga biseda e zhvilluar ne datën 9 Korrik 2016, ora 8 e 35 a.m., ndërmjet te pandehurit Ilia Çabiri dhe Petraq Dashi. Ky i fundit, i di lëvizjet e tyre dhe po pret nje përgjigje nga Ilia qe t'ja u konfirmoje: “*Merr pergjigje, merr pergjigje nga ata se une do neser po qe se ata se me thane nje llaf sikur s'kan ikur ne Itali nuk e di ku kan vajt, une do interesohem sonte, po ashtu vete neser i takoj per te bere ato muhabetet, po me nda kete njehere mua ti qe te jem me kembe ne toke*”. Konfirmohet nga provat e dorëzuara dhe te pranuar me cilesine e proves nga vetë të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea se, një ditë më parë ata kishin rezervuar biletat e trageitit për të ikur në Itali me datën 15 Korrik 2016.

253. Me datën 10 Korrik 2016, të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea kthehen nga Greqia dhe futen në territorin e Republikës së Shqipërisë në orën 15 e 16 minuta, nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Bota, Sarandë. U vërtetua se ne datën 10 Korrik 2016, në orën 18 e 35, i pandehuri Petraq Dashi ka folur ne telefon me të pandehurin Ilia Çabiri, dhe më pas në orën 18 e 39, ka marre në telefon të pandehurën Eleni Lino.

254. Të dyve u ka konfirmuar faktin se, kishte biseduar atë ditë drejtpërdrejt me mikun “*Une fola me nje fjal direkt me mikunmos ta zem emrin*”. Biseda vazhdon: “**...Petraqi:** *ai nuk pranon as me toka as me gje i do te thata ne rregull.... dhe e vetmja gje qe na beri ai ne eshte qe nga 60 e coi ne 50 dakorte, kte po ta them ty do marr dhe lencen do tja them dhe asaj tani sepse*

per ne eshte gje e madhe qe e uli 10". Të dyve u thotë se të nesërmen duhet të vinin në Fier dhe të takoheshin të tre për të biseduar ne lidhje me pagesen (bisedat e plota te zhvilluara mes te pandehurve si dhe faktet qe vertetohen nga keto biseda jepen ne menyre te detajuar ne piken 130, 132, 133, 182, 183 te ketij vendimi).

255. U provua nga fotografitë e raportit të shërbimit "Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016", te marra me cilësinë e provës nga kjo gjykate se ne datën 11 Korrik 2016 të pandehurit Ilia Çabiri, Eleni Lino dhe Petraq Dashi janë takuar në Fier dhe kane biseduar me njeri tjetrin. I pandehuri Petraq Dashi pasi ka siguruar shumën prej 50 mijë euro cash, siç rezulton dhe nga procesverbali "Per përgjimin e telekomunikimeve" te datës 11.07.2016 (faqja 164 e dosjes gjyqësore, volumi 2), ka marre në telefon të pandehurin Odhise Andrea, ku këtij te fundit i ka kërkuar te takohen. Nga biseda e zhvilluar mes tyre, provohen fakti se: (i) se te dy te pandehurit kërkojnë qe te takohen sa me shpejt duke thënë: "është vapë e madhe dhe ikin njerëzit"; (ii) takimi do realizohet atë mbasdite ne Tirane.

Odhisea : *E Petraq ?*

Petraqi : *Odise ç'a po bën ti vlla, mir je ?*

Odhisea : *Mir, ca bëre ti ?*

Petraqi : *Hajt, dëgjo.*

Odhisea : *He ?*

Petraqi : *Si e ke më mir, takohemi sonte në dark në Tiran, apo nesër ? Si është, si është, si e ke më mirë ?*

Odhisea : *Po sa më shpejt, aq më mir, vap e madhe, ikin njerëzit.*

Petraqi : *E, në rregull at'here, un po ashtu pastaj, për mbasdite sot.*

Odhisea : *Flasim mbasdite, 6 - 7 mbasdite që të mir e?*

256. U provua nga fotografitë e raportit të shërbimit "Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016" te marra me cilësinë e provës nga kjo gjykate se po atë mbasdite dy te pandehurit janë takuar ne Tirane. Në orën 19 e 15, automjeti "Volksvagen Cady" me targë AA 493 OB është parkuar në rrugën "Margarita Tutulani", në afërsi të një lokali të quajtur "Harli Cafe". Te dy te pandehurit Petraq Dashi dhe Odhise Andrea kane zbritur nga automjeti dhe i pandehuri Petraq Dashi mban në dorë qesen e plasmasit e cila siç rezulton edhe nga fotografitë është po ajo e marre ne agjencinë Troka, me ngjyre te bardhe dhe me stemën e agjencisë e cila kishte brenda shumën prej 50.000 euro. Fakti qe brenda ne qese ishte shuma e mësipërme konfirmohet dhe nga vete deklaratimet e te pandehurve Petraq Dashi dhe Odhise Andrea, te dhëna ne seancat gjyqësore te datave 12.01.2017 dhe 27.02.2017. Vërtetohet po me raportin e shërbimit te asaj dite se, pasi janë ndare te pandehurit, i pandehuri Odhise Andrea se bashku me qesen e plasmasit ku ishte shuma prej 50 mijë euro është futur ne shtëpinë e tij.

257. Ne datën 12 korrik 2016, paradite, Kolegji Civil në Gjykatën e Lartë i përbërë nga gjyqtarët Artan Broci, Admir Thanza dhe e pandehura Majlinda Andrea, ka vendosur në dhomë këshillimi të mos pranohej rekursi për çështjen civile për të cilën interesoheshin të pandehurit Petraq Dashi, Ilia Çabiri dhe Eleni Lino.

258. Rezulton nga procesverbali "Per përgjimin e telekomunikimeve" te datës 14 korrik 2016, qe te pandehurit Majlinda dhe Odhise Andrea u vene ne dijeni te faktit qe kishte nje dosje ne prokurori dhe qe kjo kishte dale nga nje çështje tjetër. Sa me sipër, u konfirmua dhe nga deklaratimet e te pandehurit Odhise Andrea ne seancën gjyqësore te datës 12.01.2017, ne te cilën ai ka deklaruar se: "Jam vënë në dijeni nga një koleg për implikimin tim në këtë histori. Kam informuar bashkëshorten time për sa më sipër, por nuk e kisha informuar se për çfarë kisha folur me P.Dashin, megjithëse ajo e dinte që më duheshin një sasi lekësh per biznesin tim. Nuk i thashë

për sasinë e lekëve, por e pyeta nëse e dinte me çfarë merrej P.Dashi dhe përgjigja e saj ishte “nuk e di”. Pas këtij momenti i pandehuri Odhise Andrea nuk i është përgjigjur me ne telefon te pandehurit Petraq Dashi, me gjithë insistimin dhe këmbënguljen e këtij te fundit, për ta marrë ne telefon dy dite rresht (sa me sipër këto fakte konfirmohen nga Akti i Ekspertimit nr. 9365, datë 08.09.2016, si dhe procesverbali datë 27.09.2016 i oficerit të policisë gjyqësore, mbi këqytjen e të dhënave të përfituara nga akti ekspertimit të telefonave celularë).

259. Ne datën 14 Korrik 2016 mbasdite, i pandehuri Odhise Andrea, së bashku me të birin janë nisur për ne Fier, për të takuar të pandehurin Petraq Dashi. Rrugës, në orën 16: 47 p.m., e pandehura Majlinda Andrea nga numri 692027672 që kishte në përdorim, ka marrë të birin, në numrin e telefonit 697087878 dhe i ka kërkuar që të nxjerrë në telefon të pandehurin Odhise Andrea. Sa me sipër konfirmohet nga procesverbali “Për përgjimin e telekomunikimeve” date 15.07.2016 (referojuni faqes 93-94 te dosjes gjyqësore, vol. 2). Nga biseda e zhvilluar ndërmjet dy të pandehurve, konfirmohet fakti që: (i) te pandehurit tashme e dine që ka një çështje në drejtim të tyre; (ii) dhe se duhet të bëjnë veprimet me kujdes se ai mund të jete dakort.

Majlinda : Alo.

Kristi : Alo ?

Majlinda: Jepja i çik babit.

Kristi : Po. (flet Odisea) E me.

Majlinda : Nigjo edhe Dhori më kishte shkruar që, më kishte konfirmu nëpërmjet atij që e ka, që e kishte.

Odhisea : Po, po.

Majlinda : Që dosja është atje.

Odhisea : Po

Majlinda : Dhe që nuk ka, nuk bëhet fjal për kallzim.

Odhisea : Dhe njëher.

Majlinda : Nuk bëhet fjal për kallzim.

Odhisea : Ehe.

Majlinda : Por ka dal rastësisht nga një çështje tjetër.

Odhisea : Okej

Majlinda : Kshu që bëji ato veprimet sot me shumë kujdes.

Odhisea : Mir.

Majlinda : Se ai mund t'jet, dakort?

Odhisea : Okej.

Majlinda : Hajde pra, cao.

Odhisea : Cao.

260. Siç vërtetohet nga procesverbali “Për përgjimin e telekomunikimeve” te datës 14.07.2016 (referojuni faqes 95-96 te dosjes gjyqësore, vol. 2), edhe Petraq Dashi ishte nisur për ne Tiranë për të takuar të pandehurin Odhise. Në orën 17 : 38 p.m., i pandehuri Petraq Dashi ka folur në telefon nëpërmjet nr. 693520130 me të pandehurin Odhise Andrea, i cili i thotë që ishte nisur për tek ai dhe ishte në Fier.

Odhisea : Odesea jam, çka bëre?

...Petraqi: Degjo, unë jam nisur për Tiran, burrash jam ktu në atë, isha dhe jam drejt Tiranës kshu që mirupafshim n'Tiran.

Odhisea : Un jam n'Fier.

Petraqi : A në Fier je ti, at'here po kthehem un.

...**Petraqi** : *Për dhjet min shum, shum, njëzet minuta jam aty un.*

Odhisea : *E mir...*

261. Njëzet minuta më vonë, në orën 18 e 58 p.m., të datës 14 Korrik 2016, i pandehuri Petraq Dashi ka folur përsëri me te pandehurin Odhise Andrea në numrin 693520130 (vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 14.07.2016 (referojuni faqes 97 te dosjes gjyqësore, vol 2). Nga analiza qe u behet te dyja bisedave, konfirmohet fakti se te dy po nxitonin per te takuar njeri tjetrin. Sapo janë takuar, ata kane shkuar tek zyra e noterit Durim Lekdushi, e cila ndodhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kane nënshkruar nje akt noterial te datës 14.07.2016, me nr. 1840 rep. nr. 1045 kol. Sipas këtij akti, rezulton qe i pandehuri Petraq Dashi i kishte dhënë të pandehurit Odhise Andrea, në Tiranë ne datën 11.07.2017, ora 19 e 25 nje shume prej 50.000 Eure, shume e cila ishte dhëne borxh për arsye biznesi, ne kushtet kur ata kane kanë lidhje familjare me njëri tjetrin. Sipas këtij akti, borxhi do të kthehet nga i pandehuri Odhise Andrea ne datën 31.12.2016. Të njëjtin deklarim bën dhe i pandehuri Odhise Andrea. Ne datën 15 Korrik 2016, ora 16 e 45 p.m., të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë me automjetin me targë AA 307 LT, nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar “Porti i Durrësit”, me linjën e tragetit “Bari – Durrës – Bari”, SNAV LAZIO, me drejtim Italinë.

262. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, ne analize te gjitha provave te paraqitura nga organi i akuzës dhe te analizuara me lart ne këtë vendim, vlerëson se i pandehuri Odhise Andrea ka konsumuar veprën penale per te cilën ai akuzohet.

263. Mbrojtja e te pandehurit Odhise Andrea, ne konkluzionet përfundimtare, pretendoi përsëri se ankimi i paraqitur prej tij ne datën 22.10.2016 kundër vendimit nr. 386, date 04.06.2016 “Per vlefësim përgjimi dhe lejim përkatës per nr telefonik celular 0697612754” dhëne nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, si dhe teresise se akteve përgjuese qe pasojnë këtë vendim, nuk ishte jashtë afatit dhe ai nuk kishte shkelur asnjë afat procedural. Ne lidhje me këtë pretendim, Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se i ka dhëne përgjigje me vendimin e ndërmjetëm dhe te arsyetuar ne seancën gjyqësore te datës 19.12.2016, argumente te cilat qëndrojnë dhe s’ka nevojë qe te përsëriten edhe ne këtë vendim. (shiko procesverbalin e seancës gjyqësore te datës 19.12.2016 si dhe referojuni pikës 82 dhe 82/1 të këtij vendimi).

264. I pandehuri Odhisea Andrea nuk e pranon akuzën. Mbrojtja e këtij te pandehuri ne konkluzionet përfundimtare, kërkoi nga ana e këtij trupi gjykues paperdorshmerine e provave dhe konkretisht te transkripteve dhe procesverbaleve te analizuara me lart ne këtë vendim, te përfituara si pasoje e përgjimeve te telekomunikimeve qe rridhnin nga marrja e vendimit nr. 386, date 03.06.2016 te Gjykates se Shkalles se Pare te Krimeve te Renda dhe per rrjedhoje, edhe te gjitha transkriptet e përfituara si pasoje e përgjimeve te telekomunikimeve qe rridhnin nga vendimet me nr. 465, datë 07.07.2016, me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Petraq Dashi; nga vendimi nr. 468, datë 09.07.2016 me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Odhise Andrea. Argumentet e përdorur nga kjo mbrojtje per paperdorshmerine, janë te njëjta me te gjitha argumentet qe kanë ngritur edhe te gjithë avokatet e tjerë dhe te analizuara me lart ne këtë vendim. Pra, Gjykata e Shkalles se Pare te Krimeve te Renda ne vendimin e saj 386, date 03.06.2016 dhe ne vendimet ne vijim, nuk kishte respektuar kërkesat e parashikuar nga neni 221/a, 222/a te K.Pr.P dhe se kjo gjykate ne vendimin e saj, i referohet përgjimit parandalues. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte vlerëson se, pikerisht këtij pretendimi, ne mënyre te detajuar i është dhëne përgjigje me lart ne këtë vendim nga pika 149-178 (pa qene nevoja te përsëriten), argumenta te cilat kane vlere te plote ligjore dhe ne rastin konkret.

265. U provua gjate gjykimit se, i pandehuri Odhise Andrea nuk e pranon akuzën, duke i bere nje interpretim krejt te ndyhem provave te sjella nga organi i akuzës dhe te marra ne shqyrtim nga ky trup gjykues. Ai pretendon se shuma e mësipërme është marre borxh nga i pandehuri Petraq Dashi, per shkak te biznesit qe ai po zhvillonte dhe te lidhjes familjare qe ata kishin me njeri tjetrin. Per këtë qellim, mbrojtja e te pandehurit thirri si dëshmitar edhe administratorin e shoqërisë “Granitimport – AL” si dhe solli ne cilësinë e provës “statment” nga Bankat në Lek dhe Euro të shoqërisë “Granitimport – AL” sh.p.k., për vitin 2016, si dhe kopje pasaportave të të pandehurve Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea, që konfirmojnë hyrjet dhe daljet e tyre për në Greqi.

266. Por provat e paraqitura nga mbrojtja e te pandehurit nuk arritën te provonin alibinë e tij.

(i) Pretendimi se këto leke ishin dhëne borxh per arsye biznesi me qellim qe i pandehuri Odhise këto leke ti kontribuonte ne shoqëri per blerjen e makinerive mbeti thjesht ne kuadrin e deklarimeve te tij dhe te administratorit te shoqërisë “Marmor Production” sh.p.k. Nga ana e këtij te fundit nuk u soll asnjë prove shkresore ku te vërtetonte faktin qe, kjo shume ishte derdhur ne shoqëri apo kishte shërbyer per blerjen e makinerive. Nuk u soll ne gjykim asnjë akt provues nga shoqëria qe kishte vendosur te rriste kapitalin, kishte vendosur te lente makineri dhe se sa ishte kontributi i secilit ortak ne këtë rritje kapitali.

(ii) Nga vlerësimi qe ju be provave shkresore te paraqitura nga mbrojtja e këtij te pandehuri, dokumentacionit të shoqërisë “Marmor Production” sh.p.k., i depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezulton se kjo shoqëri është regjistruar me datën 27.11.2015, me administrator shtetasin Ervin Stefa dhe ortak shtetasit Kristi Andrea 20%, Ervin Stefa 20 %, Dhimitër Kapaj 40 % dhe Henri Aleksis 20 %. Vlera e kapitalit të shoqërisë është 100 mijë lek. I pandehuri Odhise Andrea nuk rezulton në asnjë moment me ndonjë funksion në këtë shoqëri. Rezulton qe ne datën 26.02.2016, është marrë vendim nga asambleja e ortakëve të shoqërisë “Marmor Production” sh.p.k., ku sipas tij, ortaku Kristi Andrea ka humbur cilësinë e zotëruesit aktiv të aksioneve dhe ja ka kaluar të drejtën e administrimit të tyre, shtetasit Silvi Duka. Me datën 26.02.2016 është lidhur një Akt Marrëveshje ndërmjet shtetasve Kristi Andrea dhe Silvi Duka, nga ku rezulton se shtetasi Kristi Andrea humb cilësinë e zotëruesit aktiv të aksioneve dhe ja kalon të drejtën e administrimit të tyre shtetasit Silvi Duka, ne respektim te ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ne kushtet kur nena e tij, e pandehura Majlinda Andrea, e ka të ndaluar të ushtrojë aktivitetet biznesi, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005.

(iii) Ne këtë kuadër, nuk u paraqit ndonjë prove shkresore me anën e te cilit, shtetasi Kristi Andrea ose personi i besuar te kenë marre ndonjë vendim per blerje makinerish, te kenë marre ndonjë vendim per rritje te kapitalit apo kontribut te ortakut ne shoqëri. Nuk ka asnjë prove qe këta dy persona te kenë derdhur ne shoqëri apo ne banke, shumën e mësipërme prej 50,000 euro.

(iv) Dokumentacioni i bankës i marre per shoqërinë “Granitimport – AL” sh.p.k., gjatë vitit 2016 (lëvizjet e parave dhe transaksionet bankare qe ajo ka kryer), nuk provojnë faktin e pretenduar ne këtë gjykim nga i pandehuri Odhise Andrea se, shuma ne masën prej 50,000 euro i ishte marre hua te pandehurit Petraq Dashi, persa kohë ne llogarinë bankare te kësaj shoqërie nuk është derdhur asnjë shume e tille.

(v) Fakti qe akti noterial (duke qene se shuma ka qene e konsiderueshme), nuk është nënshkruar ditën e dhënies se te hollave, por pasi te pandehurit Majlinda dhe Odhise Andrea janë vene ne dijeni te ekzistencës se dosjes ne organin e akuzës; si dhe fakti qe përmbajtja e këtij akti nuk përputhet me provat e sjella nga mbrojtja, krijon bindjen tek ky trup gjykues se ai nuk pasqyron realitetin.

267. E kundërta ndodh me provat e akuzës, te cilat janë konkrete, ne koherence me njëra tjetrën dhe ku te gjitha bisedat dhe veprimet e te pandehurve kane arritur ne nje pasoje konkrete. Te gjitha veprimet dhe bisedat e regjistruara dhe te kryera nga te pandehurit deri para datës 14.07.2016, tregojnë qëllimin e vërtete te tyre , konsumimin e anës objektive dhe subjektive te veprës penale nga ky i pandehur dhe nuk provojnë atë qe thotë mbrojtja e te pandehurit Odhise Andrea.

268. Pa përsëritur sa është thënë me lart ne këtë vendim, është i pandehuri Petraq ai i cili është duke ndjekur këtë çështje me njerëzit e tij (përmend dhe gocën e xhaxhait), duke u përpjekur qe çështjen ta mbyllte ne korrik. Ai kishte dijeni per ecurinë e dosjes dhe muhabetet i kishte te bërë ç'shkoqura, t'pjekura, t'sakta. U vërtetua ne proces se, ne datën 7 Korrik 2016 ora 12.43 minuta p.m., i pandehuri Petraq Dashi është takuar në Rrogozhinë me të pandehurin Odhise Andrea, ku nga bisedat qe rezultojnë me vone mes te pandehurve, krijohet bindja e plote se ata janë takuar dhe kane biseduar per shpërblimin qe do te jepej ne këmbim te vendimit ne favor te pronareve. Sinkronizimi i veprimeve dhe bisedave telefonike te njespashnjeshme, le te kuptosh qe nuk behet fjale per leke te dhëna per biznes, persa kohe menjehere pas takimit me Odhisene, i pandehuri Petraq bisedon me te pandehurit Ilia dhe Eleni ku te dyve u thote qe duhet te takohen se, çështja eshte ne Gjykatën e Larte. Ne bisede, ai lë të kuptohet se ka marrë vesh se sa duhet paguar, por i thotë se këto muhabetet nuk bëhen në telefon. Gjate gjykimit, u vërtetua se i pandehuri Petraq ka dijeni per te gjitha lëvizjet e Odhise dhe Majlinda Andreas. Është Petraqi ai qe i konfirmon Ilias dhe Elenit se, shuma qe duhet te paguhej ishte 50.000 euro (njësoj kjo me shumën e pretenduar te dhëne borxh).

269. Janë te vërtetuara faktet qe te tre kane shkuar ne Fier per te bere nje akt noterial, gjë te cilën nuk e kane realizuar dot. Dy te pandehurit e tjerë Eleni dhe Ilia duhet te deklaronin se i kishin borxh Petraqit shumën prej 17.000 euro. Është i vërtetuar fakti qe, ky i pandehur mori nga agjencia e këmbimit valutor “Troka” shumën prej 50.000 euro ne cash dhe i kaloi kësaj shoqërie shumën prej 6,850,000.00 ne leke. Menjëherë i pandehuri Petraq, po atë dite, i ka dhëne shumën e mësipërme te pandehurit Odhise Andrea ne Tirane. Pra janë veprimet aktive (deri ne marrjen e te hollave) te këtij te pandehuri, te kryera me dashje, te cilat vërtetojnë konsumimin e veprës penale.

270. Ne datën 12 korrik 2016, paradite, Kolegji Civil në Gjykatën e Lartë, i përbërë nga gjyqtarët Artan Broci, Admir Thanza dhe e pandehura Majlinda Andrea, ka vendosur në dhomë këshillimi të mos pranohej rekursi për çështjen civile për të cilën interesoheshin të pandehurit Petraq Dashi, Ilia Çabiri dhe Eleni Lino. Zhvillimi i ngjarjeve në vijim, biseda telefonike ndërmjet të pandehurve Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea e datës 14 Korrik, fakti qe i pandehuri Odhise nuk i përgjigjej me te pandehurit Petraq dhe nxitimi per te nënshkruar aktin e mësipërm noterial, krijojnë dhe njëherë bindjen se vepra penale është kryer nga ky i pandehur. Ai ka konsumuar elementet e kësaj vepre me veprime konkrete aktive, me dashje dhe ka dëshiruar ardhjen e pasojës.

271. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, bazuar ne gjithë sa ka pasqyruar me larte ne këtë vendim, vlerëson se të pandehurit Ilia Çabiri, Eleni Lino, Petraq Dashi dhe Odhise Andrea kane konsumuar veprën penale te mësipërme ne bashkëpunim. Referuar te drejtës sonë penale *“Bashkëpunimi quhet kryerja e veprës penale nga dy ose me shume persona me marveshje ndermjet tyre .*

272. Nga te gjitha provat e paraqitura ne këtë gjykim dhe te pranuar nga gjykata, te shpjeguara ne mënyre analitike ne këtë vendim, del qarte pjesëmarrja aktive e te pandehurve te mësipërm ne kryerjen e kësaj vepre penale. Te gjitha veprimet e tyre janë te kundraligjshme. Te gjithë kane vepruar dhe kane dashur te kryejnë veprime korruptive per te marre nje vendim ne favor te tyre. Sa me sipër, rezulton qarte jo vetëm nga bisedat telefonike ku secili prej informon

tjetrin se ç'ka bere dhe se ç' duhet te beje ne te ardhmen, por ata kane kryer edhe takime konkrete mes tyre per arritjen e qëllimit (takimet e tre te pandehurve ne Gjirokastër, Fier, etj) si dhe takimet e te pandehurve Petraq Dashi dhe Odhise Andrea ne Rrogozhine, Tirane dhe Fier). Po te analizosh te gjitha veprimet e kryera nga secili bashkëpunëtor, del qarte qe dhe pse s'ka nje lloj ndarje rolesh ne kuptimin klasik mes te pandehurve, ka ndarje punësh mes tyre per realizimin e qëllimit te përbashkët, ku i pandehuri Petraq kishte detyre qe te bisedonte me njerëzit e tij per arritjen e qëllimit. Te pandehurit Ilia dhe Eleni kishin si detyre qe te siguronin nje pjese te shumës nga bashkëpronaret e tjerë (takimet e Ilias me bashkëpronaret), si dhe i pandehuri Odhise kishte marre persiper përfundimin e çështjes ne Gjykate te Larte, kundrejt shpërblimit prej 50,000 euro.

273. Nga pikëpamja e anës subjektive, del qarte qe te gjithë te pandehurit kane vepruar me faj dhe me dashje. Te gjithë janë dakorte qe te jepet shpërblim per marrjen e vendimit civil per përcaktimin e kufijve te pronës prej 40 Ha, e ndodhur ne Ksamil, Sarande, ne favor te trashëgimtareve ligjore te subjektit te pretenduar te shpronësuar Spiro Mihal Gjokes. Ilia dhe Eleni jane dakord per pagimin e shumes prej 50,000 euro, edhe pse nuk kane mundesi financiare per momentin, duke pranuar qe keto leke te jepen nga i pandehuri Petraq apo edhe te trete, e me vonë, kur çështja e prones te kete përfunduar me njohjen dhe kthimin e saj subjekteve te interesuar, ta kompensojnë kete shume me toke ne natyre. Ata kane punuar qe edhe bashkëpronaret e tjere te kontribojne ne natyre. I pandehuri Odhise ka marre shumën prej 50.000 euro, per te ndërhyre, ne marrjen e nje vendimi ne favor te te pandehurve te tjerë etj. Nga te gjitha bisedat dhe veprimet konkrete, del qarte vullneti i përbashkët i tyre per ti kryer këto veprime. Te gjitha veprimet e kryera me dashje janë ne unitet me njëra tjetrën. Nga këto veprime dhe biseda, del qarte marrëveshja ndërmjet palëve per arritjen e këtij qëllimi dhe secili prej te pandehurve është ne dijeni te veprimeve qe kryen tjetri, duke i miratuar ato. Per tu quajtur e kryer vepra penale, nuk ka rendësi se si është marrëveshja, pra ne çfarë forme shfaqet ajo (me shkrim me goje apo me ndonjë forme tjetër). E rëndësishme është dhënia e pëlqimit per kryerjen e veprës penale.

274. Ky Kolegj, vlerëson te theksoje se per te ekzistuar elementi i bashkëpunimit nuk ka shume rendësi njohja mes te gjithë te pandehurve. Ne këtë kuptim, nuk ka shume rendësi nëse Eleni e njihje apo jo te pandehurin Odhise. E rëndësishme është qe te gjitha veprimet e kryera nga te katërt te pandehurit, janë ne sinkron me njëra tjetrën, janë ne funksion te njëjtit qellim qe kane subjektet e saj, janë te miratuara prej tyre dhe ekziston nje lidhje shkakësore mes veprimeve te tyre dhe pasojës se ardhur, te cilat kane çuar ne konsumimin e veprës penale per te cilën akuzohen. Përsa më sipër provohet plotësisht se të pandehurit Eleni Lino, Ilia Çabiri, Odhise Andrea dhe Petraq Dashi, në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë kryer veprën penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319 e 25 i Kodit Penal, nëpërmjet dhënies se shumës prej 50 mijë euro, me qëllim përfitimin e nje vendimi ne favor te tyre.

275. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, vlerëson se e pandehura **Majlinda Andrea** ka konsumuar elementët e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319/ç të Kodit Penal. Kjo dispozite thotë shprehimisht se: “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me detyrën e funksionin e tij...”. Ne momentin e shqyrtimit te kësaj çështje ne Gjykatën e Larte, e pandehura Majlinda Andrea ka qene duke ushtruar detyrën e anëtares se Gjykatës se Larte, emëruar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5795, datë 08.07.2008. Objekti i kësaj vepre penale, janë “mardheniet juridike te

vendosura per te siguruar nje veprimtari te rregullt e korrekte te organeve gjyqësore, te prokurorisë si dhe nga ana e funksionareve te tjerë te drejtësisë, si dhe interesat e ligjshme te shtetasve te mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale”.

276. Nga ana objektive, vepra penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*”, kryhet me ane te veprime direkte ose indirekte që shprehen në kërkimin, ose marrjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çfarëdo përfitimi të parregullt ose një premtimi të tillë, ose duke pranuar një premtim ose ofertë që vjen nga përfitim i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarët e tjerë të organeve të drejtësisë, e lidhur kjo me kryerjen ose moskryerjen e një veprimi që lidhet me detyrën a funksionin e tyre. Kjo vepër konsiderohet e kryer, mjafton që të jetë realizuar një nga format: kërkimi, marrja, e një përfitimi të parregullt, pranimi i një premtimi ose oferte për një përfitim të parregullt, nga një nga funksionarët si: gjyqtari, prokurori ose funksionari i organeve të drejtësisë.

277. Subjekt te kësaj vepre janë gjyqtaret, prokuroret si dhe funksionaret e tjerë te organeve te drejtësisë. Pra, janë subjektet e posaçme te përmendur me lart ne këtë dispozite, te cilët ne ushtrim te funksionit qe ata kryejnë, per te kryer apo mos kryer nje veprim, kërkojnë ose marrin drejtpërdrejt ose tërthorazi çdo lloj përfitimi të parregullt ose një premtim, për vete ose për persona të tjerë, ose pranojnë nje oferte ne shkëmbim te nje vendimi apo akti tjetër ne favor te personave qe e ofrojne ate ç’ka do perfitohet. Nga ana subjektive kjo vepër kryhet me dashje dhe me qëllimi përfitimi duke kryer ose mos kryer nje veprim konkret, qe ka lidhje me ushtrimin e detyrës se subjektit te posaçëm.

278. Ne gjykim u vërtetua lidhja qe kishte i pandehuri Petraq me te pandehurën Majlinda (janë kushërinj te dyte). Nga gjithë analiza qe ju be provave ne këtë gjykim, u vërtetua se i pandehuri Petraq Dashi ka dashur te realizoje qëllimin qe ai kishte bashke me te pandehurit e tjerë, duke përdorur lidhjen qe ai kishte me “*njerëzit e tij*”, si dhe me “*gocën e xhaxhait*”, duke aluduar per te pandehurën Majlinda Andrea (vajzën e xhaxhait). Sa me sipër, vërtetohet me procesverbalin “*Per përgjimin e telekomunikimeve*” te datës 24.6.2016 (fq 125 e dosjes gjyqësore, vol 2), nga ku ka rezultuar se ne datën 24 Qershor 2016, i pandehuri Petraq Dashi ka bere nje bisede me te pandehurin Ilia Çabiri, ku nder te tjera I thotë ...

Petraqi: *Hiç asgjë fare, as nuk më ka marrë as ashu... nuk e di si e qysh e tek do vijë. Nuk po e marr vesh fare, më tha më prit, më prit, po të marr vetë në telefon e kaq.*

Ilia: *Mos është e nevojshme të vete unë një herë lart vetë...?*

Petraqi: *Po jo ore vlla se e bezdis, unë merrem me njerëzit e mi atje, thashë një mendje me gocën e xhaxhait, ti veja të shpija, por më duket si. Nqs të ka thënë kshu tha është kot tha...*

279. Është vërtetuar ne gjykim se, çështja civile me objekt “*Përcaktimi i kufijve për sipërfaqen 40 ha e ndodhur në Ksamil*”, ishte regjistruar ne Gjykatën e Lartë qe ne date 21.11.2014, dhe qe do te shqyrtohej nga Kolegji Civil me relator A. Thanza, ne përbërje te cilit do te ishte dhe e pandehura Majlinda. Gjate gjykimit, rezultoi e provuar sipas procesverbalit “*Per përgjimin e telekomunikimeve*” te datës 07.06.2016 (fq 126 e dosjes vol 2), se ne datën 6 Korrik 2016, i pandehuri Ilia Çabiri ka folur ne telefon me te pandehurin Petraq Dashi, ku ky i fundit, i ka konfirmuar se po vazhdonte veprimet e tij per zgjidhjen e çështjes dhe se: “*i kishte dërguar fjalë atij mikut me të atin*”, duke lënë te nënkuptohet qe ka takuar babain e te pandehurës per shkak te lidhjes se gjakut qe ata kishin.

Petraqi : *E mo Ylli ?*

Petraqi : *Ati mikut i çova fjalë me të jatin me një fjalë.*

Ilia : *Po ?*

Petraqi : Edhe tha është akoma në ashu, tha po e shikojmë, tha mos ki merak. Kjo ishte përgjigja.

Ilia : Mos ki merak ? Kaq ?

280. Po kështu, informacioni qe jepte ne mënyre te vazhdueshme i pandehuri Petraq Dashi tek te pandehurit e tjerë, qofte per ecurinë e çështjes dhe qofte edhe per lëvizjen e çiftit Andrea, tregojnë qarte qe ai ishte ne kontakt me ta. Informacionet per ecurinë e dosjes mund te siguroheshin vetëm nga njerëzit, te cilët per shkak te funksionit qe ata kryenin mund ta siguronin atë. I pandehuri Petraq Dashi i thotë te pandehurit Ilia se, i kane thënë qe: “*çështja është në shqyrtim akoma, ne po e shikojmë, po mos ki merak*”, si dhe i konfirmon se muhabetet “*janë bërë t’shkoqura, t’pjekura, t’sakta*”. Siç u vertetua nga procesverbali “Per pergjimin e telekomunikimeve” te dates 07.07.2016 (referojuni fq. 133 te dosjes gjyqesore, vol. 2), ne datën 7 Korrik 2016, në orën 12.43 minuta p.m., i pandehuri Petraq Dashi eshte takuar me të pandehurin Odhise Andrea ne Rrogozhine dhe menjëherë pasi është ndare prej tij, ka marre ne telefon të pandehurit Ilia Çabiri dhe Eleni Lino, te cileve, siç është përshkruar dhe ne transkriptet e bisedave te përshkruara ne pikat 248 dhe 249 te këtij vendimi, u thotë qe duhet te takohen se çështja është ne Gjykatën e Larte.

281. Pyetjes se Ilia Çabirit se sa është “*kosto*”, i pandehuri Petraq i përgjigjet se këto muhabetete s’bëhen ne telefon, por duhet te takohen nga afër. Ky takim është zhvilluar ne Gjyrokastër ne datën 8 Korrik 2016 mes tre te pandehurve, Petraq, Ilia dhe Eleni siç eshte pasqyruar dhe ne pikat 189-190 te ketij vendimi. Pas këtij takimi, te tre këta te pandehur janë përpjekur me veprime aktive dhe me bashkëpronaret e tjerë per te siguruar shumën qe u kërkohej. Ndërkohë, ne ditët ne vijim, referuar bisedave te zhvilluara mes te pandehurve Petraq dhe Ilia, i pandehuri Petraq ngulte këmbë qe te kishin nje përgjigje sa me pare “*pasi duhet tu kthente përgjigje njerëzve*”.

282. Me datën 8 Korrik 2016, ora 17 e 25, të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea me automjetin me targa AA307LT, dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë për në Greqi, nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Bota, Sarandë. Ndërkohë kishin rezervuar dhe bileta trageti për të udhëtuar për Itali me datën 15 Korrik 2016.

283. Gjate gjykimit, rezultoi e provuar nga transkriptet e bisedës se zhvilluar ne datën 9 Korrik 2016 (fq 154-156 te dosjes gjyqësore, vol 2), mes te pandehurve Ilia Çabiri dhe Petraq Dashi, se ky i fundit ishte në dijeni të lëvizjeve të të pandehurve Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea, sepse deklaroi në bisedë “*se ata kanë ikur diku, por nuk kanë ikur në Itali*”. Konfirmohet nga provat e dorëzuara nga vetë të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea se një ditë më parë ata kishin rezervuar biletat e tragetit për të ikur në Itali me datën 15 Korrik 2016.

Petraqi : *Ja the troç ti atë punën e atyre hektarëve vlla ?*

Ilia : *Po, po, po, po re.*

Petraqi : *Që të dalim e ti bëjmë muhabetet*

Ilia : *Po re, Po re.*

Petraqi : *Merr përgjigje nga ata se unë do nesër, po qe se ata, se më than një llaf, sikur s’kan ikur n’Itali, nuk e di ku kan vajt. Un do interesohem sonte, po ashtu nesër vete i takoj për të bërë ato muhabetet, po ma nda këtë njëher mua ti, që t’jem me këmbë në tok un.*

Ilia : *Ore, do të jap unë haber në darkë, të thash mo.*

284. Me datën 10 Korrik 2016, të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea janë kthyer nga Greqia dhe futen në territorin e Republikës së Shqipërisë në orën 15 e 16 minuta, nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Bota, Sarandë. Nga procesverbali “Per pergjimin e telekomunikimeve” te datës 10.07.2016 (fq 161-162 te dosjes vol 2), ka rezultuar se ne datën 10 Korrik 2016, në orën 18 e 35, i pandehuri Petraq Dashi ka marre në telefon të pandehurin Ilia

Çabiri dhe më pas, në orën 18 e 39, ka marre ne në telefon të pandehurën Eleni Lino. Nga biseda e mësipërme vërtetohet fakti se: (i) ai kishte biseduar me ata miqte; (ii) Bashkëbiseduesi i kishte thënë se: “*ai nuk pranonte propozimin që të merrte si shpërblim ndonjë sipërfaqe tokë për dhënien e vendimit gjyqësor, por donte para të thata*”; (iii) ata kishin rënë dakort që ta zbrisnin shumën që kërkonin nga 60 mijë euro në 50 mijë euro. Sipas tij, kjo ishte fitore e madhe dhe ndërkohë u kërkon te dyve te takohen ne Fier për të zgjidhur punën e pagesës.

Petraqi : *Une fola me nje fjal direkt me mikun...*

Ilia : *Po ?*

Petraqi : *Mos ta zem emrin.*

Ilia : *Mos ze emra, jo, jo, ic, vazhdo.*

Petraqi : *Ashtu tani që sa folëm bashkë ne në mengjes, un kontaktova edhe me mesazh.*

Ilia : *Po.*

Petraqi : *Tani që nga mëngjezi deri tani që un i thash propozimet dhe më tha, Petraq, ai nuk pranon as me toka as me gjë, i do të thata. Në rregull ?*

Ilia : *Po.*

Petraqi : *Dhe e vetmja gjë që na bëri ai ne është që nga 60 e çoj 50. Dakort ? Ktë po ta them ty, do marr dhe Lenicen, do t'ja them dhe asaj tani, sepse për ne është gjë e madhe që e uli 10. 285. Sa me siper provohet dhe me procesverbalin per pergjimin e telekomunikimeve date 10.7.2016 (fq 84-91 e dosjes vol 2)*

Petraqi : *O Lenica.*

Eleni : *Urdhro.*

Petraqi : *Petraqi jam.....*

Petraqi : *Nga ato që bëm neve muabetet, me propozimet që i thash me tok, ose me kshtu, më kupton ?*

Eleni : *Po.*

Petraqi : *Ai nuk pranoj, se i do lek të thata, dakort ashtu, tani dhe i vetmi lajmi i mir, është që nga 60 e uli 50.*

Eleni : *50 ?*

Petraqi : *Më kupton ?*

Eleni : *Po.*

286. Është vërtetuar nga raporti i shërbimit “Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016”, te marra me cilësinë e provës nga kjo gjykate (fq 178-181 te dosjes gjyqësore, vol. 2), fakti qe te nesërmen ne datën 11 Korrik 2016 të pandehurit Ilia Çabiri, Eleni Lino dhe Petraq Dashi janë takuar në Fier per nënshkrimin e nje akti noterial, i cili nuk u realizua. Me vone, i pandehuri Petraq Dashi, vërtetohet qe ka siguruar shumën prej 50 mijë euro nga agjencia “Troka” ne cash dhe ka marre në telefon të pandehurin Odhise Andrea, duke e pyetur se kur është më mirë të takohen, atë natë apo të nesërmen. I pandehuri Odhise Andrea i kërkon që të takohen sa më shpejt aq më mirë, sepse është vapë e madhe dhe ikin njerëzit. Siç thamë edhe me lart, me datën 15 Korrik 2016, të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea kishin rezervuar biletat e tragetit për në Itali. Sa me sipër vërtetohen me procesverbalin “Per përgjimin e telekomunikimeve” date 11.07.2016 (fq 164 e dosjes volumi 2). Pra nga kjo bisede vërtetohen faktet qe: (i) te dy te pandehurit nxitonin dhe leket duhet te jepeshin sa me shpejt; (ii) dhe nxitimi kishte lidhje me përfundimin e çështjes

Petraqi : *Si e ke më mir, takohemi sontë në dark në Tiran, apo nesër ? Si është, si është, si e ke më mirë ?*

Odhisea : *Po sa më shpejt, aq më mir, vap e madhe, ikin njerëzit.*

Petraqi : *E, në rregull at'here, un po ashtu pastaj, për mbasdite sot.*

287. Po atë ditë mbasdite, d.m.th. ne datën 11 Korrik 2016, në orën 19 e 25, në ambientet e jashtme të lokalit “Harli Cafe”, ndodhur në Tiranë, afër shtëpisë së të pandehurit Odhise Andrea, i pandehuri Petraq Dashi i jep të pandehurit Odhise Andrea 50 mijë euro cash, të futura në një qese plasmasi. I pandehuri Odhise Andrea pasi merr shumën prej 50 mijë euro cash dhe futet direkt në shtëpinë e tij, së bashku me paratë (Ky fakt u provua nga fotografitë e raportit të shërbimit “Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer në datë 11.07.2016” te marra me cilësinë e provës nga kjo gjykate (referojuni fq 186-188 te dosjes gjyqësore, vol 2). Janë dy bisedat e bëra mes te pandehurit Petraq Dashi me te bijën dhe me Eleni Linon, përkatësisht ne datat 11 dhe dt 12 Korrik (referojuni procesverbaleve “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 11 dhe 12 Korrik te cituara edhe me larte), te cilat konfirmoje faktin: (i) qe u dha shuma prej 50.000 euro dhe (ii) qe pritej përfundimi i çështjes brenda javës “*këtë jave mbyllet e merrnin ne dore*” duke lene te nekuptohej qe behet *ffale per mb ylljen e ceshtjes gjyqesore*”.

288. Me datën 12 korrik 2016 paradite, Kolegji Civil në Gjykatën e Lartë, i përbërë nga gjyqtarët Artan Broci, Admir Thanza dhe e pandehura Majlinda Andrea, ka vendosur në dhomë këshillimi të mos pranohej rekursi për çështjen civile për të cilën interesoheshin të pandehurit Petraq Dashi, Ilia Çabiri dhe Eleni Lino.

289. Nga zhvillimi i ngjarjeve në vijim, është vërtetuar se ne date 13 Korrik 2016 të pandehurit Majlinda Andrea dhe Odhise Andrea janë vënë në dijeni të faktit që kishte një procedim penal të regjistruar nga prokuroria në lidhje me ngjarjen dhe kjo ka ndikuar qe i pandehuri Odhise mos ti përgjigjet te pandehurit Petraq atë dite ne telefon (ky i fundit e ka marre 6 here). Po ne date 14.07.2016, siç vërtetohet nga procesverbali “Per përgjimin e telekomunikimeve” te datës 14.07.2016 (fq 93 e dosjes gjyqësore, vol. 2), e pandehura Majlinda Andrea nga numri i telefonit 692027672 që ka në përdorim, ka marrë të birin, në numrin e telefonit 697087878 dhe i ka kërkuar që të nxjerrë në telefon të pandehurin Odhise Andrea. Nga biseda e zhvilluar ndërmjet dy të pandehurve konfirmohet: (i) shqetësimi që kanë për procedimin penal të filluar. E pandehura Majlinda i thotë se ka marrë vesh dhe nga një burim i dytë se ka çështje penale, se nuk është kallëzim, por ka dalë rastësisht nga një çështje tjetër; (ii) dhe e porosit te pandehurin Odhise që të bëjë me shumë kujdes ato veprimet, duke lënë te kuptohet realizimin e deklaratën noteriale per shumën e marre.

Majlinda : *Alo.*

Kristi : *Alo ?*

Majlinda: *Jepja i çik babit.*

Kristi : *Po. (flet Odisea) E me.*

Majlinda : *Nigjo edhemë kishte shkruar që, më kishte konfirmu nëpërmjet atij që e ka, që e kishte.*

Odhisea : *Po, po.*

Majlinda : *Që dosja është atje.*

Odhisea : *Po*

Majlinda : *Dhe që nuk ka, nuk bëhet fjal për kallzim.*

Odhisea : *Dhe njëher.*

Majlinda : *Nuk bëhet fjal për kallzim.*

Odhisea : *Ehe.*

Majlinda : *Por ka dal rastësisht nga një çështje tjetër.*

Odhisea : *Okej*

Majlinda : *Kshu që bëji ato veprimet sot me shum kujdes.*

Odhisea : *Mir.*

Majlinda : *Se ai mund t'jet, dakort?*

Odhisea : *Okej.*

Majlinda : *Hajde pra, cao.*

Odhisea : *Cao.*

290. Ndërkohë po ne datën 14 Korrik 2016, mbasdite, i pandehuri Petraq Dashi pasi nuk kishte arritur te komunikonte me te pandehurin Odhise per dy dite me radhe, niset për në Tiranë per ta takuar atë, kurse ky i fundit niset ne Fier per te takuar te pandehurin Petraq. Pasi bisedës qe realizohet mes tyre per vendin e takimit, i pandehuri Petraq kthehet nga rruga dhe takohen ne Fier. Pasi takohen dhe bisedojnë, dy të pandehurit shkojnë tek zyra e noterit Durim Lekdushi, dhe firmosin një Deklaratë Noteriale, nga përmbajtja e se çiles del qe shuma prej 50 mijë euro është dhëne si borxh për biznes. Gjithë kronologjia e bisedave dhe veprimeve (te cilat përputhen me atë ç'ka ata bisedojnë ne fakt me njeri tjetrin), te gjithë te pandehurve përfshire dhe bashkëshortin e te pandehurës dhe vete te pandehurën, te analizuara me lart ne këtë vendim vërtetojnë faktin se shuma e marre me sipër nuk ishte marre per qëllime biznesi, por per te përfituar nje vendim ne favor te personave te interesuar.

291. Ne këto kushte, ky trup gjykues vlerëson se e pandehura Majlinda Andrea **ka konsumuar veprën penale te "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë"**, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, nëpërmjet përfitimit të parregullt, me qëllim kryerjen e një veprimi që lidhet me detyrën e saj si anëtare e Gjykatës se Lartë. E pandehura Majlinda Andrea është subjekt i veprës penale dhe rezulton person i përgjegjshëm para ligjit.

292. E pandehura Majlinda Andrea nuk e pranoi akuzën ne drejtim te saj. Mbrojtja e te pandehurës ne konkluzionet përfundimtare kërkoi nga ana e këtij trupi gjykues paperdorshmerine e provave dhe konkretisht te transkripteve dhe procesverbaleve te analizuara me lart ne këtë vendim, te përfituara si pasoje e përgjimeve te telekomunikimeve qe rridhnin nga marja e vendimit nr. 386, date 03.06.2016 te Gjykates se Shkalles se Pare te Krimeve te Renda dhe per rrjedhoje dhe te gjitha transkriptet e përfituara si pasoje e përgjimeve te telekomunikimeve qe rridhnin nga vendimet me nr. 465, datë 07.07.2016, me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Petraq Dashi; nga vendimi nr. 468, datë 09.07.2016 me të cilin ishte vendosur në përgjim numri që disponohej nga i pandehuri Odhise Andrea. Argumentat e perdorur nga kjo mbrojtje per paperdorshmerine, jane njësoj si te gjitha pretendimet e ngritura nga avokatet e tjerë dhe te analizuara me lart ne këtë vendim, se Gjykata e Shkalles se Pare te Krimeve te Renda ne vendimin e saj 386, date 03.06.2016 dhe ne vendimet ne vijim nuk kishte respektuar kërkesat e parashikuar nga neni 221/a , 222/a te KPrP dhe se gjykata ne vendimin e saj i referohet përgjimit parandalues. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, vlerëson se pikerisht këtij pretendimi ne mënyre te detajuar i është dhëne përgjigje edhe me lart ne këtë vendim, konkretisht nga nenet 149-178, argumente te cilat kane vlere te plote ligjore dhe ne rastin konkret.

293. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte i vlerëson si te pabazuar ne ligj edhe pretendimin e mbrojtjes se te pandehurës Majlinda Andrea se procesverbali i përgjimit te telekomunikimeve te datës 14.07.2016, i bere nga Prokuroria e Përgjithshme duhet te deklarohen te papërdorshme, pasi ai është rrjedhoje e nje vendimi te marre ne kundërshtim me ligjin.

294. Mbrojtja ne konkluzionet e saj pretendoi se vendimi nr. 477, date 13.07.2016 i Gjykatës se Shkalles se Pare te Krimeve te Renda per subjektin e posaçëm, është absolutisht i pavlefshëm ne vështrim te nenit 128/1.a te K.Pr.Penale, pasi ky vendim është marre nga nje gjykate jokompetente. Kjo gjykate, ka vene ne përgjim nje subjekt te posaçëm ne kundërshtim me nenin

141/1 te Kushtetutës (dispozite kjo ne fuqi ne kohen e marrjes se vendimit) dhe nenin 75/b te K.Pr.Penale. Vendimi i mësipërm, është dhënë nga nje gjykate jo e caktuar me ligj. Si prokuroria e Shkalles se Pare per Krimet e Renda, ashtu edhe gjykata (nisur nga përmbajtja e akteve) e dinin se po vinin ne përgjim nr e tel te subjektit te posaçëm.

295. Kolegji Penal i Gjykatës se Larte, vlerëson se ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar ne ligj. Referuar te drejtës sonë penale, pavlefshmëria konsiderohet absolute vetëm kur nje gjë e tille parashikohet shprehimisht ne ligj. Ne baze te nenit 128/1.a te K.Pr.Penale (kësaj i referohet edhe mbrojtja), kemi nje akt absolutisht te pavlefshëm kur nuk respektohen dispozitat qe lidhen me: (a) kushtet per te qene gjyqtar ne nje çështje konkrete; dhe (b) numrin e gjyqtareve qe janë te domosdoshëm per formimin e kolegeve te caktuar ne këtë Kod.

296. Ne rast se do te analizojmë këtë parashikim ligjor, do te konstatojmë se sa me sipër nuk ka lidhje me atë qe pretendon mbrojtja e te pandehurës Majlinda Andrea. Kjo pasi: (a) kushtet per te qene gjyqtar nuk ka lidhje me gjykatën e caktuar me ligj, por me faktin qe gjyqtari qe gjykon çështjen duhet te plotësoje kushtet per ushtrimin e detyrës qe i është ngarkuar (psh te këtë arsimin e larte juridik, etj). Po kështu, kur flitet per numrin e gjyqtareve qe gjykon çështjen, ligjvënësi ka parasysh faktin qe çështja duhet te gjykohet me trup gjykues (nje, tre ose pese) aq sa ligji e përcakton gjykimin e çështjes konkrete (psh ne rast se ligji thotë qe çështja duhet te gjykohet me tre gjyqtare, ai nuk mund te gjykohet me nje gjyqtar).

297. Pavlefshmëria absolute e nje akti, është rasti me i rende prandaj dhe ligjvënësi ka parashikuar qe ajo është e tille vetvetiu dhe deklarohet edhe kryesisht. Organi qe e konstaton, nuk e shqyrton dhe nuk ka te drejte te beje asnjë vlerësim. Ai vetëm zgjidh pasojat e saj. Marrja e nje prove nga nje gjykate jo kompetente, nuk te çon ne pavlefshmërinë e provës. Ne nenin 87 te K.Pr.Penale thuhet se: *“Mosrespektimi i dispozitave mbi kompetencën, nuk sjell pavlefshmërinë e provave të marra. 2. Deklarimet e bëra para gjykatës që nuk ka pasur kompetencë lëndore, në qoftë se përsëriten, mund të përdoren vetëm për kundërshtim të përmbajtjes së deponimit”*. Ne analize te paragrafit te pare te kësaj dispozite, rezulton qarte qe vlera e provave te marra nga nje gjykate jokompetente, parimisht nuk te çon ne pavlefshmëri, kushdo lloj qofte moskompetenca e gjykatës qe i ka marre, mjafton qe kjo gjykate te këtë respektuar rregullat proceduriale ne marrjen e tyre. Ligjvënësi ne këtë paragraf, nuk përcakton se per çfarë kompetence Ben fjale dhe per çfarë provash flitet, duke i trajtuar ato ne përgjithësi dhe duke bere përjashtim vetëm per deklarimet. Përjashtimi per deklarimet, del qarte ne rast se do te analizojmë paragrafin e dyte te kësaj dispozite. Dhe ne këtë rast, ligjvënësi flet per kompetencën lëndore. Ai ka bere nje parashikim te tille, pasi deklarimi është nje prove qe mund te merret përsëri dhe duhet te behet para gjykatës kompetente (sidomos kur behet fjale per nje gjykate te nje niveli me te larte). Por edhe ky përjashtim nuk është pavlefshmëri absolute, duke patur parasysh parashikimet e nenit 362 dhe 370 te K.Pr.Penale.

298. Rezulton se është lejuar dhe miratuar nga gjykata përgjimi i bisedave të pandehurës Majlinda Andrea, *“si person që dyshohet qe merr apo transmeton komunikime nga i dyshuari, apo që dyshohet se merr pjesë në transaksione me të dyshuarin “, bazuar në nenin 221/3, gërmat “b” dhe “c” të Kodit të Procedurës Penale dhe jo se ajo dyshohej qe kishte kryer ndonjë vepër penale. Gjykata ka lejuar përgjimin e numrit ne përdorim te pandehurës Majlinda Andrea, bazuar ne kërkesën e Prokurorit pranë Prokurorisë se Shkalles se Pare per Krime te Renda, i cili ne kërkesën e tij ka parashtruar se: *“nisur nga dinamika e hetimeve, kronologjia e kryerjes se veprimeve nga ana e shtetasve te mesiperm, fakti se sipas pergjimeve rezulton se ceshtja gjyqesore civile konkrete do te merret ne shqyrtim brenda kësaj jave, ekzistojnë dyshime te bazuara se personi i dyshuar Odhise Andrea, mund te marre apo transmetoje komunikime nga bashkëshortja e tij e cila ka ne përdorim nr e telefonit 0692027672 ,”neni 221/3 pikat (b) dhe (c) te K.Pr.Penale lejojnë**

përgjimin e personave që dyshohen se marrin apo transmetojnë komunikime nga i dyshuari, apo që dyshohet se marrin pjesë në transaksione me të dyshuarin”.

299. Ka rezultuar se deri në momentin që gjykata ka marrë vendimin e mësipërm, emri i shtetasës Majlinda Andrea nuk ishte shënuar në regjistrin e personit që atribuohet vepra penale. Ajo është vënë në përgjim në bazë të nenit 221/3 pikat (b) dhe (c) të K.Pr.Penale. Në momentin që Prokuroria pranë Shkallës së Parë për Krime të Rënda, konstatoi se ajo mund të kishte konsumuar një veprë penale në datën 14.06.2016 vendosi: *“Shpalljen e moskompetencës lëndore për procedimin penal nr. 104, të vitit 2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë”* (referojuni fq 39-47 vol 1). Në arsyetimin e këtij vendimi, prokuroria pasi bëri një analizë të ngjarjeve dhe fakteve thotë se: *“...ekzistojnë dyshime të arsyeshme se shtetasia Odhisea Andrea dhe shtetasja Majlinda Andrea në cilësinë e gjyqtarit të gjykatës së lartë në bashkëpunim me njeri tjetrin kanë konsumuar veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtareve e prokurorëve dhe funksionareve të tjerë të organeve të drejtësisë parashikuar nga nenet 319/c dhe 25 të K.Penal. Në bazë të nenit 75/b pika 2 e K.Pr.Penale kompetenca lëndore për gjykimin e anëtarëve të gjykatës së lartë, kur ata janë në funksion në kohën e kryerjes së veprës penale i përket Gjykatës së Lartë. Si rrjedhim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk ka kompetencën lëndore për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore në lidhje me këtë procedim penal, pasi kompetenca lëndore në këtë rast i përket Prokurorisë së Përgjithshme* “

300. Mbi këtë bazë, në datën 14.07.2016 Prokuroria e Përgjithshme ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale *“korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”* të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal dhe *“Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”*, parashikuar nga nenet 319 e 25 të Kodit Penal, duke u shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emri i personit nën hetim Majlinda Andrea, si e dyshuar për kryerjen e veprës penale *“korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”* të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal (fq 23 vol 1). Edhe përgjimi i datës 14.07.2016 si dhe transkriptimi i kësaj bisede, që është marrë si prove në këtë gjykim, rezultojnë se te jete bere nga Prokuroria e Përgjithshme. Në përfundim të analizës së mësipërme, ky Kolegj vlerëson se kjo prove nuk mund të deklarohet e papërdorshme, përse kohe ajo është marrë në respektim të ligjit procedural.

301. Përveç sa me sipër, mbrojtja e të pandehurës kërkoi pafajësinë e të pandehurës me argumentin se ajo nuk e dinte shumën e marrë borxh nga i shoqi dhe se kjo shumë nuk ishte dhënë për dhënien e një vendimi në favor të pandehurës të tjerë. Mbrojtja deklaroi se kur ajo ishte vënë në dijeni të procedimit penal të regjistruar në ngarkim të pandehurit Petraq Dashi, ka marrë vesh edhe se bashkëshorti i saj i kishte marrë 50 mijë euro borxh për biznes nga ky person. Në këto kushte, ajo e ka porositur bashkëshortin që të bënte deklaratën noteriale së bashku me të pandehurin Petraq Dashi, për të sqaruar faktin se ato para ishin marrë borxh. Por veprimet dhe bisedat e kryera nga bashkëshorti i saj me të pandehurin Petraq (me të cilin kishin lidhje familjare), bisedat dhe veprimet e kryera nga ky i fundit me dy të pandehurit e tjerë Ilija dhe Eleni (te cilat janë dhënë në mënyrë kronologjike me lart) dhe që rezultojnë në koherencë të plote dhe vazhdimësi me njëra tjetrën, të pashkëputura në asnjë moment, pasoja e ardhur, shumën e dhënë (që është e njëjta me atë që Petraqi i kishte thënë Ilias dhe Elenit), si dhe veprimet e kryera me pas (pas dhënies së vendimit dhe pas vënies në dijeni të procedimit penal) nga të pandehurit Odhise dhe Majlinda, të krijojnë bindjen se kjo e fundit ishte në dijeni veprimeve që po kryente i shoqi dhe shumën e mësipërme, ishte dhënë për përfitimin e një vendimi në favor të interesuarve.

302. Fakti që e pandehura Majlinda komunikon me të pandehurin Odhise nëpërmjet telefonit të birit dhe jo direkt, si dhe fakti që i pandehuri Odhise Andrea atë dite kishte në përdorim një numër tjetër telefoni 693520130 dhe jo numrin 694083111 që kishte patur më parë, tregon se të pandehurit tashme kishin marre informacion për ekzistencën e procedimit penal dhe po tregonin kujdes në kryerjen e veprimeve. Ata tashme nuk po komunikonin me të pandehurin Petraq nga telefoni që Odhiseja kishte përdorur deri në atë moment dhe e pandehura Majlinda e porositi të shoqin “*që të bëjë me shumë kujdes ato veprimet sepse ai mund të jetë dakort*”. Sa me sipër, kjo konfirmon edhe njëherë faktin e djegësisë nga kjo e pandehur se çfarë po ndodhte, si dhe faktin që veprimet që po kryeshin në datën 14.07.2016 nuk pasqyronin realitetin.

303. Përfundimisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nga të gjitha provat e analizuarat me lart, vlerëson se e pandehura Majlinda Andrea ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën ajo akuzohet. Sa me sipër ato u provuan nga analiza që iu bë të gjitha provave dhe fakteve të kësaj ngjarjeje, të cilat çuan në përfundimin se ajo kishte djegësi për veprimet që po kryente i shoqi së bashku me të pandehurin Petraq, dhe se këto veprime ndikojnë drejtpërdrejt në detyrën që ajo po ushtronte.

304. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se në dhënien e masës së dënimit për të pandehurën Majlinda Andrea duhet të aplikojë dhe nenin 59 të K.Penal.Ky Kolegj, vlerëson aplikimin e kësaj dispozite, pasi çmon që jemi para rrethanave të posaçme të parashikuara nga kjo dispozite. Ky kolegj, vlerëson aplikimin sa me sipër për shkak të rrezikshmërisë së paketit të personit. E pandehura nuk ka qenë e dënuar më parë. Ka qenë një person e cila gëzonte reputacion dhe respekt në jetën sociale dhe në institucionin ku ajo punonte dhe ky Kolegj, krijon bindjen se gjendja dhe niveli i saj arsimor dhe kulturor, nuk e lejon atë që të kryejë një veprë tjetër penale të këtij lloji. Përveç sa me sipër, ky Kolegj, vlerëson se duhet të aplikohen kushtet e posaçme të kësaj dispozite edhe për shkak të gjendjes familjare të krijuar në familjen e të pandehurës. E pandehura ka dy fëmijë të cilët kanë nevojë për kujdesin dhe interesin e saj. Gjithashtu, ky Kolegj vlerëson se në këtë rast, dhënia e një dënimi me kusht pezullues e ka arritur qëllimin për të cilin po jepet dënimi.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi shqyrtoi dhe çmoi terezinë e provave të pranuarat dhe verifikuarat në gjykim, dhe pasi i analizoi ato në raport me ligjin procedural dhe material të zbatueshëm, bazuar në nenet 379, 380, 381 të K.Pr.Penale, si dhe nenet 319 e 25 dhe 319/ç të Kodit Penal,

V E N D O S I

1-Deklarimin fajtor të pandehurës **Majlinda Andrea** për veprën penale të “korrupsionit pasiv të gjyqtareve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe në zbatim të nenit 319 /ç të K.Penal dënimin e saj me 4 (katër) vjet burgim.

- Në zbatim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prove prej 3 (tre) vjetësh.

- Urdhërohet e dënuara Majlinda Andrea që të mbajë kontakt me shërbimin e provës në bazë të nenit 60 të K.Penal.

- Në zbatim të nenit 35/1 të K.Penal të caktohet si dënim plotësues “heqja e së drejtës për të kryer funksione publike për një afat prej 5 (pese) vjetësh.

2-Deklarimin fajtor të pandehurit **Odhise Andrea** për veprën penale të “Korrupsionit

aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë “ ne bashkëpunim dhe ne zbatim te nenit 319 e 25 te K.Penal dënimit e tij me 1 (nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim.

- Vuajtja e dënimit fillon nga data 09.01.2017.
- Vuajtja e dënimit do te kryhet ne burgun e sigurisë se zakonshme.
- Ne zbatim te nenit 35/1 te K.Penal te caktohet si dënim plotësues “heqja e se drejtës per te kryer funksione publike per nje afat prej 5 (pese) vjetësh.

3-Deklarimin fajtor te pandehurit **Petraq Dashi** per veprën penale te “Korrupsionit aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë “ ne bashkëpunim dhe ne zbatim te nenit 319 e 25 te K.P dënimit e tij me nje 1 (nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim.

- Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ndalimit 16 korrik 2016.
- Vuajtja e dënimit do te kryhet ne burgun e sigurisë se zakonshme.

4-Deklarimin fajtor te pandehurit **Ilia Cabiri** per veprën penale te “Korrupsionit aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë “ ne bashkëpunim dhe ne zbatim te nenit 319 e 25 te KP dënimit e tij me 1 (nje) vit e 6 (gjashte) muaj burgim .

- Vuajtja e dënimit fillon nga data 17.7.2016.
- Vuajtja e dënimit do te kryhet ne burgun e sigurisë se zakonshme.

5-Deklarimin fajtor te pandehures **Eleni Lino** per veprën penale te “Korrupsionit aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë” ne bashkëpunim dhe ne zbatim te nenit 319 e 25 te KP dënimit e tij me 1 (nje) vit burgim.

- Ne zbatim te nenit 59 te K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit te pjesës se mbetur te dënimit per nje afat prove prej 2 (dy) vjetësh.

6-Bazuar ne nenin 36 /b dhe c te K.Pr.Penale shuma e sekuestruar prej 50.000 euro (pesëdhjete mije euro) ne pronësi te pandehurit Odhise Andrea te ndodhura ne depozitat bankare te bankave te nivelit te dyte, konfiskohet dhe kalon ne favor te shtetit.

7-Ne baze te nenit 190/1 germa c te K.Pr.Penale provat materiale :

- Aparati celular i markes samsung me nr IMEI 35602404066020/1 ti kthehet te pandehures Eleni Lino.
- Aparati celular i markës Samsung me nr IMEI 35230104961790/1 me dy karta sim ti kthehet te pandehurit Ilia Cabiri.
- Aparati celular i markës SONY me nr. IMEI 351680063523967 ti kthehet te pandehur Petraq Dashi.
- DVDR me përmbajtje filmike te kamerave te sigurisë te zyrës se këmbimit valutor “Troka” sh.p.k Fier ti kthehet shtetasit Xhevahir Troka.

8-Shpenzimet proceduriale ne hetim si dhe ato gjyqësore tu ngarkohen solidarisht te pandehurve.

Tiranë, më 14.06.2017

MENDIM PAKICE

Si gjyqtar në pakicë, në ndryshim nga shumica e Kolegjit Penal, kam qëndrimin se ky Kolegj nuk duhet të vijonte gjykimin e çështjes dhe të dispononte për themelin e saj mbi fajësinë e të gjykuarve sipas parashikimeve të nenit 379-381 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 319 e 319/ç në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Përkundrazi, Kolegji Penal duhet vetëm të dispononte dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, si e vetmja gjykatë penale, e cila, pas hyrjes në fuqi të shtesave dhe ndryshimeve në Kushtetutë të bëra me ligjin kushtetues nr. 76/2016 dhe deri në fillimin e veprimtarisë së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, mund të gjykojë çështje penale ndaj subjekteve të posaçme të cilat ishin në kompetencën e Gjykatës së Lartë, si gjykatë penale e shkallës së parë dhe të vetme për këto subjekte të posaçme.

Çështja penale objekt gjykimi është paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Lartë në datën 14.10.2016.

Më përpara, në datën 10 Gusht 2016, ka hyrë në fuqi edhe ligji kushtetues nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

Në formulimin e mëparshëm të nenit 141 të Kushtetutës përcaktohej se:

"1. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

2. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore."

Ndërsa, me hyrjen në fuqi të ligjit kushtetues nr. 76/2016, neni 141 i Kushtetutës parashikon se:

"1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit."

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit."

Ndryshimet që ka pësuar neni 141 i Kushtetutës, natyra, misioni dhe kompetencat e Gjykatës së Lartë janë thelbësore.

Së pari, Gjykatës së Lartë i është hequr, në mënyrë përfundimtare dhe të menjëhershme, pa ndonjë periudhë kalimtare, kompetenca e saj e juridiksionit fillestar për të gjykuar së gjykatë penale e shkallës së parë dhe të vetme akuzat penale ndaj subjekteve të posaçme - disa prej funksionarëve publikë të përcaktuar nga kjo dispozitë kushtetuese.

Së dyti, Gjykatës së Lartë i është ngushtuar edhe funksioni i zakonshëm rishikues, duke e përcaktuar atë si një gjykatë ligji, klasike kasacioni, pra për të mos pasur më funksionin e mëparshëm të një gjykate ligji (e jo vetëm) me juridiksion të gjerë rishikues.

Së treti, gjykimi dhe vendimet e kolegjeve të zakonshme të Gjykatës së Lartë do të synojnë njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe qëndrimet e këtyre kolegjeve mbi interpretimin e ligjeve duhet të mbahen parasysh nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apeleve në zgjidhjen e çështjeve ku gjejnë zbatim ato ligje. Praktikisht do të jenë këto kolegje që kanë detyrën të bëjnë dhe garantojnë interpretimin dhe zbatimin e njëzuar të ligjit në praktikën gjyqësore, ndërkohë që, vetëm kur të lindë nevoja për ta ndryshuar praktikën gjyqësore të njëjtësuar nga kolegjet e zakonshme duhet të mbidhen dhe të vendosin Kolegjet e Bashkuara.

Sipas ligjit kushtetues nr. 76/2016, në pikën 2 të nenit 135 parashikohet se:

“2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.”.

Pra, kjo gjykatë e posaçme jo vetëm dallohet nga gjykatat e zakonshme penale për shkak të lëndës së posaçme të gjykimit, por edhe sepse ajo gjykon edhe akuzat penale ndaj një kategorie të caktuar funksionarësh dhe ish-funksionarësh publikë. Në këtë kompetencë të kësaj gjykatë të posaçme përfshihet edhe kompetenca që, përpara ndryshimit të Kushtetutës, me ish nenin 141 pika 2 i ngarkonte Gjykatës së Lartë juridiksionin fillstar për akuzat penale ndaj disa subjekteve të posaçme, pavarësisht nga vepra penale për të cilën ata akuzoheshin.

Duke ndryshuar për këtë qëllim nenin 148, si edhe duke shtuar nenet 148/b shkronja “a” dhe 148/dh pika 1 të Kushtetutës, të njëjtin zgjidhje i ka dhënë kushtetuesbërësi edhe organit të prokurorisë, lidhur me kompetencën për hetimin e disa llojeve të veprave penale dhe për hetimin dhe akuzat ndaj një kategorie subjektësh të posaçme funksionarë dhe ish-funksionarë publikë.

Nga ana tjetër, është thelbësore të mbahet parasysh se ligji kushtetues nr. 76/2016, në dispozitat kalimtare të tij përcakton rregulla të hollësishme për mjaft çështje.

Por, lidhur me gjendjen që krijohet dhe qëndrimin që duhet të mbahej për kërkesat a çështjet penale të juridiksionit fillestar ende në shqyrtim apo gjykim pas heqjes së kompetencës së juridiksionit fillestar penal të Gjykatës së Lartë për një kategori funksionarësh publikë pavarësisht nga veprat penale të akuzuara, dispozitat kalimtare të ligjit kushtetues nr. 76/2016 nuk përmbajnë asnjë parashikim.

Ndërkohë që, ligji kushtetues nr. 76/2016 përmban rregulla të posaçme kalimtare në pikën 8 të nenit 179 lidhur me mënyrën se si do të funksionojnë gjykatat ekzistuese për krimet e rënda deri në fillimin e veprimtarisë së Gjykatave të reja të posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Deri në fillimin e veprimtarisë së gjykatave të reja të posaçme, gjykatat ekzistuese për Krimet e Rënda do të vijojnë veprimtarinë e tyre sipas lëndës penale që i është përcaktuar me ligj, pra përfshirë ato të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Rregullimet e tjera më të hollësishme të natyrës kalimtare kushtetuesbërësi ia delegoi ligjvënësit. Kështu, në dispozitën kalimtare të pikës 8 të nenit 179 të ligjit kushtetues nr. 76/2016 parashikohet qartë se:

“8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.”.

Pikërisht, duke pasur parasysh këto zgjidhje që ka përcaktuar qartazi vetë kushtetuesbërësi në ligjin kushtetues nr. 76/2016, si gjyqtar në pakicë kam mendimin dhe qëndrimin se, me hyrjen në fuqi të këtij ligji kushtetues, Gjykata e Lartë e ka humbur në mënyrë përfundimtare dhe të

menjëhershme, pa ndonjë periudhë kalimtare, kompetencën e saj të mëparshme të juridiksionit fillestar për të gjykuar së gjykatë penale e shkallës së parë dhe e vetme akuzat penale ndaj subjekteve të posaçme - disa prej funksionarëve publikë të përcaktuar nga ish-neni 141 pika 2 e Kushtetutës.

Duke qenë se, sipas dispozitave të Kushtetutës në fuqi dhe në kushtet e mungesës së rregullimit kalimtar të përcaktuar prej saj, Gjykata e Lartë e ka humbur në mënyrë përfundimtare, të menjëhershme dhe pa ndonjë periudhë kalimtare lejimi të ushtrimit prej saj, kompetencën e saj të mëparshme të juridiksionit fillestar penal për akuzat ndaj subjekteve të posaçme, problemi ligjor që vendoset në bisedim vetvetiu është se si duhet të interpretohet dhe zbatohet kuadri kushtetues dhe ligjor në fuqi, jo vetëm në lidhje me ekzistencën apo jo të kompetencës për të shqyrtuar e gjykuar kërkesat a çështjet penale të juridiksionit fillestar që gjenden për shqyrtim në Gjykatën e Lartë (që sipas mendimit tim e ka humbur), por edhe për ti dhënë zgjidhje eventuale në kushtet e mungesës së kësaj kompetence problemit juridik se cilës gjykatë duhet ti dërgohet çështja në kompetencë. Kjo për arsyen se është e papranueshme të konkludosh mungesën e kompetencës dhe të mos tregosh e arsyetosh se cila është më tej gjykata kompetente për kërkesat dhe akuzat penale ndaj subjekteve të posaçme.

Si gjyqtar në pakicë kam mendimin se, në kushtet kur Gjykata e Lartë e ka humbur në mënyrë përfundimtare dhe të menjëhershme kompetencën e saj të mëparshme të juridiksionit fillestar për të gjykuar akuzat penale ndaj subjekteve të posaçme, si edhe në kushtet kur nuk i është dhënë as edhe ndonjë kompetencë gjykimi për një periudhë kalimtare për çështjet ende në shqyrtim pranë saj, e vetmja zgjidhje juridike në pajtim dhe përputhje me Kushtetutën është që këto çështje ti dërgohen për kompetencë asaj gjykate penale të shkallës së parë, e cila, së paku e ka ende kompetencën aktuale lëndore, pra jo për subjektin e posaçëm por për lëndën penale materiale.

Prandaj, meqenëse në çështjen objekti i këtij gjykimi akuza penale është ngritur për kryerjen e veprave penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të gjyqtarëve etj. të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penale dhe, meqenëse, aktualisht, e vetmja gjykatë penale që ka kompetencë lëndore për gjykimin e akuzave të tilla është Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, si gjyqtar në pakicë kam qëndrimin se çështje objekt gjykimi duhet ti dërgohej për kompetencë kësaj gjykate të shkallës së parë. Gjykata për krimet e rënda do të duhej ta gjykonte çështjen dhe nëse nuk do të mund ta përfundonte shqyrtimin e saj deri në fillimin e veprimtarisë së Gjykatës së re të posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, sikurse e parashikon vetë Kushtetuta në dispozitën kalimtare të pikës 8 të nenit 179, çështja do ti kalohej për kompetencë kësaj të fundit.

Sipas mendimit tim si gjyqtar në pakicë sikurse arsyetohet më sipër, ky interpretim dhe zbatim korrekt dhe i drejtpërdrejtë i Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi në pajtim me të, më rezultojnë që të përputhet plotësisht me qëndrimin dhe interpretimin që i ka bërë Kushtetutës vetë ligjvënësi me miratimin e ligjit nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në pajtim dhe përputhje me nenet 135, 141, 148, 148/b, 148/dh por edhe të dispozitës kalimtare të nenit 179 pika 8 të Kushtetutës, në ligjin nr. 35/2017, në dispozitat kalimtare të nenit 285 të tij, parashikohet qartë se:

“1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.

2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.

3. Aktet dhe provat e marra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme dhe të përdorshme edhe në rastet kur ky ligj parashikon rregullime të ndryshme.

4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. I njëjti rregull zbatohet edhe për çështjet në hetim në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat kalojnë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.....”.

Vlerësoj të evidentoj dhe të qartësoj se, si gjyqtar në pakicë nuk e shikoj të jetë aspak vendi për të vënë në bisedim faktin që ligji nr. 35/2017 ende nuk ka hyrë në fuqi sepse sipas nenit 286 të tij hyn në fuqi në datën 1 gusht 2017, as edhe për të treguar se qëndrimi im në këtë mendim pakice është një mënyrë e interpretimit autentik të ligjit, sepse kjo mënyrë interpretimi i takon vetë ligjvënësit.

Por, nga ana tjetër, këtë vullnet dhe interpretim që i ka bërë Kushtetutës edhe vetë ligjvënësi në miratimin e ligjeve të reja në përmbushje të detyrimeve dhe në pajtim me normat e reja kushtetuese, vlerësoj ta sjell në vemendje thjesht si një qëndrim të njëjtë me atë që unë kam si gjyqtar në pakicë, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e normave të reja kushtetuese mbi kompetencën lëndore penale për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi, pra që Gjykata e Lartë, me hyrjen në fuqi të amendamenteve kushtetuese të vitit 2016 e ka humbur përfundimisht kompetencën e saj lëndore për të gjykuar së gjykatë e shkallës së parë çështje penale, përfshirë ato për subjektet e posaçme sikurse e parashikonte kushtetuta në nenin ish-141 të saj, përpara amendimit të bërë në vitin 2016.

Për rrjedhojë të këtij arsytimi dhe qëndrimi, duke qenë se për shkak të tyre jam i penguar për të shprehur qëndrimet e mia eventuale edhe ndaj arsytimit dhe disponimit të shumicës së Kolegjit Penal mbi çështjet e fajësisë dhe llojit a masës së dënimeve të dhëna, si gjyqtar në pakicë vij në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të kishte vendosur dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë, si e vetmja gjykatë penale që ka kompetencë lëndore për veprat penale të korrupsionit.

G J Y Q T A R

Ardian Dvorani